

VËLLIMI XXIV /JANAR - MARS/ 2024

**VENDIMET E
KOMISIONIT TË
KONKURRENCËS
2024**

BULETINI ZYRTAR



PËRMBAJTJA

Nr.1046, Datë 16.01.2024**Error! Bookmark not defined.**

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT, NËPËRMJET BLERJES SË AKSIONEVE, TË SHOQËRISË “SAV 92” NGA SHOQËRITË ORBICO D.O.O. DHE ASNOVA HOLDING”

Nr.1047, Datë 16.01.2024**Error! Bookmark not defined.**

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË FAB INVEST SHPK NGA SHOQËRIA INSIG JETE SH.A”

Nr.1048, Datë 16.01.2024**Error! Bookmark not defined.**

“PËR DHËNIEN E DISA REKOMANDIMEVE AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE LIDHUR ME DOKUMENTIN PËR KËSHILLIM PUBLIK “ANALIZË TREGU E TELEFONISË CELULARE PËR TREGJET ME SHUMICË TË TERMINIMIT NË RRJETET E TELEFONISË SË LËVIZSSHME (CELULARE)”

Nr.1049, Datë 16.01.2024**Error! Bookmark not defined.**

“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT THELLUAR NË TREGUN E PROKURIMIT PUBLIK NDAJ NDËRMARRJEVE RAIMONDO G.P SHPK DHE LI.BO-ALBANIA BRANCH SHPK DHE DHENIEN E DISA DETYRIMEVE NDËRMARRJEVE RAIMONDO G.P SHPK DHE LI.BO-ALBANIA BRANCH SHPK”

Nr.1050, Datë 25.01.2024**Error! Bookmark not defined.**

“ MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË ILI (HIGHLANDS PSH) LIMITED NGA SHOQËRIA STATKRAFT UK LTD”.

Nr.1051, Datë 25.01.2024**Error! Bookmark not defined.**

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT NË SHOQËRINË MIDOCEAN HOLDINGS II L.P DHE INDIREKT NË SHOQËRINË MIDOCEAN ENERGY, LLC NGA SHOQËRITË ARAMCO OVERSEAS COMPANY B.V DHE EIG MANAGEMENT COMPANY, LLC”

Nr.1052, Datë 25.01.2024**Error! Bookmark not defined.**

“PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT TË KONKURRENCËS Nr.1045 DATË 29.12.2023 “PËR HAPJEN E HETIMIT TË THELLUAR NDAJ NDËRMARRJEVE ERZENI SHPK,GJIROFARMA SHA, ADG SHPK(LUFRA),SHAKA BOBOSHTICË SHPK NË TREGUN E PRODHIMIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË NËNPRODUKTEVE TË QUMËSHTIT(DJATHË DHE GJALPË)”

Nr.1053, Datë 02.02.2024**Error! Bookmark not defined.**

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT ME FUNKSIONE TË PLOTA NGA SHOQËRITË AGNA SH.A; LARTI – SHPK DHE FIX PRO SHPK”

Nr.1054 Datë 02.02.2024**Error! Bookmark not defined.**

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET BLERJES SË AKSIONEVE TË SHOQËRISË EAGLE INVESTMENT SHA NGA SHOQËRIA INFINITY INVESTMENT SHA”

Nr.1055, Datë 02.02.2024**Error! Bookmark not defined.**

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR NËPËRMJET PËRFTIMI TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË ENERFIN SOCIEDAD DE ENERGIA SL NGA SHOQËRIA STATKRAFT EUROPEAN WIND AND SOLAR HOLDING AS”

Nr.1056, Datë 02.02.2024**Error! Bookmark not defined.**

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË FIRST BANK S.A. NGA SHOQËRIA INTESA SANPAOLO S.P.A”

Nr.1057, Datë 12.02.2024**Error! Bookmark not defined.**

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË WE SII S.r.l. NGA Z. MAURO MIGLIAZZI; SHOQËRIA TERNA FORWARD S.r.l. DHE SHOQËRIA DXT COMMODITIES SA.”

Nr.1058, Datë 12.02.2024**Error! Bookmark not defined.**

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË BTB HOLDING INVESTMENTS S.A. NGA SHOQËRIA ULTIMA HOLDING S.A.”

Nr.1059, Datë 23.02.2024**Error! Bookmark not defined.**

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË STUDIO MODERNA ALBANIA SHPK NGA SHOQËRIA SMA HOLDING SHPK”

Nr.1060, Datë 23.02.2024**Error! Bookmark not defined.**

“PËR DHËNIEN E DISA REKOMANDIMEVE AUTORITETI TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE”

Nr.1061, Datë 06.03.2024**Error! Bookmark not defined.**

“PËR DHËNIEN E DISA REKOMANDIMEVE ENTIT RREGULLATOR TË UJIT MBI APLIKIMIN PËR NDRYSHIMIN E NIVELIT TARIFOR PËR NDËRMARRJEN RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME LEZHË SHA”

Nr.1062, Datë 06.03.2024**Error! Bookmark not defined.**

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË

NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT, ME FUNKSIONE TË PLOTA, NGA SHOQËRITË FORD MOTOR COMPANY, BMW (US) HOLDING CORP. DHE AMERICAN HONDA MOTOR CO., INC.”

Nr.1063, Datë 06.03.2024**Error! Bookmark not defined.**

“ MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PËRKOHSHËM, TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRIVE NEOEN RENEWABLES CROATIA D.O.O. DHE FAZAN SOL D.O.O. NGA SHOQËRIA STATKRAFT OIE D.O.O...”.

Nr.1064, Datë 19.03.2024**Error! Bookmark not defined.**

“MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR MBI VEPRIMTARINË E AUTORITETIT TË KONKURRENCËS PËR VITIN 2023 DHE PRIORITETET KRYESORE PËR VITIN 2024”

Nr.1065, Datë 19.03.2024.....**Error! Bookmark not defined.**

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT NGA SHOQËRITË MIELE BETEILIGUNGS-GMBH (INTERNATIONAL STEEL CO. S.P.A.) DHE METALL ZUG AG (BELIMED AG DHE BELIMED LIFE SCIENCE AG), ME KONTROLL TË VETËM NGA MIELE”

Nr.1066, Datë 19.03.2024**Error! Bookmark not defined.**

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT ME FUNKSIONE TË PLOTA, PERUTNINA PTUJ ALBANIA SHPK DHE PËRFTIMI I KONTROLLIT NGA KJO E FUNDIT MBI SHOQËRITË DRIZA SHPK, FRESH CHICKEN ALBANIA 2019 SHPK, INDUSTRIA FORAGJERE (VEAF) SHA DHE BIZNESIN E SHOQËRISË EURO ALB 2009 SHPK”

Nr.1067, Datë 29.03.2024.....**Error! Bookmark not defined.**

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR MBI PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRISË FORTENOVA GROUP MIDCO B.V. DHE TËRTHORAZI MBI FORTENOVA GROUP NGA SHOQËRIA OPEN PASS LIMITED”

Nr.1068, Datë 29.03.2024.....**Error! Bookmark not defined.**

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË EUROSIG SHA NGA SHOQËRIA EURO-ALBA-EA SHPK”

Nr.1069, Datë 29.03.2024**Error! Bookmark not defined.**

“PËR DHËNIEN E DISA REKOMANDIMEVE AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE LIDHUR ME DOKUMENTIN PËR KËSHILLIM PUBLIK “ANALIZA E TREGJEVE ME SHUMICË TË AKSESIT BROADBAND FIKS”

VENDIM

Nr. 1046 , Datë 16. 01. 2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT, NËPËRMJET BLERJES SË AKSIONEVE, TË SHOQËRISË “SAV 92” NGA SHOQËRITË ORBICO D.O.O. DHE ASNOVA HOLDING”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 16.01.2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të përbashkët, nëpërmjet blerjes së aksioneve, të shoqërisë “SAV 92” nga shoqëritë Orbico d.o.o. dhe Asnova Holding.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të përbashkët, nëpërmjet blerjes së aksioneve, të shoqërisë “SAV 92” nga shoqëritë Orbico d.o.o. dhe Asnova Holding,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës u depozitua njoftimi mbi përfitim e kontrollit të përbashkët, nëpërmjet blerjes së aksioneve, të shoqërisë “SAV 92” nga shoqëritë Orbico d.o.o. dhe Asnova Holding.

Referuar dokumentit “Marrëveshje kuadër për blerjen e aksioneve”, nënshkruar më datë 09 qershor 2023, “Marrëveshje e aksionerëve”, nënshkruar më datë 27 tetor 2023 dhe “Marrëveshje për Shitjen-Blerjen e Letrave me Vlerë nr.04/23-BW”, datë 27 tetor 2023, palët në marrëveshje janë:

Blerësi: Orbico d.o.o. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Kroacisë, me objekt aktiviteti: Blerja dhe shitja e mallrave, kryerja e ndërmjetësimit tregtar në tregun e brendshëm dhe të huaj, përfaqësimi i kompanive të huaja, transporti rrugor i mallrave, transporti i mallrave në trafikun ndërkombëtar, reklamim, tregtia me shumicë e produkteve mjekësore, prodhimi i produkteve të kremrave, prodhimi dhe shpërndarja e gazit, biznesi i pasurive të paluajtshme, etj.

Në Shqipëri: Shoqëria Orbico, zotëron 100% të Orbico SHPK, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar me objekt aktiviteti: tregtim artikujsh industrial, import dhe eksport me shumicë dhe pakicë, etj.

Shitësi: Asnova Holding është një shoqëri aksionare e regjistruar sipas legjislacionit të Ukrainës, me objekt aktiviteti: Ofrimi shërbimeve të tjera financiare (me përjashtim të: sigurimit dhe sigurimit pensional), tregtimi i automjeteve dhe makinave, marrja me qira e makinave dhe pajisjeve për zyra, përfshirë kompjuterat, tregti me shumicë e paspecifikuar, konsulencë biznesi dhe menaxhimi, etj.

Shoqëria Target: “SAV 92” është një shoqëri aksionare, e regjistruar sipas legjislacionit të Ukrainës, me objekt aktiviteti: Shitje të vogla me shumicë, pakicë, komision, tregti mallrash të prodhuara, produkte bujqësore, materiale ndërtimi, lëndë djegëse dhe lubrifikantë, produkte të sintezës organike të naftës, lëndë të para, produkte minerale, gurë të përpunuar, produkte ushqimore, mallra të konsumit, alkool, produkte duhani, kimikate shtëpiake, produkte parfumerie dhe kozmetike, artikuj sanitar dhe higjienike, minerale, radio-elektronik, kompjuter, pajisje kopjimi, përbërës dhe konsumues për të me prodhim vendas dhe të huaj, organizimi i tregtisë shëtitëse, organizimi i rrjetit të vet të shitjes me pakicë, duke përfshirë hapjen e dyqaneve, kioskave, etj.

Filialet e target:

- SAVSERVIS- MOVA LLC, një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit ukrainas, me objekt aktiviteti: shitja me shumicë e produkteve ushqimore, pijeve dhe produkteve të duhanit.
- BENICE LLC, një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit ukrainas, me objekt aktiviteti: shitja me shumicë e produkteve kozmetike (përfshirë dhe produktet dekorative, produktet e kujdesit të lëkurës dhe trupit).
- PE PROMO SERVICE, një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit ukrainas, aktiv në shërbimet e reklamimit.

Target dhe filialet e Target nuk janë prezentë në Shqipëri.

II. Përqendrimi

Referuar marrëveshjeve të lidhura, përqendrimi do të zhvillohet në dy faza:

Faza Fillestare e Investimit

Ndërmjet shoqërisë Orbico d.o.o. (blerësi) dhe shoqërisë Asnova Holding si (shitësi), është lidhur “Marrëveshje kuadër për blerjen e aksioneve”, e cila u nënshkrua më datë 09 qershor 2023.

Referuar kësaj Marrëveshje shitësi dhe blerësi synonin kryerjen e një transaksioni që përfshinte blerjen e 24,9% të aksioneve të shoqërisë sipas afateve dhe kushteve në këtë marrëveshje. Transaksioni do të ishte efektiv pas përfundimit të disa kushteve paraprake sipas Marrëveshjes duke përfshirë dhe sigurimin nga shoqëria target të 100% të kapitalit themeltar të filialeve.

Më datë 27 tetor 2023 shoqëria Orbico d.o.o. dhe Asnova Holding kanë lidhur, “Marrëveshje për Shitjen-Blerjen e letrave me Vlerë Nr.04/23-BW”. Me pjesëmarrjen e shoqërisë aksionare Credit Agricole Bank (person juridik i regjistruar sipas legjislacionit të Ukrainës), shitësi ka marrë përsipër të transferojë në pronësi të blerësit dhe blerësi të pranojë dhe paguajë paketën e Letrave me Vlerë (Aksione të Zakonshme të Regjistruara), me vlerë nominale 1000,00 UAH që përfaqësojnë 24,9% të kapitalit themeltar të shoqërisë target.

Po më datë 27 tetor 2023 ndërmjet shoqërisë Orbico d.o.o. (aksioner), Asnova Holding (aksioner) dhe shoqërisë “SAV 92” (target) është lidhur “Marrëveshje e aksionerëve”.

Faza e dytë e Investimit

Qëllimi dhe objekti i kësaj marrëveshje është të përcaktojë afatet dhe kushtet e bashkëpunimit, e në veçanti:

- detyrimet e palëve në datën e nënshkrimit, detyrimet e palëve nga data e nënshkrimit deri në datën kur Orbico bëhet aksioner 51% i shoqërisë “SAV 92” (blerja e shumicës së aksioneve), detyrimet e palëve nga data e blerjes së aksioneve të shumicës deri në datën e bërjes së shoqërisë Orbico d.o.o. aksionar të vetëm të shoqërisë (blerja e plotë e aksioneve), përcaktimin e rregullave për funksionimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e Grupit të Shoqërisë, aksionet kërkojnë dhe vendosin opsione, kufizime dhe limite të transferimit të Aksioneve.

Palët do të sigurojnë që brenda 3(tre) muajve nga data e nënshkrimit, shoqëria të fillojë të përdorë emrin e “SAV Orbico” në të gjitha operacionet e saj të biznesit. Palët do të sigurojnë që emri ligjor i shoqërisë do të ndryshohet në “SAV Orbico” menjëherë pas blerjes së shumicës së aksioneve.

Në varësi të ligjeve të zbatueshme, Asnova Holding do të bëjë përpjekje të arsyeshme për të transferuar të gjitha operacionet e biznesit, detyrimet dhe pasuritë e Filialeve në shoqërinë target.

Secili nga aksionarët zotohet se për sa kohë është direkt ose tërthorazi ortak i shoqërisë (dhe në lidhje me Asnova Holding për periudhën 3(tre) vjeçare pasi kjo e fundit pushon së ekzistuari të jetë aksioner i shoqërisë), ai nuk do të angazhohet (si personalisht ose përmes ndonjë filiali) në

aktivitet konkurrues ne territorin e Ukrainës në veçanti.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i shitjes me shumicë i produkteve të konsumit të shpejtë dhe i produkteve kozmetike, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfitim i kontrollit të përbashkët, nëpërmjet blerjes së aksioneve, të shoqërisë “SAV 92” nga shoqëritë Orbico d.o.o. dhe Asnova Holding.

Transaksioni ndodh në tregun e Ukrainës dhe ka si qëllim zgjerimin më tej në kategori të tjera të produkteve dhe shitjes në këtë treg, ku Orbico ka qenë i pranishëm si distributor i produkteve kozmetike dhe kujdesit të flokëve. Asnova Holding dhe “SAV 92” ushtrojnë aktivitet vetëm në territorin e Ukrainës dhe nuk janë prezente dhe nuk realizojnë të ardhura në Shqipëri.

Orbico d.o.o. është një shoqëri aktive kryesisht në shitjen dhe distribucionin e produkteve kozmetike, ushqimore dhe jo ushqimore, farmaceutike, tekstile etj.

Orbico d.o.o. është prezent në Shqipëri nëpërmjet Orbico SHPK, e cila operon në tregun e produkteve të konsumit të shpejtë (FMCG) dhe tregun e bukurisë dhe pjesa që Orbico SHPK zë në totalin e tregut të produkteve të konsumit të shpejtë (FMCG) është vetëm 1.27%.

Transaksioni nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët, nëpërmjet blerjes së aksioneve, të shoqërisë “SAV 92” nga shoqëritë Orbico d.o.o. dhe Asnova Holding.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1047, Datë 16. 01. 2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË FAB INVEST SHPK NGA SHOQËRIA INSIG JETE SH.A”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Znj. Rezana KONOMI	Anëtar
Z. Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 16.01.2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë FAB INVEST SHPK nga shoqëria INSIG JETE SH.A.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë FAB INVEST SHPK nga shoqëria INSIG JETE SH.A,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës u depozitua njoftimi mbi përfutimin e kontrollit të shoqërisë FAB INVEST SHPK nga shoqëria INSIG JETE SH.A.

Referuar dokumentit “Kontratë Shitje Kuote Kapitali”, nënshkruar më datë 15 gusht 2023, palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: INSIG JETE SH.A është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, e krijuar pas ndarjes së aktivitetit të shoqërisë Insig SHA. Shoqëria ushtron veprimtarinë

e sigurimit dhe risigurimit, nëpërmjet përgatitjes, ofrimit, nënshkrimit dhe zbatimit të kontratave të sigurimit "Jete", sipas termave dhe klasave të përcaktuara në Ligjin Nr.52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", akteve të tjera normative dhe për te cilat është e licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. INSIG JETE SH.A ushtron aktivitetin e saj sigures në përputhje me licencën Nr.4/2000 date 27/12/2016, aprovuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

INSIG JETE SH.A zotërohet plotësisht nga shoqëria EUROSIG SHA.

EUROSIG SHA është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, e cila ka për objekt të veprimtarisë së saj ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit dhe risigurimit, nëpërmjet përgatitjes, ofrimit, nënshkrimit dhe zbatimit të kontratave të sigurimit "Jo-Jetë", sipas termave dhe klasave të përcaktuara në Ligjin Nr.52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", akteve të tjera normative dhe për te cilat është e licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me licencën Nr. 7/2004, datë 22.06.2012.

EUROSIG SHA zotëron Bankën e Bashkuar të Shqipërisë, e cila operon në tregun e ofrimit të shërbimeve bankare, si bankë e nivelit të dytë, dhe shoqërisë Insig SH.A., e cila operon në tregun e sigurimit dhe risigurimit të produkteve Jo-Jetë. EUROSIG SHA zotëron një degë të saj në Kosovë me emrin Eurosig Kosova.

Pala shitëse: FAB - GROUP SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti prodhimin, tregtimin, import-eksportin e ujit të pijshëm, lëngjeve të ndryshme jo alkoolike, pijeve alkoolike si birra, vera etj; import-eksport me shumicë dhe pakicë të mallrave të ndryshëm ushqimorë etj.

FAB - GROUP SHPK përpara transaksionit zotëronte plotësisht shoqërinë target.

Shoqëria Target: FAB INVEST SHPK (EUROSIG – MICROCREDIT SHPK) është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, e cila ushtron veprimtari si një institucion financiar jo-bankë e që lidhen me: financim i furnizuesit duke përfshirë parapagimet, mbajtja e llogarive që lidhen me kreditë e llogarisë klient, mbledhja e kredisë e llogarisë klient, mbrojtja e furnizuesit nga paaftësia paguese e debitorëve, si pasojë e pamundësisë së tyre financiare për të paguar, veprimtari në fushën e kontratave faktoring në cilësinë e faktorit, sipas të gjitha përcaktimeve ligjore të parashikuara në Ligjin Nr. 9630, datë 30.10.2006 "Për Faktoring-un", i ndryshuar, të gjitha aktivitetet që kryen një institucion financiar jo-bankë për të gjitha format e kredidhënies, faktoringun dhe financimin e transaksioneve tregtare, qira financiare, shërbimet e pagesave e të transferimit të parave etj. FAB INVEST SHPK është e pajisur nga Banka e Shqipërisë me Licencën Nr. 23, datë 29.06.2011 "Për Subjekt Financiar JoBankë" dhe Aneksin e licencës 23/1 për veprimtaritë e lejueshme për FAB INVEST SHPK.

II. Përqendrimi

Më datë 15 gusht 2023 është nënshkruar "Kontratë Shitje Kuote Kapitali" ndërmjet shoqërive

INSIG JETE SH.A (blerësi) dhe FAB – GROUP SHPK (shitësi).

Referuar kësaj marrëveshje, shitësi është ortak me 100% të kuotës në kapitalin e shoqërisë target FAB INVEST SHPK. Shitësi ka rënë dakord që t'i shesë këtë kuotë, që zotëron në shoqërinë target, blerësit INSIG JETE SH.A.

Me shlyerjen e plotë të çmimit të shitjes, shoqëria INSIG JETE SH.A bëhet ortake e vetme e shoqërisë target FAB INVEST SHPK.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e Konkurrencës

Sipas nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i shërbimit të faktoring-ut nga Subjektet Financiare joBankë (SFJB) dhe përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Referuar aktivitetit të palëve pjesëmarrëse në transaksion, tregjet e prekura nga transaksioni janë:

- *Tregu i sigurimeve*

Shoqëria EUROSIG SHA dhe shoqëritë e kontrolluara prej saj, Insig SHA dhe INSIG JETE SH.A, ushtrojnë aktivitetin në tregun e sigurimeve, i cili funksionon në zbatim të ligjit nr. 52 datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) është autoritet mbikëqyrës dhe rregullator i integruar i tregut të sigurimeve, të titujve, të sipërmarrjeve, të investimeve kolektive dhe të pensioneve private vullnetare në Shqipëri. Ligji nr. 52/2014, ka parashikuar që shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit të pajisen me licenca për klasa të sigurimit të Jetës dhe sigurimit të Jo-Jetës.

Referuar të dhënave të raportit vjetor të AMF-së konstatohet se, gjatë vitit 2022 në tregun e sigurimeve ushtrojnë veprimtarinë e tyre 12 shoqëri sigurimi Jetë dhe Jo-Jetë. Në strukturën e tregut, katër shoqëri sigurimesh ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sigurimet e Jetës dhe tetë shoqëri sigurimesh ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sigurimet e Jo-Jetës.

Sipas të dhënave mbi primet e nënshkruara për sigurimin e jetës për periudhën 2021-2022 rezulton se pjesa e tregut e shoqërisë INSIG JETE SH.A, në tregun e sigurimit të jetës, gjatë vitin 2021 ka qenë 15% me një trend rritës në vitin 2022 drejt vlerës 18% dhe shoqëria, sipas raportit të auditimit të pasqyrave financiare për vitin 2022, paraqitet me një fitim bruto rreth 23 milion lekë ose 8.4%.

Sipas treguesit të primeve të shkruara për periudhën 2021-2022 në tregun e sigurimit të jo-jetës, rezulton se pjesa e tregut e shoqërisë EUROSIG SHA gjatë dy viteve 2021-2022 është 13%, ndërkohë që shoqëria Insig SHA është në vlerën 7%.

- *Tregu i shërbimeve bankare*

Që nga viti 2021, EUROSIG SHA zotëron të gjithë kapitalin aksionar të shoqërisë Banka e Bashkuar e Shqipërisë, e cila është shoqëri e licencuar dhe që shtron aktivitet si bankë e nivelit të dytë në Shqipëri, duke ofruar shërbime bankare.

Referuar të dhënave të Shoqatës Shqiptare të Bankave, për treguesit ekonomik të bankave të nivelit të dytë për 3 mujorin e tretë 2023, na rezulton se Banka e Bashkuar e Shqipërisë renditet në bankat e vogla në vend, duke zotëruar 1.4% të tregut në termat e kredisë, 0.8% në terma te depozitave dhe 0.7% në vlerën e aseteve. Banka paraqitet me humbje gjatë vitit 2022.

- *Tregu i shërbimit të faktoring-ut*

Shoqëria FAB INVEST SHPK është pajisur me licencë nr. 23, datë 29.06.2011, për të ushtruar shërbime faktoringu; shërbimet këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbimet e tjera ndihmëse për faktoringun; të gjitha format e kredidhënies si Subjekt Financiar JoBankë (SFJB).

Faktoringu është një shërbim i cili konsiston në konvertimin e llogarive të arkëtueshme të klientit (fatura apo edhe kontrata) në mjete likuide (para), duke i dhënë mundësi ndërmarrjes për të pasur likuiditet dhe për të vazhduar punën. Pra, SFJB që ofron shërbimin e faktoringut blen faturat e biznesit dhe ndjek shlyerjen e tyre nga subjekti debitor.

Mbështetur në pasqyrat financiare të konkurrentëve më të afërt të shoqërisë FAB INVEST SHPK për vitin 2021 dhe 2022 rezulton se, FAB INVEST SHPK është ndërmarrja me pjesën më të vogël të të ardhurave në këtë treg duke zënë vetëm 4% të tregut në vitin 2022.

Efektet e përqendrimit.

Transaksioni i përfundimit të kontrollit të shoqërisë FAB INVEST SHPK nga shoqëria INSIG JETE SH.A. përbën një përqendrim konglomerat, pasi ndërmarrjet që marrin pjesë në përqendrim nuk kanë as marrëdhënie horizontale (si konkurrentë në të njëjtin treg përkatës) dhe as vertikale (si prodhues edhe klientë). Palët në transaksion operojnë në tregje të ndryshme.

Referuar tregjeve të prekura dhe të lidhura me aktivitetin e palëve në transaksion, konstatohet se shoqëria EUROSIG SHA, shoqëria që do të kontrollojë indirekt shoqërinë target, FAB INVEST SHPK, ushtron aktivitet edhe në tregun e shërbimeve bankare nëpërmjet shoqërisë Banka e Bashkuar e Shqipërisë. Faktoringu është një shërbim, i cili sigurohet nga kredimarrja e SFJB nga bankat e nivelit të dytë, duke e klasifikuar kredidhënien nga bankat e nivelit të dytë dhe shërbimit të faktoring-ut si produkte të lidhura.

Problemi kryesor në përqendrimet konglomerate është ai i përjashtimit i konkurrentëve nga tregu. Kombinimi i produkteve në tregjet e lidhura, mund t'i japë njësisë së përqendruar mundësinë dhe ta nxitë që të transmetojë një pozicion tregu të fuqishëm, nga një treg në një tjetër, me anë të praktikave kushtëzuese ose praktikave të tjera përjashtuese (të lidhura).

Në Udhëzimin “Për vlerësimin e përqendrimeve jo horizontale dhe konglomerate”, evidentohet se

nëse pjesët e tregut të shoqërive që ofrojnë produkte të lidhura mund të sjellin pozicione të fuqishme në treg, mundësia për të ndodhur një sjellje përjashtuese mund të jetë evidente.

Referuar pjesëve të tregut që zotëron Banka e Bashkuar e Shqipërisë në tregun e shërbimeve bankare si dhe pjesën e tregut që zotëron FAB Invest SHPK në tregun e shërbimit të faktoring-ut, konstatohet se asnjë nga palët nuk ka një pjesë të ndjeshme tregu, duke mos sjellë shqetësime për konkurrencën në treg dhe duke mos ndikuar në përjashtimin e konkurrentëve të tjerë nga tregu.

Nisur nga sa më sipër dhe mbështetur në Udhëzimin “Për vlerësimin e përqendrimeve jo horizontale dhe konglomerate”, gjykojmë se një transaksion i tillë mund të sjellë eficensa dhe mund të ndihmojë shoqërinë target, FAB INVEST SHPK, të përmirësojë treguesit ekonomik, duke e bërë më konkurrues në tregun përkatës të produktit.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë FAB INVEST SHPK nga shoqëria INSIG JETE SH.A.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr.1048, Datë 16. 01. 2024

“PËR DHËNIEN E DISA REKOMANDIMEVE AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE LIDHUR ME DOKUMENTIN PËR KËSHILLIM PUBLIK “ANALIZË TREGU E TELEFONISË CELULARE PËR TREGJET ME SHUMICË TË TERMINIMIT NË RRJETET E TELEFONISË SË LËVIZSSHME (CELULARE)”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 16.01.2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Dhënia e disa rekomandime Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare në tregun e shërbimeve celulare lidhur me dokumentin nxjerrjen për këshillim publik të dokumentit “Analizë e tregjeve me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme (celulare)”.

Baza Ligjore: Neni 24, shkronja (d) dhe neni 70 dhe neni 43, pika 1 e Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE :

1. Këshilli Drejtues i AKEP-it me Vendimin nr. 16, datë 16.11.2023, miratoi nxjerrjen për këshillim publik të dokumentit “Analizë e tregjeve me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme (celulare)”.
2. AKEP në vijim të bashkëpunimit dhe detyrimeve që përcakton neni 38 i Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nenet 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, me shkresën nr. 2024/4 prot., datë 17.11.2023 (protokolluar pranë AK me nr. 655 prot., datë

20.11.2023), mirëpret komentet e Autoritetit të Konkurrencës për dokumentin e nxjerrë për këshillim publik, lidhur me “Analizë e tregjeve me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet e telefonisë së lëvizshme (celulare)”.

3. Sipas nenit 31 të Ligjit nr. 9918/2008, tregjet që justifikojnë rregullimin dhe janë subjekt i rregullimit, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji, janë tregjet me pengesa, me natyrë juridike ose strukturore të larta dhe të qëndrueshme për hyrjen në treg, tregjet të cilat nuk janë të orientuar drejt konkurrencës efektive brenda një periudhe kohore të përshtatshme, tregjet ku zbatimi vetëm i ligjit për konkurrencën nuk mund të zgjidhë në mënyrën e duhur dështimet e tregut. Sipërmarrësit, që kanë fuqi të ndjeshme në treg, janë subjekt i masave të vendosura nga AKEP-i, në përputhje me këtë ligj dhe aktet në zbatim të tij.
4. Tregu me shumicë i terminimit të thirrjeve ndërkombëtare është pjesë e listës së tregjeve të përcaktuar në rregulloren 9/2007 dhe listës së tregjeve në rekomandimin e KE të vitit 2014, si i tillë për analizën e këtij tregu nuk është e nevojshme kryerja e testit të tre kritereve.
5. Niveli i tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare ka qenë objekt rregullimi *ex-ante* nga AKEP (më parë ERT) që nga viti 2006. Rregullimi i këtyre tarifave nga AKEP deri në vitin 2010 është kryer duke përdorur nivelin mesatar të tarifave të terminimit në vendet e BE, dhe, duke filluar nga viti 2010 deri në mars 2014, ky rregullim është kryer bazuar në reduktimin e përshkallëzuar për orientimin në kosto drejt vlerës së nxjerrë nga modeli BULRAIC i ndërtuar në vitin 2010 nga AKEP me konsulencë ndërkombëtare. Modeli BULRAIC në vitin 2010 referohet si LRIC+, ndërsa metoda e rekomanduar nga KE dhe e përdorur në shumicën e vendeve evropiane tashmë është Pure LRIC.
6. Në lidhje me masën rregulluese të rregullimit të MTR, AKEP bazuar në ndryshimet e ndodhura në treg, ndryshimet në MTR benchmark në vendet e BEREC si dhe bazuar në komentet finale të operatorëve të dërguara në Janar 2018, përgatiti një version të ri të dokumentit për rregullimin e MTR për këshillim publik me palët e interesuara.
7. AKEP me Vendimin nr. 15, datë 22.02.2018, miratoi nxjerrjen në këshillim publik të dokumentit “Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare – Këshillim Publik”.
8. AKEP me Vendimin nr. 70, datë 01.10.2018 vendosi miratimin e Dokumentit: “Rregullimi i tarifave të sipërmarrësve me FNT në tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare - Dokumenti Përfundimtar”.
9. Me Vendimet nr. 71, 72, 73 të datës 01.10.2018 Këshilli Drejtues i AKEP miratoi reduktimin e përshkallëzuar të tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare (MTR) simetrike për të tre MNO-të me FNT për thirrjet kombëtare në periudhën 2018-2020. MTR në nivelin e

1.22 lek/min duke filluar nga data 01.12.2018 dhe në nivelin 1.11 lekë/min nga data 01.12.2019 - deri në një vendim tjetër të AKEP, miratimi i këtyre tarifave është bazuar në nivelin benchmark të MTR mesatare të vendeve të BEREC që kanë aplikuar modelin e kostos Pure LRIC deri në 2016 dhe Korrik 2017 respektivisht.

10. Këshilli Drejtues i AKEP me Vendimin nr. 78, datë 01.10.2018, miratoi dokumentin “Analizë e Tregut Celular: Tregu me Shumicë i Aksesit dhe Origjinimit; Tregjet me Shumicë të Terminimit të Thirrjeve Ndërkombëtare dhe Tregu me Pakicë i Shërbimeve Celulare – Dokument Përfundimtar”, mbi bazën e të cilit miratoi Vendimin nr. 79, datë 01.10.2018 ku përcaktoi sipërmarrësin Vodafone Albania SHA me Fuqi të Ndjeshme në: (i) tregun me shumicë të aksesit dhe origjinimit, (ii) tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare dhe (iii) tregun me pakicë të shërbimeve celulare dhe masat përkatëse rregullatore, dhe me vendimet nr. 80 dhe nr. 81, datë 01.10.2018 përkatësisht përcaktoi sipërmarrësin Altelecom SHA dhe sipërmarrësin Telekom Albania SHA me Fuqi të Ndjeshme në (i) tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare si dhe masat përkatëse rregullatore.
11. Të tre sipërmarrësit Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Altelecom u shpallën me FNT në tregun me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare, dhe u vendosën masat përkatëse rregullatore për detyrimin e mos-diskriminimit dhe detyrimin e transparencës.
12. AKEP, me Vendim nr. 89, datë 15.11.2018, miratoi shfuqizimin e Vendimit nr. 78, datë 1.10.2018, të Këshillit Drejtues të AKEP, “Për Miratimin e Dokumentit: “Analizë e Tregut Celular: Tregu me Shumicë i Aksesit dhe Origjinimit; Tregjet me Shumicë të Terminimit të Thirrjeve Ndërkombëtare dhe Tregu me Pakicë i Shërbimeve Celulare – Dokument Përfundimtar” dhe përkatësisht shfuqizimin e Vendimeve të Këshillit Drejtues nr. 79, nr. 80, nr. 81 dhe nr. 82, datë 1.10.2018, të cilat kanë dalë mbështetur në VKD nr. 78, datë 1.10.2018 të Këshillit Drejtues të AKEP. Në këtë vendim AKEP vendosi nisjen e procedurës për rikryerjen e analizës për tregjet përkatëse si dhe të tregjeve të tjera, në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke garantuar harmonizim dhe përputhshmëri me legjislacionin e Komisionit Europian. AKEP do të bashkëpunojë ngushtësisht me strukturat e Komisionit Europian për të përfutur ekspertizën dhe kontributin e ofruar prej tyre në këtë proces.
13. Këshilli Drejtues i AKEP, me Vendimin nr. 11, datë 16.6.2020, miratoi dokumentin “Mbi përfundimet e arritura pas Këshillimit Publik të dokumentit: “Analizë tregu e telefonisë celulare për tregjet me shumicë të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare, përfshirë terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare”, në të cilin vendosi t’i konsiderojë të tre operatorët e rrjeteve celulare Altelekom SHA., Telekom Albania SHA, dhe Vodafone Albania SHA, si sipërmarrës me fuqi të ndjeshme (FNT) në tregun përkatës: tregu me shumicë të terminimit të thirrjeve kombëtare në rrjetet celulare, duke lënë në fuqi masat rregullatore të

përcaktuara në vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP nr.12, 13, 14, datë 22.2.2018, si dhe tarifën e terminimit të thirrjeve kombëtare në rrjetet celulare 1.11 lekë për minutë, sipas vendimeve të Këshillit Drejtues të AKEP nr. 71, 72, 73 të datës 1.10.2018. Gjithashtu, vendosi të mbajë në vëzhgim tregun përkatës me shumicë të terminimit të thirrjeve ndërkombëtare në rrjetet celulare, deri në plotësimin e tërësisë së kushteve për ndërmarrjen e një analize të re.

14. Në përfundim të procesit të asistencës ndërkombëtare për ndërtimin e një modeli kostosh BU-LRIC përgjatë periudhës 2020 – 2021, AKEP, me vendimin nr. 3, datë 1.4.2021, vendosi “Miratimin e dokumentit: Modeli i Referencës së dokumentit për ndërtimin e modelit të kostove për shërbimet mobile”, dhe me vendimin nr. 10, datë 22.7.2021 për “Miratimin e dokumentit – Rezultatet e modelit të kostove të shërbimeve me shumicë të rrjeteve celulare”, publikoi rezultatet e modelit të kostove të pastra mesatare të LRIC për tarifën e terminimit.
15. BEREC në dhjetor 2021 ka publikuar të dhënat më të fundit për MTR-në deri më Korrik 2021, konkretisht tarifa MTR mesatare e ponderuar në vendet e BE/BEREC rezulton 0.7170 eurocent për minutë, (0.881 lek) nga 0.7574 eurocent (0.94 lek) për minutë në vitin 2020, dhe mesatarja e ponderuar për të gjitha vendet në analizë (37 vendeve të BEREC) rezulton 0.6952 eurocent (0.854 lek), duke shënuar rënie me rreth 4% në krahasim me 0.7222 eurocent (0.899 lek) për minutë në vitin 2020.
16. Në vijim të vendimmarrjeve të AKEP në Mars 2014 e në vijim për rregullimin e tarifave të terminimit në rrjetet celulare në Shqipëri bazuar në tarifën benchmark të vendeve të BE/Europiane që kanë aplikuar modelin BULRIC i pastër (Pure BU-LRIC), AKEP paraqet informacion të përditësuar në lidhje me aplikimin e këtij modeli dhe nga vendet anëtare të BEREC dhe vlerat përkatëse mesatare, që mund të përdoren si benchmark për rregullimin e MTR-ve në Shqipëri.
17. Në këtë dokument paraqiten tarifën mesatare të thjeshta për 27 vendet e BE dhe vlerën mesatare të thjeshtë të tarifave të terminimit në 37 vendet që raportojnë në BEREC, si dhe krahasimin me tarifën aktuale të terminimit të thirrjeve në rrjetet celulare në Shqipëri.
18. Nga këto të dhëna, vërehet se tarifën e terminimit MTR në Shqipëri në këtë periudhë janë më të larta se ato të vendeve të BEREC si për mesataren e thjeshtë të 37 vendeve të EEA, ashtu edhe për atë të 27 vendeve të BE.
19. Referuar të dhënave të raportit të BEREC, të datës 9 dhjetor 2021, 6 vende (përfshirë Shqipërinë) rregullojnë tarifën e terminimit në rrjetet celulare duke përdorur tarifën benchmark nga vendet që kanë aplikuar modelin ‘Pure-BU-LRIC’, ndërsa Qipro, duke filluar nga viti 2018 ka filluar zbatimin e modelit të kostove Pure LRIC. Tarifën e këtyre vendeve janë përcaktuar nga rregullatorët përkatës në momente të ndryshme kohore duke përdorur informacionin e disponueshëm për aplikimin e modelit Pure BU-LRIC në vendet e tjera

Europiane/BE. Ndërsa me hyrjen në fuqi të Rregullores së Komisionit European 2021/654, që nga 1 korrik 2021, shumë vende të BE kanë filluar aplikimin e MTR-ve sipas vlerave të glidepath të përcaktuar në këtë Rregullore.

20. Në Shqipëri, AKEP ka përcaktuar vlerën 1.48 lek/minutë në vitin 2014, duke përdorur tarifën mesatare prej 1.0550 eurocent të 13 vendeve që kishin aplikuar modelin Pure BULRIC deri në fund të vitit 2013. Rregullimi më i fundit i bazuar në metodën 'benchmark pure BULRIC' është kryer në Islandë, e cila ka përllogaritur vlerën benchmark prej 0.8813 eurocent/min në gusht 2016 dhe kjo vlerë ka filluar të aplikohet nga janari 2017.
21. Tarifat e terminimit në rrjetet celulare në Shqipëri kanë ardhur duke u reduktuar në mënyrë të përshkallëzuar si rezultat i ndërhyrjes së AKEP, nga viti në vit, duke konverguar drejt një simetrie të plotë mes tre operatorëve. Në figurën e mëposhtme paraqitet grafikisht ecuria e tarifave të terminimit për operatorët celularë si dhe mesatarja e tyre nga viti 2010 e në vazhdim,
22. Vërehet që tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale ka ardhur në ulje, duke pasur fillimisht një asimetri midis dy operatorëve më të vegjël (hyrës të rinj në këtë treg) kundrejt operatorëve ekzistues Vodafone Albania dhe One Telecommunications (tashmë One Albania, pas bashkimit të One Telecommunications dhe Altelecom), për të shkuar në simetri të plotë pas daljes së Plus nga tregu dhe vendimmarrjes së AKEP në tetor 2018. Ndërsa aktualisht, me ndryshimet e reja të ndodhura në strukturën e tregut të telefonisë celulare pas bashkimit të dy operatoreve Altelecom dhe One Telecommunications, nga data 1.1.2023 tregu i telefonisë celulare ka kaluar nga 3 operatorë, në 2 operatorë, përkatësisht Vodafone Albania dhe One Albania.
23. Duke përafruar tarifat e terminimit celulare me BE/BEREC në tetor të vitit 2018, AKEP miratoi reduktimin e përshkallëzuar të tarifave të terminimit të thirrjeve në rrjetete celulare (MTR) simetrike për të tre MNO-të me FNT për thirrjet kombëtare në periudhën 2018-2020. MTR u përcaktua në nivelin e 1.22 lek/min duke filluar nga data 1.12.2018 dhe në nivelin 1.11 lek/min nga data 1.12.2019 - deri në një vendim tjetër të AKEP, miratimi i këtyre tarifave është bazuar në nivelin benchmark të MTR mesatare të vendeve të BEREC që kanë aplikuar modelin e kostos Pure LRIC.
24. Duke filluar nga data 1.7.2021, në zbatim të Rregullores së Komisionit European 2021/654 për implementimin e tarifave të përbashkëta të terminimit (MTR dhe FTR) në vendet e BE, janë përcaktuar eurotarifat (Eurorates) përkatësisht në vlerat: 0.7 eurocent/minutë për periudhën 1.7.2021 – 31.12.2021, dhe 0.55 eurocent/minutë për periudhën 1.1.2022 – 31.12.2022, të cilat janë përkatësisht 22% dhe 39% më të ulëta se tarifa aktuale e terminimit MTR në Shqipëri 1.11 lek/minutë.

25. Viti 2023 shënon vitin e parë pas ndryshimeve strukturore të ndodhura në tregun e telefonisë celulare, në të cilin aktualisht ofrojnë rrjete/shërbime përkatëse dy ofertues, pas transaksionit të ndodhur në fund të vitit 2022, duke e ulur numrin e operatorëve nga tre në dy për herë të parë që nga viti 2008, pas bashkimit të Albtelecom dhe ONE nën kontrollin e 4iG.
26. Nga të dhënat e këtij dokumenti evidentohet se sipërmarrësi me pjesën më të madhe të tregut, pothuajse për të gjitha treguesit e marrë në analizë, është Vodafone Albania, dhe pjesët e tregut për këtë operator kanë qenë në nivele pothuajse të qëndrueshme me luhatje të lehta nga njëri vit në tjetrin. One Telecommunications është sipërmarrësi i dytë me pjesën më të madhe të tregut për treguesit respektivë, dhe vërehet se veçanërisht përgjatë viteve 2021 – 2022 ka shënuar rritje të pjesëve të tregut.
27. AKEP, me Vendimin nr. 2522, datë 6.11.2014 ka vendosur “Miratimin Dokumentit: Analizë e tregut celular: tregjet me shumicë të terminimit dhe tregu me pakicë të shërbimeve publike në rrjetet e telefonisë së lëvizshme - Dokumenti Përfundimtar”. Me Vendimet 2523, 2524, 2525, 2526 janë shpallur FNT në tregjet e terminimit të thirrjeve të katër operatorët dhe janë miratuar tarifat e terminimit të thirrjeve (me asimetri në favor të Plus) ndërkohë që në të njëjtat vendime është shtuar edhe detyrimi për on-Net vs off-net i cili, në fakt, i referohet problematikës në tregjet celulare me pakicë dhe është marrë si një masë rregullatore.
28. Masa mosdiskriminimit on-net vs off-net është ndërmarrë në vitin 2014 në kushtet e tarifave të larta të terminimit të thirrjeve nga një rrjet dejt një tjetër rrjeti celular që nxiste efektin ‘club’ të favorizimit të thirrjeve brenda rrjetit duke avantazhuar operatorët me pjesë të madhe tregu dhe penalizonte për thirrjet jashtë rrjetit (operatorët me pjesë më të vogla tregu). Këto masa janë akoma në fuqi.
29. Një ndër faktorët kryesorë që është marrë në konsideratë nga AKEP për vendosjen e detyrimit të mosdiskriminimit të thirrjeve on-net vs off-net ka qenë pjesa e tregut e operatorëve, ku potencialisht operatorët me pjesën e tregut më të madhe shfrytëzojnë bazën më të gjerë të pajtimtarëve, duke ju ofruar incentiva në kohë komunikimi brenda rrjetit me çmime preferenciale. Nga periudha në të cilën është vendosur kjo masë rregullatore situata e operatorëve të këtij tregu ka ndryshuar qënësisht, ku nga katër operatorë mobile tashmë në treg kemi vetëm dy, One Albania dhe Vodafone Albania, pjesët e tregut të të cilëve janë të përfafërta për sa i përket numrit të pajtimtarëve.
30. Nga të dhënat vihen re ndryshime të mëdha në strukturën e thirrjeve dhe tendencat e rritjes së peshës së thirrjeve off-net (drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare) dhe reduktimin e peshës së thirrjeve brenda rrjetit (on-net). Pesha e thirrjeve off-net është rritur nga 5% në vitin 2013 dhe ka arritur në 42% në vitin 2022. Në të njëjtën periudhë pesha e thirrjeve on-net është

reduktuar nga 93% në vitin 2013 në 56% në vitin 2022. Struktura e thirrjeve on-net përkundrejt atyre off-net ka qenë e qëndrueshme përgjatë viteve 2018 – 2022, duke tentuar drejt peshave të përafërta.

31. Për sa më lart, AKEP vlerëson se kjo masë e ka dhënë efektin e saj në përputhje me qëllimin e vendosur dhe si e tillë AKEP gjykon që kjo masë mund të tërhiqet në referencë me parashikimet e nenit 36 të ligjit 9918/2008, i ndryshuar. Arsyet e propozimit për tërheqjen e kësaj mase rregullatore ndër të tjera argumentohen nga faktorët si:
 - a. struktura e re e tregut me dy operatorë mobile;
 - b. mungesa e stimujve të nevojshëm për aplikim të tarifave grabitqare për krijimin e grupeve të mbyllura;
 - c. ulja e volumit të thirrjeve voice ndikuar nga rritja gjithnjë e më e madhe nëpërmjet aplikacioneve OTT, të cilat gjithnjë e më shumë ofrojnë shërbim thirrjesh (audio, video, sms) me cilësi në rritje;
 - d. struktura e thirrjeve e balancuar për një periudhë relativisht të gjatë, etj.
32. Bazuar në analizat e tregut deri në vitin 2019, AKEP ka përcaktuar se terminimi i thirrjeve ndërkombëtare nuk është në të njëjtin treg përkatës, si edhe terminimi i thirrjeve kombëtare për shkak të dimensionit gjeografik, por në të dy tregjet secili nga operatorët është me fuqi të ndjeshme në treg (FNT) pasi ka monopolin e terminimit në rrjetin e vet të thirrjeve kombëtare ose ndërkombëtare. Theksojmë se për shkak të natyrës monopoliste që ka tregut i terminimit të thirrjeve, edhe në kushtet e reja në tregun e telefonisë celulare me kalimin nga tre në dy operatorë, të dy operatorët vazhdojnë të jenë me fuqi të ndjeshme në treg (FNT) në tregjet përkatëse të terminimit
33. Në rekomandimet për orientimin në kosto të tarifave të terminimit nga KE dhe BEREC, si dhe nga praktikat rregullatore në vende të BE, vihet re se orientimi në kosto rekomandohet të kryhet nëpërmjet një reduktimi të përshkallëzuar. Për të kryer një reduktim të tillë glide path është një mjet rregullator i përshtatshëm që përdoret nga rregullatorët për reduktimin e çmimeve gjatë një periudhe të shtrirë në kohë, në nivelin e llogaritur drejt koston së orientuar. Në praktikën rregullatore glide path janë konsideruar të zakonshme në caktimin e tarifave të orientuara drejt koston, arsyet më të zakonshme që lidhen me përdorimin e tyre shoqërohen me nevojën për t'u dhënë kohë operatorëve për të rregulluar gradualisht planet e tyre të biznesit, duke shmangur ndërprerjet e menjëhershme në treg, veçanërisht kur ndryshimi midis MTR ekzistuese dhe MTR të orientuar drejt koston është i lartë.
34. AKEP e konsideron gjithashtu glide path si një mjet të rëndësishëm për zbatimin e nivelit të ri të MTR-së zanore të orientuar drejt koston në rastet kur normat mesatare aktuale të terminimit janë dukshëm më të larta se niveli i vlerësuar i koston efikase.

35. AKEP gjykon se në kushtet e publikimit të rezultateve në përfundim të projektit të asistencës ndërkombëtare për ndërtimin e Modelit të Kostos për Terminimin me shumicë të thirrjeve në rrjetet celulare, të miratuara me Vendim të AKEP nr. 10, datë 22.7.2021, të përcaktojë tarifën e reja të terminimit me shumicë të thirrjeve kombëtare mbi Modelin e Kostos BULRAIC për të dy operatorët celularë Vodafone Albania SHA, dhe One Albania SHA.
- a) Sipërmarrësi One Albania SHA, përmbush kriteret për FNT në tregun përkatës me shumicë të terminimit të thirrjeve kombëtare në rrjetin celular One Albania;
 - b) Sipërmarrësi Vodafone Albania SHA përmbush kriteret për FNT në tregun përkatës me shumicë të terminimit të thirrjeve kombëtare në rrjetin celular Vodafone Albania;
36. Duke vlerësuar qëndrimet e operatorëve të rrjeteve celulare gjatë procesit të ndërtimit të modelit të kostove BU-LRIC, si dhe bazuar në rezultatet e përfundimit të projektit të asistencës teknike për Modelin e Kostove, trajtimin dhe analizën e tregjeve të ofrimit të shërbimeve mobile në këtë dokument AKEP propozon që MTR kombëtare për të dy operatorët të rishikohen sipas si më poshtë vijon, nëpërmjet reduktimit të përshkallëzuar ‘glide path’ për zbatimin e ri të MTR kombëtare.
- Vodafone Albania/One Albania: duke filluar nga data 1.12.2019 në nivelin 1.11 lek/min; duke filluar nga data 01.03.2024 në nivelin 1.02 lek/min; duke filluar nga data 01.09.2024 në nivelin 0.89 lek/min dhe duke filluar nga data 01.03.2025 në nivelin 0.75 lek/min.
37. Bazuar në parashikimet e nenit 75 të Kodit të Komunikimeve Elektronike Europiane (EECC), duke marrë në konsideratë opinionin e BEREC, në përputhje edhe me parashikimet e nenit 117 të EECC, Komisioni Europian ka adaptuar një akt për të mbështetur këtë direktivë për vendosjen e një tarife të vetme maksimale për secilin nga shërbimet e terminimit të thirrjeve zanore nga rrjetet fikse dhe ato mobile, të cilat do të vendosen në të gjithë ofruesit e këtyre shërbimeve në të gjitha vendet anëtare të BE-së.
38. Autoritetet Rregullatore të vendeve anëtarë (NRAs) pas hyrjes në fuqi të tarifave nuk do të mund të vendosin masa rregullatore për kontrollin e tarifave për shërbimet celulare ose fikse në territorin e tyre kombëtar, por mund të përdorin vetëm instrumentin e masave të palidhura me rregullimin e tarifave/çmimeve (non-price related obligation on the termination providers).
39. Vihet re një rënie e minutave të komunikimit të thirrjeve ndërkombëtare nga viti 2018 në vitin 2022, me përjashtim të sipërmarrësit Vodafone Albania i cili ka pasur rritje të thirrjeve ndërkombëtare të terminuara gjatë vitit 2019 në krahasim me vitin 2018, por pas vitit 2019 rënia ka qenë e ndjeshme edhe për këtë sipërmarrës. Rënia e terminimit të thirrjeve ndërkombëtare i atribuohet ndër të tjera edhe rritjes së përdorimit të internetit me anë të

telefonave celularë, nëpërmjet të cilit konsumatorët komunikojnë duke përdorur aplikacionet, etj.

40. Sa më sipër, AKEP ka ngritur disa pyetje rreth këtij dokumenti për Këshillim Publik, si vijon:
41. Cili është opinioni juaj për vlerat aktuale të tarifave të terminimit të thirrjeve kombëtare dhe reduktimin e përshkallëzuar të propozuar në këtë dokument deri në vitin 2025, sipas rezultateve të Modelit të Kostove të miratuar nga AKEP?
42. Lidhur me pyetjen e parë, sipas analizës së kryer tarifat e terminimit në Shqipëri janë më të larta se tarifa mesatare e thjeshtë e vendeve anëtare të BE dhe vendeve të cilat raportojnë në BEREC. Por vlerësojmë se tarifat e terminimit në Shqipëri, kanë ardhur duke u reduktuar në mënyrë të përshkallëzuar si rezultat i ndërhyrjes së AKEP, nga viti në vit, duke konverguar drejt një simetrie të plotë mes tre operatorëve si dhe vërehet se tarifat e terminimit të thirrjeve në rrjetet individuale ka ardhur në ulje, duke pasur fillimisht një asimetri midis dy operatorëve më të vegjël (hyrës të rinj në këtë treg) kundrejt operatorëve ekzistues Vodafone Albania dhe One Telecommunications (tashmë One Albania, pas bashkimit të One Telecommunications dhe Albtelecom), për të shkuar në simetri të plotë pas daljes së Plus nga tregu dhe vendimmarrjes së AKEP në tetor 2018. Ndërsa aktualisht, me ndryshimet e reja të ndodhura ne strukturën e tregut të telefonisë celulare pas bashkimit të dy operatoreve Albtelecom dhe One Telecommunications, nga data 1.1.2023 tregu i telefonisë celulare ka kaluar nga 3 operatorë, në 2 operatorë, përkatësisht Vodafone Albania dhe One Albania.
43. A duhet ta konsiderojë AKEP që në periudhën nga viti 2025 e në vijim, që edhe në Shqipëri të aplikohen tarifa terminimi të njëjta me euro tarifën, sipas të njëjtave vlera të unifikuar për shërbimin e terminimit të thirrjeve zanore edhe në vendet e BE-së?
44. Lidhur me pyetjen e dytë, duke parë se tarifat aktuale të vendeve të BE janë më të ulta se tarifat aktuale të terminimit në Shqipëri, vlerësohet se AKEP duhet të konsiderojë që nga viti 2025, e në vijim të implementojë metodologjinë e vendeve të BE për percaktimin e tarifave të terminimit, duke qenë se ato kanë për qëllim orientimin e çmimeve drejt kostos të terminimit të thirrjeve.
45. Cili është opinioni juaj mbi propozimin e AKEP për heqjen e masës rregullatore të detyrimit për mosdiskriminimin e thirrjeve On-Net vs Off-net në rrjetet mobile?
46. Lidhur me pyetjen e tretë, nga periudha në të cilën është vendosur kjo masë rregullatore situata e ndërmarrjeve që operojnë në treg ka ndryshuar qenësisht, ku nga katër ndërmarrje tashmë në treg kemi vetëm dy, One Albania SHA dhe Vodafone Albania SHA, pjesët e tregut të të

cilëve janë të përafërta për sa i përket numrit të pajtimtarëve, por pavarësisht në kushtet kur AKEP ende nuk ka realizuar një analizë të tregut të pakicës të tregut të telefonisë celulare për të ndërmarrë masat e nevojshme rregullatore për rregullimin e këtij tregu, vlerësohet se kjo masë rregullatorë duhet të jetë ende në fuqi.

47. Cili është opinioni juaj për opsionet e paraqitura nga AKEP për rregullimin në tregun e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në rrjetet celulare?
1. Përfshirja e terminimit të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në tregun përkatës të terminimit të thirrjeve (kombëtare), shpalljen FNT të të tre operatorëve dhe rregullimin e tarifave në mënyrë proporcionale me balancat in-out nga terminimi thirrjeve kombëtare dhe ndërkombëtare:
 - a. me të gjitha detyrimet si MTR kombëtare, përfshirë barazimin e MTR të dy lloj thirrjeve (menjëherë ose me glide path);
 - b. me detyrime të ndryshme për dy llojet e thirrjeve: vetëm me detyrim dhënie aksesi dhe mosdiskriminim për thirrjet ndërkombëtare.
 2. Me përkufizim si treg përkatës i veçantë (nga thirrjet kombëtare) i justifikuar për ndërhyrje ex-ante dhe FNT:
 - a. me të gjitha detyrimet si MTR kombëtare, përfshirë barazimin e MTR të dy lloj thirrjeve (menjëherë ose me glide path); me detyrime të ndryshme për dy llojet e thirrjeve: vetëm me detyrim dhënie aksesi dhe mosdiskriminim për thirrjet ndërkombëtare.
 3. Aplikimin e një reduktimi të veçantë nëpërmjet glide path edhe për terminimin e thirrjeve ndërkombëtare duke synuar në afat mesëm orientimin drejt MTR kombëtar;
 4. Lënie në derregullim siç është aktualisht.
48. Lidhur me pyetjen e katërt, kostot e terminimit të thirrjeve kombëtare dhe ndërkombëtare, janë thuajse të njëjta, pasi terminimi i thirrjeve hyrëse ndërkombëtare është një shërbim që kryhet në RSH.
49. Në dokumentin e nxjerrë nga AKEP për Këshillim Publik rezulton se pesha e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në totalin e thirrjeve të terminuara është reduktuar ndjeshëm për shkak rënies së trafikut hyrës ndërkombëtar, por edhe për shkak të rritjes së ndjeshme të trafikut off-net, por MTR ndërkombëtare gjatë vitit 2022 ka shënuar rritje krahasuar me vitet 2019 – 2021, periudhë gjatë të cilës ka qenë në nivelet më të ulëta, megjithatë, MTR e vitit 2022 (20.47 lek/minutë) është më e ulët se ajo e viteve 2015 – 2018. Edhe treguesi mesatar i ponderuar (kombëtar dhe ndërkombëtar) për vitin 2022 është 2.19 lek/minutë, gati dyfish më i lartë se MTR kombëtar (1.11 lek/minutë).
50. Autoriteti i Konkurrencës vlerëson se në këtë pikë, AKEP duhet të përdori praktikatat më të mira të vendeve të BE që rregullimi/de-rregullimi t'i shërbejë rritjes së konkurrencës dhe uljes

së tarifave, duke patur si qëllim parësor çmime të orientuara drejt kostos.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Ti rekomandojë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, si vijon:
 - i. Në kushtet e ndryshimeve strukturore të ndodhura në tregun e telefonisë celulare të realizojë analizën e tregut të pakicës të tregut të telefonisë celulare për të ndërmarrë masat e nevojshme rregullatore për rregullimin e këtij tregu.
 - ii. Për përcaktimin e tarifave të terminimit të implementojë metodologjinë e vendeve të BE duke patur si qëllim parësor çmime të orientuara drejt kostos.
- II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr.1049, Datë 16. 01. 2024

“PËR MBYLLJEN E PROCEDURËS SË HETIMIT THELLUAR NË TREGUN E PROKURIMIT PUBLIK NDAJ NDËRMARRJEVE RAIMONDO G.P SHPK DHE LI.BO-ALBANIA BRANCH SHPK DHE DHENIEN E DISA DETYRIMEVE NDËRMARRJEVE RAIMONDO G.P SHPK DHE LI.BO-ALBANIA BRANCH SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 16.01.2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Mbyllja e procedurës së hetimit thelluar në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe LI.BO-Albania Branch SHPK, dhe dhënien e disa detyrimeve ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe LI.BO-Albania Branch SHPK.

Bazë ligjore: Neni 24, germa (d), neni 43, pika 5 dhe neni 45 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Raportit të hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe LI.BO-Albania Branch SHPK;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi Raportin e hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe LI.BO-Albania Branch SHPK”;
- Shpjegimet e paraqitura nga ndërmarrja Raimondo G.P SHPK nëpërmjet shkresës nr. 36 prot., datë 10.01.2024 “Objeksione dhe shpjegime të “Raimondo GP SHPK” mbi konkluzionet në Raportin e Hetimit të Thelluar në tregun e Prokurimit Publik referuar protokollin Tuaj 373/29 del 22.12.20023”;
- Seancës dëgjimore të zhvilluar në datën 10.01.2024 me përfaqësues të ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe LI.BO-Albania Branch SHPK;

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi seancën dëgjimore të zhvilluar nga ndërmarrjet Raimondo G.P SHPK dhe LI.BO-Albania Branch SHPK;

VËREN SE:

I. Procedura e ndjekur

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës, Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) nëpërmjet shkresës nr. 1257/4 prot., datë 04.07.2023 (protokolluar pranë AK me nr. 373 prot., datë 06.07.2023) ka depozituar Vendimin nr. 555/2023 prot., datë 04.07.2023, “Urdhër për pezullimin e shqyrtimit të ankesave të paraqitura nga operatorët ekonomikë Li.BO-Albania Branch SHPK me nr.1250 prot., datë 31.05.2023 dhe Trakmar SHPK, me nr.1257 prot., datë 01.06.2023”.
2. Në mbështetje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 66 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe nenit 31, pika 3 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, nëpërmjet Vendimit nr. 555/2023, ka vendosur:
 - a) Të pezullojë shqyrtimin administrativ të operatorëve ekonomikë LI.BO-Albania Branch SHPK me nr. 1250 prot., datë 31.05.2023 dhe TrakMar SHPK me nr. 1257 prot., datë 01.06.2023 për procedurën e prokurimit “objekt “Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe dixhitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)”, me fondin limit 4,854,422 lekë pa TVSH që është zhvilluar në datë 05.05.2023 nga Autoriteti Kontraktor, Albanian Gas Services Company SHA.
 - b) T’i kërkojë Autoritetit të Konkurrencës fillimin e procedurës së hetimit administrativ lidhur me konstatimet e mësipërme dhe të informojë KPP në përfundim të hetimit mbi rezultatet e tij.
3. Nga vlerësimi i informacionit të paraqitur nga KPP, nëpërmjet vendimit nr. 555/2023, mbi shkeljet e pretenduara të konkurrencës nga ndërmarrjet LI.BO-Albania Branch SHPK dhe Raimondo G.P SHPK në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe dixhitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe

DCVG)”, të zhvilluara nga Autoriteti Kontraktor, Albanian Gas Services Company SHA, vihet re se:

- Operatori Raimondo G.P SHPK dhe operatori LI.BO-Albania Branch SHPK, kanë të njëjtën zyrë qendrore me adresë të përbashkët.
 - Gjithashtu sipas të dhënave në ekstrakt, të cilat njoftohen vullnetarisht rezulton se adresa e e-mailit dhe numri i telefonit fiks është i njëjtë për të dyja ndërmarrjet.
 - Ofertat e këtyre dy ofertuesve kanë një diferencë të vogël ndërmjet tyre;
 - Të dy operatorët nuk kanë plotësuar Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit në mbështetje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimit publik” dhe Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
4. Sa më sipër, ngrihen dyshime të arsyeshme se ndërmarrjet Raimondo G.P SHPK dhe LI.BO-Albania Branch SHPK përdorin skemën e ofertës së mbuluar duke rënë dakord më përpara se cili prej tyre do të paraqesë ofertën më të lartë dhe cili ofertën fituese në procedurën e prokurimit ku ata do të jenë pjesëmarrës, me qëllim që të kualifikohet ai që ka ofertën më të ulët, duke krijuar përshtypjen e një oferte të pastër dhe një konkurrence të sigurtë.
 5. Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4, nenin 24, germa (d), nenin 26 dhe nenin 42, pika 1 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” me Vendimin nr. 1000, datë 17.07.2023, vendosi për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - Albania Branch SHPK, për periudhën kohore nga 26 shtator 2022 deri në 17 korrik 2023.
 6. Bazuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës sa më sipër, ndërmarrjet nën hetim janë:
(i) ndërmarrja Raimondo G.P SHPK, regjistruar si person juridik në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar në datë 03.11.2021, me administrator dhe ortak të vetëm Znj. Lucia Raimondo dhe (ii) ndërmarrja Li.Bo - ALBANIA Branch SHPK, regjistruar si person juridik në formën e një dege të shoqërisë së huaj në datë 20.10.2022, me administrator dhe ortak të vetëm Z. Roberto Bocca.
 7. Në zbatim të Vendimit nr. 1000, datë 17.07.2023 dhe Autorizimit të Komisionit të Konkurrencës me nr. 373/3, datë 17.07.2023 “Autorizim inspektorësh”, Grupi i Inspektimit gjatë periudhës së hetimit kreu inspektimet e nevojshme pranë adresave të deklaruara në QKB të ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - Albania Branch SHPK. Me paraqitjen e inspektorëve në adresën e përbashkët të dy subjekteve, u konstatua se në këtë adresë operonte ndërmarrja Prime Advisory Albania SHPK.
 8. Ndërmarrja Prime Advisory Albania SHPK me objekt aktiviteti dhënien e asistencës sipërmarrësve dhe shoqërive në aktivitetin e menaxhimit të eksporteve në Shqipëri dhe jashtë vendit sidomos në ndërkombëtarizimin e bizneseve, është e kontraktuar nga ndërmarrjet

Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - Albania Branch SHP për shërbime konsulence dhe kontabiliteti.

9. Gjatë procedurës së inspektimit nuk u gjetën evidenca direkte për të vërtetuar ekzistencën e një marrëveshje të ndaluar midis ndërmarrjeve nën hetim sipas përcaktimit të nenit 4 të Ligjit nr. 9121/2003.
10. Ndërmarrja Raimondo G.P SHPK në datë 31.07.2023, dhe ndërmarrja Li.Bo - Albania Branch SHPK në datë 29.08.2023, janë paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës, ku janë pyetur nga Sekretariati për çështjen objekt hetimi.
11. Gjatë inspektimit dhe nga takimet e realizuara pranë Autoritetit të Konkurrencës, ka rezultuar se ndërmarrja Li.Bo në Itali është furnitor i ndërmarrjes Raimondo G.P SHPK.
12. Në përfundim të procedurës së hetimit paraprak, Komisioni i Konkurrencës vlerësoi se bazuar në nenin 4, pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, sipas të cilit ndalohen të gjitha marrëveshjet, që kanë si objekt, ose si pasojë pengimin, kufizimin ose shtrembërimin e konkurrencës në treg, si dhe Udhëzimin “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”, sjellja e ndërmarrjeve: Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - Albania Branch SHPK, në tregun e prokurimit me objekt “Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe digjitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)”, të zhvilluara nga autoriteti kontraktues, Albanian Gas Services Company SHA, ngre dyshime për kufizime të mundshme të konkurrencës nëpërmjet një marrëveshjeje të dyshimtë në oferta midis tyre.
13. Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 1026, datë 26.10.2023, vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - Albania Branch SHPK për periudhën 26 shtator 2022 deri në 26 tetor 2023.
14. Për sa më sipër, periudhat hetimore të përcaktuara nga Autoriteti i Konkurrencës shtrihen në një afat kohor të gjatë, për të pasur kështu mundësinë e analizës të sa më shumë procedurave prokurimi ku ndërmarrjet nën hetim kanë marrë pjesë. Në rastin konkret, për arsye se ndërmarrja Raimondo G.P SHPK është regjistruar pranë QKB në datë 03.11.2021 dhe ndërmarrja Li.Bo - ALBANIA Branch SHPK është regjistruar pranë QKB në datë 20.10.2022, Komisioni i Konkurrencës ka vlerësuar që periudha hetimore të jetë 26 shtator 2022 deri në 26 tetor 2023.

15. Bazuar në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës sa më sipër, ndërmarrjet nën hetim janë:
(i) ndërmarrja Raimondo G.P SHPK, regjistruar si person juridik në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar në datë 03.11.2021, me administrator dhe ortak të vetëm Znj. Lucia Raimondo dhe (ii) ndërmarrja Li.Bo - ALBANIA Branch SHPK, regjistruar si person juridik në formën e një dege të shoqërisë së huaj në datë 20.10.2022, me administrator dhe ortak të vetëm Z. Roberto Bocca
16. Për mbledhjen e fakteve dhe të dhënave të nevojshme në lidhje me hetimin, bazuar në nenin 33 të Ligjit nr. 9121/2003, u kërkuan të dhëna dhe informacion drejtuar Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor (Albanian Gas Service Company SHA).

II. Analiza e konkurrencës

II.1 Tregu përkatës

17. Në zbatim të Ligjit nr. 9121/2003, tregu përkatës përfshin tregun e produktit dhe tregun gjeografik.
18. Procedurat e prokurimeve publike kryhen në territorin e Republikës së Shqipërisë në përputhje me Ligjin nr. 162/2020. Ky ligj përcakton rregullat për procedurat e prokurimit nga autoritetet dhe entet kontraktore për kontratat publike dhe konkurset e projektimit. Prokurimi, sipas kuptimit të këtij ligji, është blerja e punëve, furnizimit të mallrave ose shërbimeve nëpërmjet një kontrate publike nga ana e një ose më shumë autoriteteve ose enteve kontraktore nga operatorët ekonomikë që zgjidhen nga këto autoritete ose ente kontraktore, pavarësisht nëse punët, furnizimet e mallrave ose shërbimet përdoren ose jo për qëllime publike.
19. Nga informacioni i marrë gjatë procedurës hetimore nga APP me shkresën nr. 373/8 prot., datë 31.07.2023, ndërmarrjet Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - Albania Branch SHPK, kanë marrë pjesë vetëm në procedurat e prokurimeve publike të autoritetit kontraktor Albanian Gas Service Company SHA.
20. Komisioni i Prokurimit Publik, nëpërmjet shkresës nr. 373 prot., datë 06.07.2023, i ka kërkuar Autoritetit të Konkurrencës fillimin e procedurës së hetimit administrativ për procedurën e prokurimit me nr. Ref. 66587-04-19-2023, dhe objekt “Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe digjitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)”, që është zhvilluar në datë 05.05.2023 nga autoriteti kontraktues, Albanian Gas Services Company SHA.
21. Nëpërmjet shkresës nr. 373/8 prot., datë 31.07.2023 të depozituar nga Agjencia e Prokurimit Publik pranë Autoritetit të Konkurrencës, janë sjellë të gjithë procedurat e prokurimit publik ku ndërmarrjet nën hetim kanë marrë pjesë. Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo – Albania Branch

SHPK kanë marrë pjesë vetëm në procedurat e prokurimit të hapura nga autoriteti kontraktues, Albanian Gas Service Company SHA. Nga 8 procedura ku ka marrë pjesë Raimondo G.P SHPK, në dy prej tyre, ka marrë pjesë edhe ndërmarrja Li.Bo – Albania Branch SHPK.

22. Gjatë periudhës kohore 26 shtator 2022 – 26 tetor 2023, ndërmarrjet Li.Bo - ALBANIA Branch SHPK dhe Raimondo G.P SHPK kanë marrë pjesë në dy procedura prokurimi së bashku:
 - i. Procedura e referuar nga KPP: “Procedurën e hapur” me nr. REF. 66587-04-19-2023, me objekt “Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe digjitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)”, me fondin limit 4,854,422 lekë pa TVSH, që është zhvilluar në datë 05.05.2023 nga autoriteti kontraktues, Albanian Gas Services Company SHA. Shpallur fitues Raimondo G.P SHPK.
 - ii. “Procedurën e hapur” me nr. REF-59646-02-20-2023, me objekt “Blerje vegla speciale”, me fondin limit, LOTI 2: 5,067,966 (pesë milion e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, që është zhvilluar në datë 08.03.2023 nga autoriteti kontraktues, Albanian Gas Services Company SHA (shpallur fitues një tjetër pjesëmarrës në procedurën e tenderit).
23. Referuar sa më sipër, tregu përkatës i produktit është tregu i prokurimit i veglave speciale dhe i pajisjeve, instrumenteve, veglave elektrike dhe digjitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG).
24. Tregu përkatës gjeografik përfshin zonën në të cilën ndërmarrjet janë përfshirë në ofertën dhe kërkesën e shërbimit, në të cilën kushtet e konkurrencës janë mjaftueshmërisht homogjene.
25. Ndërmarrjet pjesëmarrëse në këtë procedurë të prokurimit janë aktive në tregjet e produktit, nëpërmjet ofrimit të tyre, në territorin e Republikës së Shqipërisë. Si rrjedhojë, tregu gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë

III. Vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjeve

26. Vlerësimi i sjelljes së ndërmarrjeve, në tregun e prokurimit publik me objekt “Blerje vegla speciale dhe pajisje instrumente, vegla elektrike dhe digjitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)” është realizuar bazuar në metodologjinë e OECD “Mbi luftimin e marrëveshjeve të ndaluara në oferta në prokurimet publike”, si dhe Udhëzuesit të përshtatur sipas kësaj metodologjie të OECD, “Mbi Luftimin e Marrëveshjeve të Ndaluar në Oferta në Prokurimet Publike”.
27. Për vlerësimin e sjelljes së ndërmarrjeve është shqyrtuar i gjithë dokumentacioni i administruar dhe i paraqitur nga Albanian Gas Services Company SHA në rolin e autoritetit

kontraktues, nga APP dhe KPP si edhe dokumentacioni i gjetur gjatë procedurave të inspektimit në Li.Bo - ALBANIA Branch SHPK dhe Raimondo G.P SHPK në zyrën e ndërmarrjes Prime Advisory Albania SHPK.

28. Gjatë periudhës kohore 26 shtator 2022 – 26 tetor 2023, ndërmarrjet Li.Bo - ALBANIA Branch SHPK dhe Raimondo G.P SHPK kanë marrë pjesë në dy procedura prokurimi së bashku:

- i. Procedura e referuar nga KPP: “Procedurën e hapur” me nr. REF. 66587-04-19-2023, me objekt “Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe digjitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)”, me fondin limit 4,854,422 lekë pa TVSH, që është zhvilluar në datë 05.05.2023 nga autoriteti kontraktues, Albanian Gas Services Company SHA. Shpallur fitues Raimondo G.P SHPK.
- ii. “Procedurën e hapur” me nr. REF-59646-02-20-2023, me objekt “Blerje vegla speciale”, me fondin limit, LOTI 2: 5,067,966 (pesë milion e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, që është zhvilluar në datë 08.03.2023 nga autoriteti kontraktues, Albanian Gas Services Company SHA. Shpallur fitues një tjetër operator ekonomik pjesëmarrës në tender.

29. Ndërmarrjet pjesëmarrëse në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe digjitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)”, të zhvilluara nga autoriteti kontraktues, Albanian Gas Services Company SHA, ishin, si më poshtë:

- Li.Bo - Albania Branch	3.592.000 lekë, skualifikuar
- Raimondo G.P	3.640.000 lekë, kualifikuar
- TrakMar	3.640.000 lekë, kualifikuar
- Alen-Co	3.801.680 lekë, kualifikuar
- Ligus	4.100.000 lekë, kualifikuar
- Trinity Trade Company	4.198.000 lekë, kualifikuar

30. Ndërmarrja Li.Bo Albania Branch SHPK, renditur e para, është skualifikuar nga procedura e prokurimit me objekt “Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe digjitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)”, për arsye, si më poshtë vijon:

- Ka dorëzuar në SPE kopje të pa noterizuara dhe pa vulë apostile të faturave me nr. 3/517, 3/482, 3/65, 3/2827 në emër të kompanisë mëmë italiane LI.BO SRL.
- E njëjta gjë konstatohet edhe në Certifikatën për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001-2015.
- Nuk plotëson kriterin për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare, pasi nuk ka paraqitur dokument në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

31. Ndërmarrjet Li.Bo - ALBANIA Branch SHPK dhe Raimondo G.P SHPK kanë të njëjtën adresë, në të cilën kryen aktivitetin ndërmarrja Prime Advisory Albania SHPK. (i) Ndërmarrja Raimondo G.P ka një kontratë huapërdorje pa pagesë me ndërmarrjen Prime Advisory Albania SHPK, ku kjo e fundit i ofron një tavolinë dhe një kompjuter ndërmarrjes Raimondo G.P SHPK, që të përdoret si seli ligjore dokumentare e saj; (ii) Për ndërmarrjen Li.Bo - Albania Branch SHPK, Prime Advisory Albania SHPK ka lëshuar një deklaratë ku shprehet se Li.Bo - Albania Branch SHPK, degë e shoqërisë së huaj, ka selinë dokumentare pranë Prime Advisory Albania SHPK.
32. Faktet e mësipërme përbëjnë dhe elementin kryesor mbi të cilin ngrihet dyshimi se ndërmarrjet mund të përdorin skemën e ofertës së mbuluar duke rënë dakord që njëri nga konkurrentët të paraqesë një ofertë e cila përmban terma specifike të cilat janë të papranueshme nga autoriteti kontraktues.
33. Gjatë inspektimit, rezultoi se ndërmarrjet Li.Bo - ALBANIA Branch SHPK dhe Raimondo G.P SHPK kanë të njëjtën adresë, në të cilën kryen aktivitetin ndërmarrja Prime Advisory Albania SHPK. Kjo ndërmarrje ka për objekt veprimtarie dhënien e asistencës për sipërmarrës dhe shoqëri në aktivitetin e tyre dhe ndërmarrjet Li.Bo - ALBANIA Branch SHPK dhe Raimondo G.P SHPK janë klientë të saj.
34. Ndërmarrja Raimondo G.P ka një kontratë huapërdorje pa pagesë me ndërmarrjen Prime Advisory Albania SHPK ku kjo e fundit i ofron një tavolinë dhe një kompjuter ndërmarrjes Raimondo G.P SHPK, që të përdoret si seli ligjore dokumentare e saj.
35. Për ndërmarrjen Li.Bo - Albania Branch SHPK, Prime Advisory Albania SHPK ka lëshuar një deklaratë ku shprehet se, Li.Bo - Albania Branch SHPK, degë e shoqërisë së huaj, ka selinë dokumentare pranë Prime Advisory Albania SHPK.
36. Nëpërmjet shkresës nr. 373/13 prot., datë 28.08.2023 (protokolluar pranë Autoritetit të Konkurrencës, dërguar nga ndërmarrja AGSCo SHA), grupi i punës ka verifikuar DST që ka dërguar secili operator ekonomik që ka marrë pjesë në procedurën me referencë REF: 66587-04-19-2023. Të dyja ndërmarrjet kanë nga 29 dokumente secila, dokumente që kanë shërbyer për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit. Nga verifikimi i tyre rezultojnë me disa elementë të ngjashëm:
- Lista e çmimeve të artikujve.
 - Formulari i Ofertës.
 - Dy ekstrakte QKB për secilën ndërmarrje, të cilat janë printuar të dyja në të njëjtën datë por në orare të ndryshme.
 - Tabelat që ndërmarrjet kanë përdorur për të ofertuar produktet janë të ngjashme, tabela e

ndërmarrjes Li.Bo përkatësisht e titulluar “CIPS & DCVG table for tender” dhe tabela e ndërmarrjes Raimondo e titulluar “CIPS & DCVG table for tender”.

- Për noterizimin e Certifikatës ISO, të dy ndërmarrjet kanë vajtur tek e njëjta notere, Belinda V. Celaj, por në data të ndryshme.

37. Ndërmarrjet pjesëmarrëse në procedurën e prokurimit me objekt: “Loti 2- Vegla Speciale”, të zhvilluara nga autoriteti kontraktues, Albanian Gas Services Company SHA, ishin si më poshtë:

- Raimondo G.P	3.984.750 lekë, kualifikuar
- AZ Trading	3.802.000 lekë, kualifikuar
- TrakMar	4.297.530 lekë, kualifikuar
- Vibtis	4.561.200 lekë, kualifikuar
- Alen-Co	4.873.470 lekë, kualifikuar
- Li.Bo - Albania Branch	3.974.000 lekë, kualifikuar

38. Njëpërmjet shkresës nr. 373/13 prot., datë 28.08.2023 (protokolluar pranë Autoritetit të Konkurrencës, dërguar nga ndërmarrja AGSCo SHA), grupi i punës ka verifikuar DST që ka dërguar secili operator ekonomik që ka marrë pjesë në procedurën me referencë REF: 66646-04-19-2023. Ndërmarrja Li.Bo Albania Branch ka bërë pjesë të procedurës së tenderit 26 dokumente ndërsa ndërmarrja Raimondo GP ka patur 23 dokumente që kanë shërbyer për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit. Nga verifikimi i tyre rezultojnë me disa elementë të ngjashëm:

- Formulari i Ofertës: Të dyja ndërmarrjet Li.Bo dhe Raimondo kanë të njëjtin gabim gramatikor në fillimin e paragrafit të dytë të Formularit të Ofertës, ku të dyjave i mungon e njëjta shenjë pikësimi dhe gjithashtu formatimi, fonti, stili dhe madhësia e shkrimit janë të njëjta.
- Lista e çmimeve të artikujve: Të dyja ndërmarrjet Li.Bo dhe Raimondo kanë të njëjtin formatim, fonti, stili dhe madhësia e shkrimit janë të njëjta .
- Sigurimi i Ofertës: Të dyja ndërmarrjet Li.Bo dhe Raimondo e kanë bërë sigurimin e ofertës te ndërmarrja Sigma Interbalkan dhe numri serial i policave është i njëpasnjëshëm, përkatësisht për Raimondo GP nr. i policës është 3914 dhe për Li.Bo nr. i policës është 3915.
- Kontratë Shërbimi: Të dyja ndërmarrjet Li.Bo dhe Raimondo kanë lidhur kontratë shërbimi për sistemin devPos me të njëjtën ndërmarrje Image & Communication Development SHPK.
- Deklaratë e Energjisë Elektrike: Subjekti Prime Advisory Albania SHPK ka deklaruar për të dyja ndërmarrjet Li.Bo dhe Raimondo në të njëjtën datë 01.03.2023, se ato kanë selinë qendrore dokumentare pranë zyrës së tij dhe për këtë arsye për të plotësuar

Kriteret e Përgjithshme të tenderit deklarohet se Prime Advisory Albania ka kryer të gjitha pagesat kundrejt FSHU.

- vi. Formulari i Sasisë dhe Grafikut të Lëvrimit: Të dyja ndërmarrjet Li.Bo dhe Raimondo kanë depozituar Shtojcën 6, e cila është e njëjtë për të dyja ndërmarrjet.
- vii. Formulari i Specifikimeve Teknike: Të dyja ndërmarrjet Li.Bo dhe Raimondo kanë depozituar Shtojcën 5, të cilat janë të njëjta.

39. Nëpërmjet informacionit të administruar gjatë procedurës së hetimit të thelluar nga ndërmarrja Raimondo GP SHPK vihet re se flitet shpesh edhe në emër të ndërmarrjes Li.Bo Branch SHPK duke nënkuptuar një lloj dakordësie mes dy palëve, e cila në kuptim të nenit 4 të Ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, ngre dyshime për kufizime të mundshme të konkurrencës në të shkuarën ose në të ardhmen.

40. Në procedurën e hapur me objekt “Loti 2- Blerje vegla speciale”, asnjë nga ndërmarrjet në hetim nuk është shpallur fituese nga autoriteti kontraktor dhe si rrjedhojë sjellja e dy ndërmarrjeve nuk ka sjellë pasoja në konkurrencë në tregun e prokurimeve publike. Ndërsa procedura e hapur me objekt “Blerje pajisje instrumente, vegla elektrike dhe digjitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)”, është ndërprerë për shkak të ankesës të pranuar nga KPP, dhe si rrjedhojë sjellja e dy ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - ALBANIA Branch SHPK, nuk ka arritur të finalizohet duke mos u shpallur fitues asnjëri prej tyre.

41. Në vijim të konstatimeve nga Autoriteti i Konkurrencës lidhur me:

- i. Ndërmarrjet Rajmondo GP SHPK dhe Li.Bo Albania Branch SHPK kanë të njëjtën seli ligjore, të njëjtën adresë e-maili dhe numër telefoni.

Lidhur me këtë konstatim, gjatë seancës dëgjimore është shpjeguar se pasja e një selie ligjore dhe një adrese e-mail dhe numër telefoni ka ardhur si pasojë e kontraktimit të ndërmarrjes Prime Advisory Albania SHPK për shërbimet e konsulencës dhe kontabilitetit. Ndërmarrjet kanë shpjeguar se janë lënë kontaktet e Prime Advisory për shkak se komunikimet duhet të ishin në gjuhën shqipe dhe përfaqësuesit e ndërmarrjeve nuk e njohin gjuhën shqipe. Vetë Prime Advisory Albania SHPK kryen shërbimet e konsulencës dhe kontabilitetit për disa ndërmarrje të huaja.

- ii. Ndërmarrjet Rajmondo GP SHPK dhe Li.Bo Albania Branch SHPK kanë disa dokumenta që rezultojnë me elementë të ngjashëm.

Lidhur me këtë konstatim, ndërmarrjet kanë shpjeguar gjatë seancës dëgjimore se përkthimet kanë kërkuar ndihmën e Prime Advisory Albania, noterizimet janë kryer tek noteri i ndërmarrjes ku

Prime Advisory referohet për procedura të ndryshme dhe dokumentacioni nga të tretë si sigurimi i ofertës, ekstraktet e QKB, etj., janë gjeneruar po nga ndërmarrja Prime Advisory Albania. Por dokumentacioni i lidhur me shumën e ofertuar është bërë në mënyrë të pavarur nga secila ndërmarrje.

- iii. Informacioni i administruar gjatë procedurës së hetimit të thelluar nga ndërmarrja Raimondo GP SHPK, e cila flet dhe në emër të ndërmarrjes Li.Bo Branch SHPK.

Lidhur me këtë konstatim, ndërmarrja Raimondo GP SHPK në seancë dëgjimore ka shpjeguar se nuk ka folur në emër të Li.Bo Branch SHPK, por vetëm i është referuar si një ndërmarrje e lidhur në këtë proces hetimor.

42. Sa më sipër, për shkak të mënyrës se si ndërmarrjet Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - ALBANIA Branch SHPK kryejnë aktivitetin në Shqipëri, duke qenë se Li.Bo ka qenë furnitor i Raimondo G.P SHPK si dhe gjithashtu për shkak se gjatë procedurës së inspektimit nuk janë gjetur evidenca direkte, për të vërtetuar ekzistencën e një marrëveshje të ndaluar midis ndërmarrjeve, Komisioni i Konkurrencës vlerëson se, me gjithë ekzistencën e dyshimeve, nuk ka prova të mjaftueshme që të krijojnë bindjen e plotë që në tregun e prokurimit me objekt “Blerje vegla speciale dhe pajisje instrumente, vegla elektrike dhe digjitale (pajisje për kontrollin dhe matjen e mbrojtjes katodike CIPS dhe DCVG)”, ndërmarrjet Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo – ALBANIA të ketë shkelje të nenit 4, pika 1 të Ligjit nr. 9121/2003.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në, nenin 24, germa (d), neni 43, pika 5 dhe nenin 45 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik ndaj ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - Albania Branch SHPK.
- II. Detyrimin e ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - Albania Branch SHPK që brenda 90 ditëve të realizojnë ndryshimet përkatëse për të kryer një aktivitet të pavarur nga njeri tjetri dhe konkretisht:
 - i. Të ndryshojnë selinë e ushtrimit të aktivitetit;
 - ii. Të kenë adresa e-mail dhe numra telefoni të pavarur nga njëri tjetri;

III. Detyrimin e ndërmarrjeve Raimondo G.P SHPK dhe Li.Bo - Albania Branch SHPK që kur marrin pjesë individualisht në procedurat e prokurimit publik të ofertojnë në mënyrë të pavarur.

IV. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1050 , Datë 25. 01. 2024

“ MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË ILI (HIGHLANDS PSH) LIMITED NGA SHOQËRIA STATKRAFT UK LTD”.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 25.01.2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë ILI (Highlands PSH) Limited nga shoqëria Statkraft UK Ltd.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë ILI (Highlands PSH) Limited nga shoqëria Statkraft UK Ltd.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Nëpërmjet shkresës nr. 668, datë 15.11.2022 “Njoftim përqendrimi dhe kërkesë për autorizim të përqendrimit të përkohshëm”, Autoriteti i Konkurrencës u njoftuar se shoqëria Statkraft UK Ltd synonte të blinte aksionet e shoqërisë ILI (Highlands PSH) Limited.

Bazuar në nenin 60 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe në kërkesën e palës njoftuese për pajisjen me autorizim të përqendrimit të përkohshëm, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës, me vendimin nr. 925, datë 21.11.2022, “Mbi autorizimin e

përqendrimit të përkohshëm të realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërisë ILI (Highlands PSH) Limited nga shoqëria Statkraft UK Ltd”, vendosi:

1. Të autorizojë përkohësisht përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërisë ILI (Highlands PSH) Limited nga shoqëria Statkraft UK Ltd.
2. Autorizimi i përqendrimit të përkohshëm do të jetë i vlefshëm deri në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes nga palët në transaksion.
3. Pala njoftuese ka detyrimin të depozitojë pranë Autoritetit të Konkurrencës, marrëveshjen e nënshkruar nga palët pjesëmarrëse në transaksion, pas të cilës Sekretariati do të fillojë procedurën e kontrollit të përqendrimeve bazuar në nenet 53-64 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Me shkresën nr.716 datë 18.12.2023 “Njoftim përqendrimi dhe kërkesë për autorizim të përqendrimit”, Autoriteti i Konkurrencës u njoftua se shoqëritë Statkraft UK Ltd dhe ILI Pump Storage Hydro P.L.C. kanë nënshkruar marrëveshjen për shitblerjen e kuotave të shoqërisë ILI (Highlands PSH) Limited.

Referuar dokumentit “Marrëveshja për Shitblerjen e Kuotave”, datë 14 dhjetor 2023, palët pjesëmarrëse në transaksion janë:

Pala blerëse: Statkraft UK Ltd është një shoqëri private e kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Anglisë dhe Uellsit, me ortak të vetëm shoqërinë Statkraft AS.

Statkraft UK Ltd është një shoqëri e zotëruar 100% nga Statkraft AS (shoqëria mëmë e Grupit Statkraft), një shoqëri lider në sektorin e hidroenergjisë dhe aktori më i madh i hidroenergjisë së rinovueshme në Evropë.

Grupi Statkraft është i pranishëm në Shqipëri, nëpërmjet filialeve të zotëruara tërësisht nga shoqëria Statkraft Markets B.V: Statkraft Renewables Albania SHPK dhe Devoll Hydropower SHA, të cilët operojnë në tregun e prodhimit të energjisë elektrike

Shoqëria Target: ILI (Highlands PSH) Limited është një shoqëri private e kufizuar, e themeluar sipas Ligjit të Shoqërive të Skocisë, me objekt aktiviteti: prodhimi i energjisë së rinovueshme, ruajtja e energjisë elektrike dhe hidrocentralet me pompa. Shoqëria ILI (Highlands PSH) Limited zotërohet 100% nga shoqëria ILI Pump Storage Hydro P.L.C.

Target nuk është prezent dhe nuk gjeneron xhiro në Shqipëri.

Pala shitëse: ILI Pump Storage Hydro P.L.C., është një shoqëri publike e kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Skocisë.

II. Përqendrimi

Më datë 14 dhjetor 2023 është nënshkruar “Marrëveshja për Shitblerjen e Kuotave”, lidhur me shitblerjen e gjithë kapitalit të shoqërisë ILI (Highlands PSH) Limited, mes shoqërive Statkraft

UK Ltd, në cilësinë e blerësit dhe ILI Pump Storage Hydro P.L.C., në cilësinë e shitësit.

Kuotat në shitje përbëjnë tërësinë e kapitalit aksionar të ndarë dhe të emetuar të shoqërisë dhe janë paguar plotësisht (ose kreditohen si të paguara plotësisht).

Shitësi është pronar i vetëm i kuotave në shitje dhe ka të drejtën për të transferuar titullin e Kuotave në shitje kundrejt blerësit sipas kushteve të përcaktuara në këtë marrëveshje.

Transaksioni i propozuar konsiston në blerjen e kuotave në shoqërinë ILI (Highlands PSH) Limited nga shoqëria Statkraft UK Ltd.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e Konkurrencës

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i prodhimit të energjisë elektrike nga burime hidrike dhe magazinimi i saj, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Statkraft UK Ltd dhe ILI (Highlands PSH) Limited janë aktivë në tregun e zhvillimit të projekteve të energjisë hidrike në Mbretërinë e Bashkuar. Investimi i Statkraft në projektin e hidrocentralit me pompim, që zotëron shoqëria target, konsiderohet një aset me rëndësi për magazinimin e energjisë për një kapacitet të instaluar prej 450 MW dhe kapacitet magazinimi prej 2900 GWh (e barabartë me 6.5 orë të plota ngarkese) në një zonë të Skocisë, ku projektet e fermave të energjisë së rinovueshme kanë marrë zhvillim në vitet e fundit.

Për pasojë, projekti do të mbështesë dhe do të ofrojë furnizimin me energji elektrike në rrjet, në kohën kur gjenerimi i energjisë është i ulët dhe kërkesa për konsum është e lartë.

Targeti nuk është prezent dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I.** Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit të shoqërisë ILI (Highlands PSH) Limited nga shoqëria Statkraft UK Ltd.
- II.** Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1051 , Datë 25. 01. 2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT NË SHOQËRINË MIDOCEAN HOLDINGS II L.P DHE INDIREKT NË SHOQËRINË MIDOCEAN ENERGY, LLC NGA SHOQËRITË ARAMCO OVERSEAS COMPANY B.V DHE EIG MANAGEMENT COMPANY, LLC”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 25.01.2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfhtimit të kontrollit të përbashkët në shoqërinë MidOcean Holdings II L.P dhe indirekt në shoqërinë MidOcean Energy, LLC nga shoqëritë Aramco Overseas Company B.V dhe EIG Management Company, LLC.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfhtimit të kontrollit të përbashkët në shoqërinë MidOcean Holdings II L.P dhe indirekt në shoqërinë MidOcean Energy, LLC nga shoqëritë Aramco Overseas Company B.V dhe EIG Management Company, LLC,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës u depozitua njoftimi mbi përfhtimin e kontrollit të përbashkët në

shoqërinë MidOcean Holdings II L.P dhe indirekt në shoqërinë MidOcean Energy, LLC nga shoqëritë Aramco Overseas Company B.V dhe EIG Management Company, LLC.

Referuar marrëveshjeve, palët në transaksion janë:

Pala blerëse:

- Aramco Overseas Company B.V. është një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Hollandës, me objekt veprimtarie: Dizenjim teknik dhe konsulencë inxhinierike etj., shoqëri holding (jo-financiare) dhe shoqëri pjesëmarrëse.

Aramco Overseas Company B.V. zotërohet plotësisht nga ortaku i vetëm Saudi Arabian Oil Company (Saudi Aramco), një shoqëri aksionare e themeluar nëpërmjet Dekretit Mbretëror nr. M/8 i Arabisë Saudite me objekt aktiviteti: Shoqëri e angazhuar kryesisht në kërkimin, eksplorimin, shpimin dhe nxjerrjen e substancave hidrokarbure dhe përpunimin, prodhimin, rafinimin dhe tregtimin e këtyre substancave.

Aramco Overseas Company B.V., për qëllime të transaksionit të synuar, ka krijuar shoqërinë Aramco InvestCo LP, një partneritet i kufizuar skocez.

Saudi Arabian Oil Company nuk ka asnjë entitet ose aktivitet të regjistruar në Shqipëri, por realizon xhiro në Shqipëri përmes tregtimit dhe shitjes së hidrokarbureve dhe lëndëve të tjera derivate.

- EIG Management Company, LLC është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Delaware. EIG Management Company, LLC është administratori ose zotëruesi në mënyrë direkte ose indirekte i subjekteve që menaxhojnë ose këshillojnë fondet, llogaritë, automjetet ose kompanitë e bashkuara duke përfshirë MidOcean Holdings II L.P.

EIG Management Company, LLC dhe filialet e saj nuk kanë asnjë aktivitet investimi dhe asnjë aktivitet biznesi në Shqipëri.

Shoqëritë target:

- MidOcean Holdings II L.P është një partneritet i kufizuar i fondeve private, i regjistruar sipas legjislacionit Skocez, për qëllime të transaksionit të propozuar.

- MidOcean Energy, LLC është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Delaware, aktualisht e zotëruar indirekt nga fondet e kontrolluara nga EIG Management Company, LLC nëpërmjet MidOcean Holdings L.P. MidOcean Energy, LLC ka për objekt aktiviteti tregtar gazin natyror të lëngshëm LNG.

MidOcean Energy, LLC nuk ka pasur deri më tani asnjë aktivitet biznesi në Shqipëri.

II. Përqendrimi

Ndërmjet palëve pjesëmarrëse, në transaksionin e propozuar është lidhur “Marrëveshje Aderimi”,

nënkruar më datë 06 tetor 2023, “Marrëveshje e Partneritetit të Kufizuar e Ndryshuar dhe Riformular për shoqërinë MidOcean Holdings II L.P.”, datë 27 shtator 2023 dhe “Letër Marrëveshje Investimi në MidOcean Holdings II L.P.”, nënkruar më datë 27 shtator 2023 dhe “Marrëveshje e Partneritetit të Kufizuar e Ndryshuar dhe Riformular për shoqërinë MidOcean Energy LLC”, datë 27 shtator 2023.

Transaksioni i propozuar konsiston në dy faza:

- *Faza 1:* Saudi Aramco do blejë përafërsisht 24.3% të kapitalit aksionar në MidOcean Holdings II, shoqëria mëmë që në mënyrë indirekte kontrollon MidOcean Energy, LLC, në këmbim të financimit nga Saudi Aramco, i cili do të përdoret për të bashkëfinancuar blerjet nga shoqëria MidOcean Energy, LLC të aksioneve të pakicës në disa projekte australiane LNG. Që në fazën e parë, Saudi Aramco do të përfitojë kontrollin e përbashkët së bashku me shoqërinë EIG Management Company, LLC mbi shoqërinë MidOcean Energy, LLC.
- *Faza 2:* Saudi Aramco mund të ofrojë një pjesëmarrje shtesë në kapitalin aksionar të MidOcean Holdings II, çka do të sjellë zotërim indirekt deri në 49% të kapitalit të shoqërisë MidOcean Energy, LLC, bazuar në përqindjen e kapitalit të saj të financuar. Gjatë fazës së dytë nuk do të ketë asnjë ndryshim në cilësinë e kontrollit të ushtruar mbi shoqërinë MidOcean Energy, LLC dhe Saudi Aramco dhe EIG Management Company, LLC do të vazhdojnë të ushtrojnë kontroll të përbashkët mbi shoqërinë MidOcean Energy, LLC.

Gjatë fazës së dytë, MidOcean Energy, LLC synon të bëjë investime shtesë për LNG.

Sipas parashikimeve në këto Marrëveshje EIG Management Company dhe Saudi Aramco do të ushtrojnë kontroll të përbashkët mbi shoqërinë MidOcean Energy LLC.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i synuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e Konkurrencës

Sipas nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu për kërkimin e gazit natyror dhe tregu për furnizimin me shumicë në rrjedhën e sipërme të gazit natyror, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur.

Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Aramco Ocerseas Company B.V. ka objekt veprimtarie dizenjimin teknik dhe konsulencën inxhinierike etj., shoqëri holding (jo-financiare) dhe shoqëri pjesëmarrëse, duke u ofruar filialeve të saj në grupin global të kapitalit të naftës dhe gazit, një gamë të gjerë shërbimesh, duke përfshirë shërbimet e mbështetjes financiare, menaxhimin e zinxhirit të furnizimit, shërbime të mbështetjes

teknike dhe një sërë shërbimesh mbështetëse administrative.

EIG Management Company, LLC është një investitor institucional kryesor në sektorët globalë të energjisë dhe infrastrukturës, e specializuar në investimet private në energji dhe infrastrukturën e lidhur me energjinë në baza globale.

MidOcean Energy, LLC, ka për objekt aktiviteti tregtar gazin natyror të lëngshëm LNG, studimin dhe hulumtimin e tregut, off-take dhe tregtimin.

Saudi Arabian Oil Company nuk ka asnjë entitet ose aktivitet të regjistruar në Shqipëri, por realizon xhiro në Shqipëri përmes tregimit të hidrokarbureve dhe lëndëve të tjera derivate.

EIG Management Company, LLC dhe filialet e saj nuk kanë asnjë aktivitet investimi dhe asnjë aktivitet biznesi, si dhe nuk kanë gjeneruar të ardhura në Shqipëri për vitin 2022.

MidOcean Energy, LLC, nuk ka pasur deri më tani asnjë aktivitet biznesi në Shqipëri dhe aktualisht nuk ka plane të bëhet aktive në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të përbashkët në shoqërinë MidOcean Holdings II L.P dhe indirekt në shoqërinë MidOcean Energy, LLC nga shoqëritë Aramco Overseas Company B.V dhe EIG Management Company, LLC.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr.1052, Datë 25. 01. 2024

“PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT TË KONKURRENCËS Nr.1045 DATË 29.12.2023 “PËR HAPJEN E HETIMIT TË THELLUAR NDAJ NDËRMARRJEVE ERZENI SHPK,GJIROFARMA SHA, ADG SHPK(LUFRA),SHAKA BOBOSHTICË SHPK NË TREGUN E PRODHIMIT DHE TREGTIMIT ME SHUMICË TË NËNPRODUKTEVE TË QUMËSHTIT(DJATHË DHE GJALPË)”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 25.01.2024 ,shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr.1045 datë 29.12.2023 “Për hapjen e hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve Erzeni SHPK, Gjirofarma SHA, ADG SHPK (Lufra), SHAKA Boboshticë SHPK në tregun e prodhimit dhe tregtimit me shumicë të nënprodukteve të qumështit(djathë dhe gjalpë)”.

Bazë ligjore: Neni 4, neni 9, neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe neni 43 i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (Ligji nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës, “Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr.1045 datë 29.12.2023 “Për hapjen e hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve Erzeni SHPK, Gjirofarma SHA, ADG SHPK (Lufra), SHAKA Boboshticë SHPK në tregun e prodhimit dhe tregtimit me shumicë të nënprodukteve të qumështit(djathë dhe gjalpë)”.

VËREN SE:

1. Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr.1045 datë 29.12.2023 “Për hapjen e hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve Erzeni SHPK, Gjirofarma SHA, ADG SHPK (Lufra), SHAKA Boboshticë SHPK në tregun e prodhimit dhe tregtimit me shumicë të nënprodukteve të qumështit (djathë dhe gjalpë)” vendosi hapjen e hetimit të thelluar në këtë treg për periudhën kohore nga 1 janar 2022 deri në 31 Dhjetor 2023, për të vlerësuar nëse sjellja e ndërmarrjeve

me pjesë të konsiderueshme tregu, Erzeni SHPK, Gjiofarma SHA, ADG SHPK (Lufra), SHAKA Boboshticë SHPK, mund të përbëjë abuzim me pozitë dominuese sipas nenit 9 të ligjit nr. 9121/2003 si dhe raporti i hetimit të thelluar duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 6 (dy) muaj nga dita e çeljes së këtij hetimi.

2. Në vijim të procedurës u realizuan inspektimet në ndërmarrjet Shaka Boboshticë SHPK në datë 09.1.2024, Erzeni SHPK në datë 9.01.2024, Gjiofarma SHA në datën 11.1.2024 dhe ADG (Lufra) SHPK në datë 12.01.2024. Gjithashtu, me qëllim grumbullimin e informacionit për vlerësimin e plotë të situatës me tregun përkatës i është kërkuar informacion në lidhje me qumështin e importuar DPD dhe MBZHR. Ndërsa në lidhje mbi prodhimin dhe xhiron e ndërmarrjeve në tregun përkatës u është kërkuar informacion AKU dhe DPT, si dhe është përgatitur kërkesë për informacion për ndërmarrjet objekt hetimi.
3. Duke marr shkas nga disa njoftime në media në ditët e fundit, blegtoret shqiptarë, sidomos ata të zonave të Vlorës, Gjirokastrës, Sarandës, Delvinës, Tepelenës, Përmetit, Fierit, dhe të tjerë nëpër vend, kanë nisur një valë protestash konkretisht në datën 09.1.2023 në Kotë të Vlorës, në datën 22.01.2023 në zonën Kardhiq të Gjirokastrës, për cmimin e blerjes së qumështit nga ana e grumbulluesve dhe fabrikave përpunuese të qumështit.
4. Në datën 23.1.2023 në protestën e realizuar nga blegtorët e zonës së Levanit në Fier, përfaqësues të AK realizuan takim me blegtorët për problematikat e ndryshme në lidhje me prodhimin dhe grumbullimin e qumështit kryesisht të qumështit të deles.
5. Fermeret / blegtorët gjatë takimit të realizuar pretendojnë se:
 - Çmimi i blerjes së qumështit të deles është i caktuar dhe komunikuar nga grumbulluesit ose njesitë e grumbullimit të fabrikave përpunuese. Çaktimi në mënyre të drejtpërdrejtë të të blerjes ose të shitjes, është sjellje e cila bie në kundërshtim me nenin 4 të ligjit nr.9121/2003”Për mbrojtjen e konkurrencës”.
 - Refuzim i blerjes së qumështit nga të gjitha fabrikat e përpunimit të cilat janë pjesë e shoqatës së IPQ, nëse fermeri nuk pranon cmimin e caktuar nga njëri prej grumbulluesve/fabrikat e përpunimit. Gjithashtu fermeret pretendonin se fabrikat e përpunimit të qumështit nuk pranojnë depozitimin e qumështit të fermerëve me pretendimin se nuk kanë kapacitete të lira magazinimi duke refuzuar mbledhjen dhe blerjen e qumështit në këtë sezon. Kjo sjellje bie në kundërshtim me nenin 9 pika a dhe c, “abuzimi me pozitën dominuese” të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
6. Bazuar sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës çmon se realizimi i plotë i procedurave të hetimit të thelluar me qëllim analizimin e sjelljes së ndërmarrjeve në treg, është i domosdoshëm për të siguruar një vendimmarrje objektive për të evidentuar nëse ka apo jo shenja të kufizimit,

shtrembërimin apo pengimin të konkurrencës dhe në rast konstatimi të shkeljeve do të marrë masat përkatëse në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9121 dt. 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 4 dhe 9, nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 43 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

- I. Zgjatjen e periudhës kohore përcaktuar në pikën “II”, të vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr.1045 datë 29.12.2023 “Për hapjen e hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve Erzeni SHPK, Gjiofarma SHA, ADG SHPK (Lufra), SHAKA Boboshticë SHPK në tregun e prodhimit dhe tregtimit me shumicë të nënprodukteve të qumështit(djathë dhe gjalpë)”, me 6 (gjashtë) muaj duke përfshirë periudhën 1 janar 2024 deri në 30 qershor 2024.
- II. Shtyrjen e afatit të përcaktuar në pikën “III”, të vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr.1045 datë 29.12.2023 “Për hapjen e hetimit të thelluar ndaj ndërmarrjeve Erzeni SHPK, Gjiofarma SHA, ADG SHPK (Lufra), SHAKA Boboshticë SHPK në tregun e prodhimit dhe tregtimit me shumicë të nënprodukteve të qumështit(djathë dhe gjalpë)” me 3 (tre) muaj nga marrja e këtij vendimi.
- III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1053 , Datë 02. 02. 2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT ME FUNKSIONE TË PLOTA NGA SHOQËRITË AGNA SH.A; LARTI – SHPK DHE FIX PRO SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 02.02.2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti:

Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota nga shoqëritë AGNA SH.A, LARTI – SHPK dhe FIX PRO SHPK.

Baza Ligjore:

Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimit “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota nga shoqëritë AGNA SH.A, LARTI – SHPK dhe FIX PRO SHPK,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës u depozitua njoftimi mbi krijimin e një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota nga shoqëritë AGNA SH.A, LARTI – SHPK dhe FIX PRO SHPK.

Referuar dokumentacionit të depozituar, palët në transaksion janë:

Pala 1: AGNA SHA është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: import-export të mallrave industriale e ushqimore, materiale ndërtimi, prodhime bujqësore dhe blegtorale, prodhim e shitje pije alkolike; në fushën e investimit në ndërtim, në fushën e shitblerjes së trojeve për ndërtim, për turizëm, fshatra turistike, moteleri dhe hoteleri; tregtim import - eksport i produkteve dhe nënprodukteve të duhanit; shitblerje, marrje ose dhënie me qera të pasurive të paluajtshme dhe atyre të luajtshme; veprimtari trajnuese dhe certifikuese të punonjësve të administratës publike, punonjësve të institucioneve arsimore; auditimi, mbikëqyrja dhe certifikimi i zbatimit të standarteve ndërkombëtare për institucionet në përgjithësi dhe/ose personelin e tyre në veçanti etj.

Shoqëria AGNA SHA kontrollohet nga z. Kristo Naçi me 30% të aksioneve, z. Aleksandër Naçi me 5% të aksioneve, z. Kosta Sotiri me 32.5% të aksioneve dhe z.Vasil Naçi me 32.5% të aksioneve.

Sipas të dhënave të QKB shoqëria AGNA SHA zotëron kuota në shoqëri të cilat operojnë në tregun e prodhimit të energjisë elektrike; në tregun e ndërtimit dhe në tregun e hotelarisë.

Pala 2: LARTI - SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: import-eksport dhe tregtim i artikujve të ndryshëm; transport i mallrave të të gjitha llojeve; punime druri, zdrukhtarie, mobilje, orendi, ndërtim i objekteve të ndryshme bujqësore, industriale e godina banimi etj.; grumbullim, përpunim, tregtim skrap hekuri dhe metalesh me ngjyra; punime elektrike të objekteve industriale dhe civile etj.

Shoqëria LARTI - SHPK zotërohet 50% nga z. Astrit Isa dhe 50% nga z. Luan Larti dhe shoqëria nuk kontrollon në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë shoqëri të tjera.

Pala 3: FIX PRO SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti prodhim sallami dhe nënprodukte ushqimore, import-eksport, tregti me shumicë e pakicë e mishit dhe nënprodukteve të tij; bar-kafe, restorant, hoteleri; suport teknik me forcë punëtore; prodhim dhe tregtim energjie; shpërndarje, delivery & take away etj.

FIX PRO SHPK zotërohet 100% nga z. Nesti Tarusha dhe shoqëria nuk kontrollon në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë shoqëri të tjera.

Ndërmarrje e Përbashkët (JV): Shtëpia e Pritjes SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti investime në fushën e ndërtimit duke përfshirë të gjitha llojet e ndërtimeve që kanë lidhje me fshatra turistike, komplekse banimi, objekte polifunksionale apo vila e ndërtime të veçanta; ndërtim në fushën e turizmit, infrastrukturës, qendrave të biznesit, të banimit, atyre multifunksionale apo vilave të banimit, me qëllim shitjen, dhënien me qera apo realizimin e çdo transaksioni të lejueshëm nga legjislacioni shqiptar, administrim dhe mirëmbajtje të të gjithë elementëve për godinat e ndërtuara, të rikonstruara, sipërfaqeve urbane, rrugëve e shesheve brenda dhe jashtë komplekseve të ndryshëm ndërtimorë, administrim dhe mirëmbajtje e të gjithë elementëve për fshatra turistike etj.

II. Përqendrimi

Referuar Statutit të shoqërisë Shtëpia e Pritjes SHPK, kapitali themeltar i saj përbëhet nga 3 kuota, ku 1 kuotë zotërohet nga shoqëria AGNA SHA, 1 kuotë zotërohet nga shoqëria LARTI – SHPK dhe 1 kuotë zotërohet nga shoqëria FIX PRO SHPK.

Organi më i lartë vendimmarrës i ndërmarrjes së përbashkët Shtëpia e Pritjes SHPK është Asambleja e Përgjithshme. Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 50% të kapitalit. Në rastin kur Asambleja duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të cilësuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se ½ e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë apo mjete elektronike.

Administrimi i shoqërisë do të bëhet nga një ose disa administratorë, të cilët do të përfaqësojnë shoqërinë së bashku ose veç e veç. Administratori do të organizojë dhe menaxhojë të gjithë aktivitetin e shoqërisë.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar konsiston në krijimin e një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota nga shoqëritë AGNA SHA, LARTI – SHPK dhe FIX PRO SHPK. Ky transaksion përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Kapitullit IV të Udhëzimit “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e Konkurrencës

Sipas nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i ndërtimeve. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është krijimi i një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota nga shoqëritë AGNA SHA, LARTI - SHPK dhe FIX PRO SHPK.

Shoqëria AGNA SHA ka realizuar të ardhura kryesisht nga tregtia me shumicë e mallrave ushqimorë industrialë dhe duhanit të importuar, nga investime në shoqëri të tjera dhe një pjesë të vogël nga qiradhënia e pasurive të paluajtshme.

Shoqëria LARTI – SHPK ka realizuar të ardhura kryesisht nga tregtimi i materialeve të ndërtimit.

Shoqëria FIX PRO SHPK është aktive kryesisht në prodhimin dhe tregtimin e sallamit dhe nënprodukteve të mishit.

Ndërmarrja e përbashkët Shtëpia e Pritjes SHPK do të ushtrojë veprimtarinë e vet në qytetin e Korçës, si investitorë për ndërtimin e një sipërfaqe toke në pronësi të AGNA SHA dhe do të shtojë numrin e konkurrentëve në tregun e ndërtimit, fillimisht në këtë qytet.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121,

datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota nga shoqëritë AGNA SHA, LARTI - SHPK dhe FIX PRO SHPK.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1054 , Datë 02. 02. 2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET BLERJES SË AKSIONEVE TË SHOQËRISË EAGLE INVESTMENT SHA NGA SHOQËRIA INFINITY INVESTMENT SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 02.02.2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së aksioneve të shoqërisë Eagle Investment SHA nga shoqëria Infinity Investment SHA.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përftimit të kontrollit mbi blerjen e aksioneve të shoqërisë Eagle Investment SHA nga shoqëria Infinity Investment SHA,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës u depozitua njoftimi mbi përftimin e kontrollit të shoqërisë Eagle Investment SHA nga shoqëria Infinity Investment SHA, bashkë me dokumentacionin e përcaktuar në rregulloren “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”.

Referuar dokumentit “Marrëveshje Shitje dhe Blerje”, nënshkruar më datë 28 korrik 2023, palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: Infinity Investment SHA është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas

legjislacionit shqiptar, e cila operon në fushën e lojërave të fatit përfshirë të gjithë kategoritë, kazino elektronike, operim dhe menaxhim i sallave të lojërave të fatit dhe kazinove, import-eksport i makinave të lojërave të fatit, marrje dhe dhënie me qira e tyre etj.

Tregu i lojërave të fatit rregullohet me ligjin nr. 155/2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, i përditësuar. Kategoritë e lojërave të fatit, që lejohen të zhvillohen në Republikën e Shqipërisë, për të cilat shoqëritë e interesuara mund të licencohen bazuar në këtë ligj, janë: baste sportive; baste për gara në pistë; kazino/kazino të vendosura në hotele me 5 yje; lojë elektronike në distancë; resort kazino; Lotaria Kombëtare; bingo televizive.

Shoqëria Infinity Investment SHA zotëron 100% të shoqërisë Hospitality Invest Group SHPK, shoqëri e cila ka për objekt kryerjen e të gjitha aktiviteteve tregtare që lidhen me fushën e hotelarisë, resort, bar, restorant etj.

Infinity Investment SHA zotërohet 60% nga WSI SHPK dhe 40% nga W-CZ Holdings s.r.o.

Referuar informacionit të palës njoftuese, shoqëria WSI SHPK zotëron kuota në shoqëritë PRIME INVESTMENT GROU, IMPERIUM INVEST dhe BLUE TDI, aktive në fushën e ndërtimeve të ndryshme me karakter turistik, industrial, social etj; shoqërinë ALBANIAN STONE FACTORY, aktive në fushën e minierave, të prodhimit dhe përpunimit të materialeve, në fushën e ndërtimit etj dhe shoqërinë ADRIA ENTERTAINMENT (ish "APEX - AL"), shoqëri aksionare, me objekt aktiviteti në fushën e lojërave të fatit, përfshirë të gjitha kategoritë; tregti me shumicë dhe pakicë, imp-eks të mallrave industriale dhe ushqimore.

Shoqëria W-CZ Holdings s.r.o zotëron 1% në shoqërinë SPACE + SHA, shoqëri e regjistruar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti ushtrimin e veprimtarive të lojërave të fatit në kategorinë kazino në hotel me 5 yje, etj.

Pala shitëse: Novomatic AG është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Austrisë dhe një nga prodhuesit dhe eksportuesit më të mëdhenj të pajisjeve të teknologjisë së lartë të lojërave në botë.

Shoqëria Target: Eagle Investment SHA është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: dhënia me qira e automateve të lojërave të fatit shoqërive të treta të licencuara, si dhe dhënia me qira e ambienteve dhe sallave.

Eagle Investment SHA zotërohet plotësisht nga shoqëria Novomatic AG.

Në zbatim të neneve 33, 34 dhe 55 të ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe për vlerësimin e efekteve që do të sillte transaksioni i njoftuar mbi konkurrencën në treg, Autoriteti i Konkurrencës kërkoi informacion dhe administroi të dhëna nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit.

II. Përqendrimi

Më datë 28 korrik 2023 është nënshkruar “Marrëveshje Shitje dhe Blerje” ndërmjet shoqërive Infinity Investment SHA (blerësi) dhe Novomatic AG (shitësi).

Referuar kësaj marrëveshje, shitësi është pronar i të gjithë kapitalit të shoqërisë target Eagle Investment SHA dhe synon të shesë aksionet e tij në shoqëri tek blerësi dhe blerësi synon të blejë aksionet nga shitësi, në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj marrëveshje.

Transferimi i titullit dhe pronësisë së aksioneve nga shitësi tek blerësi do të realizohet pas miratimit të Kushteve Paraprake të përcaktuara në këtë marrëveshje, ku përfshihet edhe miratimi nga Autoriteti i Konkurrencës.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i lojërave të fatit.

Shoqëria Eagle Investment SHA ka qenë një shoqëri e licencuar në ofrimin e lojërave të fatit në salla, por pas ndalimit me ligj të këtij aktiviteti, target nuk ka ushtruar aktivitet ekonomik në këtë treg. Mbështetur mbi pasqyrat financiare të audituara për vitin 2022, të ardhurat e shoqërisë vijnë nga dhënia me qira e automateve të lojërave të fatit shoqërive të treta të licencuara, si dhe dhënia me qira e ambienteve dhe sallave të cilat kanë mbetur stok.

Mbështetur në informacionin e depozituar nga pala njoftuese në lidhje me arsyet ekonomike të transaksionit, konstatohet se shoqëria target zotëron disa prona si pasuri e paluajtshme, të cilat kanë një vlerë përdorimi me interes të shoqërisë blerëse Infinity Investment SHA dhe synimi i shoqërisë blerëse është përdorimi për nevojat e saj i këtyre pronave të paluajtshme. Shoqëria blerëse nuk ka synim të zhvillojë aktivitetin tregtar të shoqërisë target.

Referuar aktivitetit të shoqërisë target dhe të shoqërisë blerëse, konstatohet se, të paktën në vitet e fundit, palët operojnë në tregje të ndryshme, por aktiviteti ekonomik i shoqërisë Eagle Investment SHA, pas përfutimit të kontrollit, do të ndikohet nga fuqia ekonomike e Infinity Investment SHA, një nga shoqëritë e licensuara në tregun e lojërave të fatit.

Mbështetur në numrin e shoqërive të licencuar në tregun e lojërave të fatit, si dhe strukturën aksionare të tyre, konstatohet se tregu karakterizohet nga një numër i vogël konkurrentësh dhe është i përqendruar vetën në 4 shoqëri.

Shoqëria target, Eagle Investment SHA nuk ka asnjë aktivitet tregtar lidhur me tregun e lojërave të fatit dhe transaksioni nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo

të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim në strukturat e tregut.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së aksioneve të shoqërisë Eagle Investment SHA nga shoqëria Infinity Investment SHA.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1055 , Datë 02. 02. 2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR NËPËRMJET PËRFTIMI TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË ENERFIN SOCIEDAD DE ENERGIA SL NGA SHOQËRIA STATKRAFT EUROPEAN WIND AND SOLAR HOLDING AS”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 02.02.2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të propozuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Enerfin Sociedad de Energia SL nga shoqëria Statkraft European Wind and Solar Holding AS.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Enerfin Sociedad de Energia SL nga shoqëria Statkraft European Wind and Solar Holding AS,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës u depozitua njoftimi mbi përfitimin e kontrollit të shoqërisë Enerfin Sociedad de Energia SL nga shoqëria Statkraft European Wind and Solar Holding AS.

Referuar marrëveshjes, palët pjesëmarrëse në transaksion janë:

Pala blerëse: Statkraft European Wind and Solar Holding AS është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, i themeluar sipas legjislacionit të Norvegjisë. Aktiviteti i shoqërisë kufizohet në

zotërimin e kuotave/aksioneve (direkt ose indirekt) në shoqëritë që zotërohen tërësisht ose pjesërisht nga Grupi Statkraft.

Grupi Statkraft është prezent në Shqipëri përmes dy filialeve të saj, Statkraft Renewables Albania SHPK dhe Devolli Hydropower SHA, të cilët operojnë në tregun e prodhimit të energjisë elektrike.

Pala shitëse: Elecnor SA është një shoqëri spanjolle, e organizuar sipas legjislacionit të Spanjës, e cila e ka filluar aktivitetin e saj në inxhinieri, projekt, ndërtim, montim, riparim, mirëmbajtje dhe konservim të të gjitha llojeve të punimeve dhe objekteve të çdo lloji apo natyre; ndërtimi i rrjeteve elektrike dhe telekomunikacionit, etj.

Shoqëria Target: Enerfin Sociedad de Energia SL është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e organizuar sipas legjislacionit të Spanjës. Objekt i saj i aktivitetit është: a) Promovimi, menaxhimi dhe administrimi i shoqërive të të gjitha llojeve, industriale, bujqësore, tregtare apo shërbime dhe pjesëmarrja në shoqëri që tashmë ekzistojnë ose krijohen, qoftë nëpërmjet organeve drejtuese, qoftë nëpërmjet pronësisë së aksioneve apo pjesëmarrjeve. Këto operacione mund të kryhen edhe në emër të palëve të treta: b) blerja ose nënshkrimi i aksioneve ose të pjesëmarrjeve në shoqëri të dedikuara për veprimtari biznesi, tituj të cilët janë renditur në bursë ose jo, për llogari të tyre.

Shoqëria target zotëron filiale në Spanjë, Brazil e më gjerë, të cilat operojnë në projekte të prodhimit të energjisë nga burime të rinovueshme.

Shoqëria target dhe filialet e saj nuk kanë prezencë ligjore dhe nuk realizojnë të ardhura në Shqipëri.

II. Përqendrimi

Ndërmjet shoqërisë Statkraft European Wind and Solar Holding AS (blerësi) dhe shoqërisë Elecnor SA (shitësi) është lidhur “Marrëveshje shitblerje kuotash”, në lidhje me kuotat e Enerfin Sociedad de Energia SL, e nënshkruar më datë 17 nëntor 2023.

Sipas afateve dhe kushteve të kësaj marrëveshje, shitësi i shet dhe i transferon blerësit, në datën e mbylljes, kuotat e lira dhe të pastra nga çdo barrë.

Blerësi Statkraft European Wind and Solar Holding AS me përfitim të kontrollit të drejtpërdrejtë të shoqërisë Enerfin Sociedad de Energia SL, indirekt do të përfitojë kontrollin e filialeve të kësaj të fundit.

Me realizimin e këtij transaksioni shoqëria Statkraft European Wind and Solar Holding AS do të jetë ortaku i vetëm i shoqërisë Enerfin Sociedad de Energia SL.

Transaksioni i propozuar konsiston në përfitim të kontrollit të shoqërisë Enerfin Sociedad de Energia SL nga shoqëria Statkraft European Wind and Solar Holding AS, i parashikuar në nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

III. Analiza e Konkurrencës

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i prodhimit të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Statkraft European Wind and Solar Holding AS është pjesë e grupit Statkraft, e cila është prezent në Shqipëri përmes dy filialeve të saj, Statkraft Renewables Albania SHPK dhe Devolli Hydropower SH.A.

Shoqëria target, Enerfin Sociedad de Energia SL, është e angazhuar, nëpërmjet filialeve të saj, në prodhimin e energjisë nga zhvillimi i projekteve në Spanjë, Brazil, Kanada, Kolumbi, Australi, Kili dhe SHBA. Targeti nuk është prezent dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Enerfin Sociedad de Energia SL nga shoqëria Statkraft European Wind and Solar Holding AS.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1056 , Datë 02. 02. 2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË FIRST BANK S.A. NGA SHOQËRIA INTESA SANPAOLO S.P.A”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 02.02.2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë First Bank S.A. nga shoqëria Intesa Sanpaolo S.p.A.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë First Bank S.A. nga shoqëria Intesa Sanpaolo S.p.A.,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës u depozitua njoftimi mbi përfutimin e kontrollit të shoqërisë First Bank S.A. nga shoqëria Intesa Sanpaolo S.p.A.

Referuar dokumentit “Marrëveshje për shitblerjen e 99.980513% të aksioneve në First Bank S.A.”, e nënshkruar më datë 28 tetor 2023, palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: Intesa Sanpaolo S.p.A është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit të Italisë, me objekt kryesor ofrimin e transaksioneve bankare, investimeve bankare, financë të

strukturuar, tregje kapitali etj.

Intesa Sanpaolo S.p.A. është shoqëria mëmë e Grupit Intesa Sanpaolo. Grupi Intesa Sanpaolo është i pranishëm në Shqipëri, nëpërmjet filialit të zotëruar tërësisht prej tij, Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA.

Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA është një nga bankat kryesore në vend, që u ofron kompanive, klientëve institucionalë e privatë me të ardhura të larta, si dhe klientëve individë e biznese të vogla e të mesme, shërbime e produkte bankare.

Pala shitëse: JCF IV Tiger Holdings S.à.r.l. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe ekzistuese sipas ligjeve të Dukatit të Madh të Luksemburgut.

Shoqëria target: First Bank S.A. është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit rumun, aktive në fushën bankare. First Bank S.A. operon me 40 degë në Rumani dhe është e angazhuar në aktivitete tipike bankare tregtare.

II. Përqendrimi

Më datë 28 tetor 2023, shoqëritë Intesa Sanpaolo S.p.A. (Blerësi) dhe shoqëria JCF IV Tiger Holdings S.à.r.l. (shitësi) kanë nënshkruar dokumentin “Marrëveshje për shitblerjen e 99.980513% të aksioneve në First Bank S.A.”.

Referuar kësaj marrëveshje, shitësi pranon të shesë dhe blerësi pranon të blejë aksionet (të cilat përfaqësojnë 99.980513% të kapitalit aksionar të First Bank S.A.) dhe çdo të drejtë që i bashkëngjitet aksioneve në përfundim, të lira nga çdo barrë.

Pas transaksionit, Intesa Sanpaolo S.p.A. do të zotërojë shumicën e aksioneve në First Bank S.A., ndërsa pjesa e mbetur përfaqësohet 0.02% do të zotërohet nga aksionarët e pakicës, persona juridikë dhe individë.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e Konkurrencës

Sipas nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i shërbimeve bankare, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfundimi i kontrollit të shoqërisë First Bank S.A. nga shoqëria Intesa Sanpaolo S.p.A.

Intesa Sanpaolo S.p.A është shoqëria mëmë e Grupit Intesa Sanpaolo, i cili është prezent në

Shqipëri, nëpërmjet filialit të zotëruar tërësisht prej tij, Intesa Sanpaolo Bank Albania SHA, ofruese e produkteve dhe shërbimeve bankare ndaj klientëve institucionalë e privatë me të ardhura të larta, si dhe klientëve individë e biznese të vogla e të mesme.

First Bank S.A. është një shoqëri aksionare, aktive në fushën bankare. Target nuk është aktiv dhe nuk gjeneron të ardhura në Shqipëri.

Transaksioni ndodh në Rumani dhe nuk do të sjellë ndryshime në strukturën e tregut në sektorin bankar në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë First Bank S.A. nga shoqëria Intesa Sanpaolo S.p.A.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1057 , Datë 12. 02. 2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË PËRBASHKËT TË SHOQËRISË WE SII S.r.l. NGA Z. MAURO MIGLIAZZI; SHOQËRIA TERNA FORWARD S.r.l. DHE SHOQËRIA DXT COMMODITIES SA.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 12.02.2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti:

Autorizimi i përqendrimit të propozuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë WE SII S.r.l. nga Z. Mauro Migliazzi, shoqëria Terna Forward S.r.l., dhe shoqëria DXT Commodities SA.

Baza Ligjore:

Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”; Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të propozuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët në shoqërinë WE SII S.r.l. nga Z. Mauro Migliazzi, shoqëria Terna Forward S.r.l., dhe shoqëria DXT Commodities SA.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës u depozitua njoftimi mbi përfutimin e kontrollit të përbashkët të shoqërisë WE SII S.r.l. nga Z. Mauro Migliazzi, shoqëria Terna Forward S.r.l., dhe shoqëria DXT Commodities SA.

Referuar “Marrëveshjes së Mirëkuptimit”, e ndryshuar dhe “Marrëveshjes së Investimit”, palët pjesëmarrëse në transaksion janë:

- **Terna Forward S.r.l.**, është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit italian, në pronësi të plotë të Terna-Rete Elettrica Nazionale Società per Azioni, e cila ka për objekt aktiviteti, *inter alia*, blerjen menaxhimin dhe vlerësimin e investimeve të kapitalit në ndërmarrjet fillestare dhe SME-të inovative, edhe nëpërmjet pjesëmarrjes në fondet e kapitalit sipërmarrës.

Terna-Rete Elettrica Nazionale Società per Azioni është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit italian dhe zotëuese e Grupit Terna. Terna-Rete Elettrica Nazionale Società per Azioni është operator i infrastrukturës elektrike të voltazhit ekstra të lartë që përbën Rrjetin Kombëtar të Transmetimit në Itali, duke përfshirë linjat e transmetimit dhe stacionet transformuese, si dhe operatori më i madh i pavarur i rrjetit të transmisionit të elektricitetit në Evropë.

Terna-Rete Elettrica Nazionale Società per Azioni nuk ka filiale apo degë biznesi në Shqipëri.

- **DXT Commodities SA** është një shoqëri aksionare e regjistruar sipas legjislacionit zviceran, e cila është e specializuar në tregtimin e mallrave, duke përfshirë gazin, energjinë elektrike dhe produkte të tjera që lidhen me sektorin e energjisë.

DXT Commodities SA kontrollohet indirekt nga Duferco Participations Holding S.A, që operon kryesisht në sektorin e gazit dhe të elektricitetit dhe zotëron Grupin Duferco, një grup ndërkombëtar që operon kryesisht në sektorin e çelikut, si dhe në sektorë të tillë si energjia, logjistika, transporti dhe mjedisi.

Grupi Duferco është i pranishëm në Shqipëri nëpërmjet: Duferco Pobreg SHPK, Energy Plus SHPK, HEC - I Kabash Porocan SHPK, Duferco Albania SHPK dhe Duferco Shqipëria SHPK.

-**Z.Mauro Migliazzi** është person fizik me shtetësi italiane dhe një nga themeluesit e shoqërisë target.

Shoqëria target: WE SII S.r.l. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit Italian. WE SII S.r.l. operon në treg si një SME inovative e specializuar në ofrimin e shërbimeve avantgard të inspektimit multispektral për një gamë të gjerë shoqërisë, duke përdorur teknologjitë e sensorit në distancë me përdorimin e mjeteve ajrore pa pilot (dronë), avionëve dhe/ose nëpërmjet satelitëve dhe inteligjencës artificiale.

WE SII S.r.l., nuk ka filiale apo degë biznesi në Shqipëri dhe as ka gjeneruar të ardhura gjatë vitit 2022.

II. Përqendrimi

Ndërmjet Z. Mauro Migliazzi, shoqërisë Terna Forward S.r.l., shoqërisë DXT Commodities SA dhe shoqërisë Tigullio Digital S.r.l, është nënshkruar më datë [.....], “Marrëveshje Mirëkuptimi”, e ndryshuar më datë [.....], dhe datë [.....].

[.....]

Me realizimin e transaksionit, vlera e kapitalit aksionar të shoqërisë WE SII S.r.l do të mbahet në një të tretën nga secili ortak, Z. Mauro Migliazzi, shoqëria Terna Forward S.r.l, dhe shoqëria DXT Commodities SA.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i synuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e Konkurrencës

Sipas nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, tregu përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i prodhimit, transmetimit dhe tregtimit të energjisë elektrike, duke përfshirë operimin, mirëmbajtjen (O&M) dhe monitorimin e sistemeve fotovoltaike nga sensorë në largësi, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Nga vlerësimi i transaksionit, konstatohet se Terna Forward S.r.l. është një shoqëri e zotëruar dhe e kontrolluar nga Terna-Rete Elettrica Nazionale Società per Azioni, e cila operon në tregun e infrastrukturës elektrike të voltazhit ekstra të lartë në Itali dhe më tej dhe nuk ka filial në Shqipëri dhe nuk ka gjeneruar të ardhura në Shqipëri në vitin 2022.

DXT Commodities S.A. është një shoqëri pjesë e Grupit Duferco, i cili është prezent në Shqipëri përmes pesë shoqërive të kontrolluara indirekt prej tij dhe aktive në fushën e prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike.

Z. Mauro Migliazzi është një nga partnerët themelues të Target, i cili nuk zotëron dhe nuk kontrollon ndonjë entitet juridik përveçse Target-it.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë WE SII S.r.l. nga Z. Mauro Migliazzi, shoqëria Terna Forward S.r.l., dhe shoqëria DXT Commodities SA..
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1058 , Datë 12. 02. 2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË BTB HOLDING INVESTMENTS S.A. NGA SHOQËRIA ULTIMA HOLDING S.A.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 12.02.2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të propozuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë BTB Holding Investments S.A. nga shoqëria Ultima Holding S.A.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”; Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë BTB Holding Investments S.A. nga shoqëria Ultima Holding S.A.,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës u depozitua njoftimi mbi përfutimin e kontrollit të shoqërisë BTB Holding Investments S.A. nga shoqëria Ultima Holding S.A.

Referuar dokumenteve të nënshkruara, palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: Ultima Holding S.A. është një shoqëri financiare holding, e themeluar sipas

legjislacionit të Luksemburgut, pjesë e Grupit Ultima. Grupi Ultima përbëhet kryesisht nga kompani financiare holding, me aktivitete të kufizuara biznesi në sektorin e medias dhe në sektorin e pasurive të paluajtshme.

Grupi Ultima nuk është prezent dhe nuk ka realizuar xhiro në Shqipëri.

Pala shitëse: BB Holding Investment është një shoqëri holding, e themeluar sipas legjislacionit të Luksemburgut, e cila zotërohet plotësisht nga La Sesta Trust.

Shoqëria target: BTB Holding Investments S.A. është një shoqëri anonime, e themeluar sipas legjislacionit të Luksemburgut. BTB Holding Investments S.A. është shoqëria holding e Duferco Group, i cili është aktiv në katër sektorë: energji, çelik, transport dhe inovacion.

Grupi Duferco është i pranishëm në Shqipëri nëpërmjet: Duferco Pobreg SHPK, Energy Plus SHPK, HEC - i Kabash Porocan SHPK, Duferco Albania SHPK dhe Duferco Shqipëria SHPK.

II. Përqendrimi

Më datë [.....], shoqëritë Ultima Holding S.A. (Blerësi), shoqëria BB Holding Investment (shitësi) dhe BTB Holding Investments S.A. (shoqëria target) kanë nënshkruar dokumentin “Marrëveshje Shitblerje Aksionesh”.

Sipas afateve dhe kushteve të kësaj marrëveshje, blerësi do të blinte 10% të aksioneve të shoqërisë target, të nënshkruara dhe paguara pjesërisht, me garanci të plotë të titullit dhe të çliruara nga të gjitha barrët.

Më datë [.....], palët në Marrëveshjen e Shitblerjes së Aksioneve të vitit [.....] dhe La Sesta Trust, kanë lidhur “Marrëveshje Shitblerje Aksionesh”.

Sipas afateve dhe kushteve të kësaj marrëveshje, blerësi do të blejë të gjitha aksionet e zotëruara nga La Sesta Trust në BB Holding Investment me të gjitha të drejtat, pronësinë dhe interesin bashkëlidhur dhe të parënduar nga barrët.

Asnjë nga kushtet e parashikuara në marrëveshjen e [.....] dhe [.....] nuk janë plotësuar dhe më datë [.....], palët nënshkruan një Shtojcë të “Marrëveshje Shitblerje Aksionesh”, [.....].

Kjo shtojcë lejon që shitja e target do të hyjë në fuqi pa rrethanat e paparashikueshme të transaksioneve të palëve të treta. Transaksioni i propozuar do të mbyllet vetëm pas marrjes së miratimeve nga autoritetet përkatëse të konkurrencës.

Në përfundim, BB Holding Investment do të bëhet një filial në pronësi të plotë të Ultima Holding S.A. dhe Ultima do të zotërojë drejtpërdrejt ose tërthorazi (nëpërmjet BB Holding Investment) 100% të kapitalit aksionar të shoqërisë target.

Referuar Udhëzimit “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” parashikohet se dy

ose më shumë transaksione përbëjnë një përqendrim të vetëm nëse ato janë unike në natyrë. Me qëllim që të përcaktohet natyra unike e transaksionit, është e nevojshme që këto transaksione të jenë të ndërrarura, në mënyrë të tillë që një transaksion nuk do të ishte kryer pa tjetrin. Kriteri që përcakton nëse transaksioni është i ndërrarur, kërkon që transaksionet të jenë të lidhura me kusht.

[.....]

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Kapitullit II (pjesa 1.5) të Udhëzimit “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”. Ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e Konkurrencës

Sipas nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur, pasi Grupi Ultima është i përbërë kryesisht nga shoqëri financiare holding dhe ka aktivitete shumë të kufizuara biznesi si në sektorin e medias, ashtu edhe në tregun e pasurive të paluajtshme dhe transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfitim i kontrollit të shoqërisë BTB Holding Investments S.A. nga Ultima Holding S.A.

Ultima Holding S.A. është një shoqëri financiare holding e Grupit Ultima. Grupi Ultima nuk është prezent dhe nuk ka realizuar xhiro në Shqipëri.

BTB Holding Investments S.A. është një shoqëri holding e Duferco Group.

Grupi Duferco është prezent në Shqipëri përmes pesë shoqërive, aktive në fushën e prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë BTB Holding Investments S.A. nga shoqëria Ultima Holding S.A.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1059 , Datë 23. 02. 2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË STUDIO MODERNA ALBANIA SHPK NGA SHOQËRIA SMA HOLDING SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 23.02.2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Studio Moderna Albania SHPK nga shoqëria SMA Holding SHPK.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Studio Moderna Albania SHPK nga shoqëria SMA Holding SHPK,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës u depozitua njoftimi mbi përfutimin e kontrollit të shoqërisë Studio Moderna Albania SHPK nga shoqëria SMA Holding SHPK.

Palët pjesëmarrëse në transaksion janë:

Pala blerëse: SMA Holding SHPK, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në Shqipëri nga ortaku i vetëm i Viva Fresh, Z. Xhevdet Rexhepi, për qëllim të transaksionit, për të ushtruar veprimtari të një shoqërie *holding*, për aktivitete të ndryshme.

Pala shitëse: Studio Moderna Holdings Investments B.V është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit hollandez, me aksionar të vetëm shoqërinë Studio Moderna Holdings B.V.

Shoqëria Target: Studio Moderna Albania SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: teleshopping, import-eksport, tregti mallrash e shërbimesh, si dhe çdo lloj tjetër aktiviteti në përputhje me ligjin. Pala shitëse, Studio Moderna Holdings Investments B.V, është ortak i vetëm i shoqërisë target.

Shoqëri të tjera target: Shoqëria Studio Moderna Holdings Investments B.V zotëron Studio Moderna Kosovë SHPK, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas legjislacionit të Kosovës, Studio Moderna d.o.o, Crna Gora, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas legjislacionit të Malit të Zi dhe Studio Moderna Dooel Skopje, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas legjislacionit të Maqedonisë së Veriut, të cilat janë pjesë e transaksionit.

II. Përqendrimi

Ndërmjet shoqërisë SMA Holding SHPK (blerësi), Studio Moderna Holdings Investments B.V (shitësi), dhe palëve Studio Moderna Brands B.V., dhe Z. Sandi Češko është lidhur “Marrëveshje e Blerjes së Kuotave” të nënshkruar më datë 07.12.2023.

Referuar kësaj Marrëveshje, shitësi dëshiron të shesë dhe transferojë kuotat tek blerësi dhe blerësi dëshiron të blejë kuotat nga shitësi sipas kushteve të rëna dakort në këtë marrëveshje.

Në përputhje me dokumentacionin e transaksionit, shitësi do të shesë dhe do të transferojë tek blerësi 100% të kapitalit të Studio Moderna Albania SHPK. Në përfundim të transaksionit të propozuar, blerësi do të zotërojë 100% kapitalin e shoqërisë Studio Moderna Albania SHPK dhe përfitim të kontrollit të vetëm të shoqërisë target.

Njëkohësisht me blerjen e Studio Moderna Albania SHPK, blerësi SMA Holding SHPK do të blejë 100% kapitalin e shoqërisë Studio Moderna Kosovë SHPK një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas legjislacionit të Kosovës, Studio Moderna d.o.o, Crna Gora një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas legjislacionit të Malit të Zi dhe Studio Moderna Dooel Skopje një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas legjislacionit të Maqedonisë së Veriut.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Sipas nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i shitjes së produkteve shtëpiake të vogla, teleshopping dhe treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i synuar konsiston në përfitim të kontrollit të shoqërisë Studio Moderna Albania SHPK nga shoqëria SMA Holding SHPK.

SMA Holding SHPK operon si një shoqëri holding. SMA Holding SHPK ka si ortak të vetëm Z. Xhevdet Rexhepi, i cili është njëkohësisht pronari përfitues i një grupi shoqëriash që ushtrojnë

veprimtari të ndryshme në tregtinë me shumicë dhe pakicë të produkteve ushqimore në Republikën e Shqipërisë, Kosovës dhe vende të tjera të rajonit.

Studio Moderna Albania SHPK është një shoqëri aktive në fushën e teleshopping, import-eksport, tregti mallrash e shërbimesh. Shoqëria tregon marka si: Top Shop, Dormeo, Wellneo, Delimano, Walkmaxx, Rovus.

Blerësi dhe Target kanë aktivitete të ndryshme tregtare, duke mos krijuar një mbivendosje të tregjeve të produkteve të shitura konkretisht prej tyre dhe kombinimi i tyre nuk do të sjellë ndryshime në strukturën e tregut në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Studio Moderna Albania SHPK nga shoqëria SMA Holding SHPK.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr.1060, Datë 23. 02. 2024

“PËR DHËNIEN E DISA REKOMANDIMEVE AUTORITETI TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 23.02.2024 ,shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Dhënie e disa rekomandimeve për Autoritetin të Mediave Audiovizive.

Bazë ligjore: Neni 24, gërma d) e f), neni 26, nenin 69 dhe neni 70 i ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës, “Mbi vlerësimin ligjor të projekt Dokumentit Strategjik dhe Planit të Veprimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive për periudhën 2024-2026.

VËREN SE:

1. Pranë Autoritetit të Konkurrencës, me shkresën nr.48 prot.,datë 08.01.2024, (protokolluar me tonën me nr. 35 prot, datë 10.01.2024), Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), ka dërguar për mendim, projekt Dokumentin Strategjik dhe Planin e Veprimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive për periudhën 2024-2026.
2. Ky dokument mbështetet në statusin e përmbushjes së objektivave të AMA-s për periudhën 2020-2022, në funksion të rolit rregullator i tregut mediatik, si dhe përcakton objektivat strategjike për periudhën 2024-2026, me angazhimin e AMA-s, posacërisht për amendimin e ligjit 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si nevojë e reflektimit të direktivave të BE-së dhe e përditësimit të diktuar nga detyrimet lidhur me transparencën e pronësisë së medias, luftën kundër piraterisë dhe shkeljes së të drejtës së transmetimit.

3. Në Planit të Veprimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive për periudhën 2024-2026, qëllimet strategjike të AMA-s janë parashikuar për një periudhë prej 3 vjetësh, duke u detajuar me objektiva dhe me një plan veprimi, të cilat do të ndihmojnë në përmbushjen e strategjisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive për këtë periudhë kohore.
4. Dokumenti merr referim tek përpjekja e AMA-s, për harmonizimin e Direktivave të BE-së, që prodhojnë detyrime prej pjesëmarrjes së vendit tonë në organizma bashkëpunimi rajonal e më gjerë (Direktiva e BE 2018/1808).
5. Gjithashtu, në periudhën 2021-2023, AMA ka finalizuar procesin e kordinimit ndërkufitar në nivel allotmenti të planit të ri Frekuencor(470-694MHz), duke mundësuar operimin e rrjetit të shtatë në Shqipëri, në përmbushje të detyrimit për trajtimin dhe qasjen e barabartë të të shtatë operatorëve audiovizivë kombëtarë në veprim (publik/privat), si dhe është kryer rishikimi i Kodit të Transmetimit.
6. Nga vlerësimi konstatohet se, Dokumenti i Planit Strategjik i Veprimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive për periudhën 2024-2026, përgjithësisht ka synuar të sjellë një frymë drejt mbrojtjes së parimeve të konkurrencës së lirë dhe efektive në treg në mbështetje të ligjit 9121/2003.
 - Evidentohet fakti se në përmbajtje të Dokumentit Strategjik ka përcaktime që përmbajnë detyra të kryera nga AMA, që kanë synuar të mbrojnë parimet e konkurrencës, si p.sh. (i) *mundësimi i operimin e rrjetit të shtatë në Shqipëri, në përmbushje të detyrimit për trajtimin dhe qasjen e barabartë të të shtatë operatorëve audiovizivë kombëtarë në veprim (publik/privat); dhe*
 - Sipas përcaktimit të Kreut IV, pika 4, germa c; (ii) *licensimi/autorizimi si dhe rregullimi i shërbimeve mediatike audiovizive do të kryet bazuar në ruajtjen e një sistemi të drejtë në respektim të parimit të drejtësisë, të paanësisë dhe konkurrencës së lirë, duke lehtësuar procedurat nëpërmjet aplikimeve virtuale për licencim/autorizimet, vlerësohet se, lehtësimi i procedurave administrative në shërbimet mediatike audiovizive, çojnë në shmangien e barrierave artificiale për konkurrencën potenciale në tregun përkatës, gjithashtu favorizon hyrjen e sipërmarrësve të rinj, për të siguruar një konkurrencë të drejtë në treg.*
7. Përcaktimi i Kreut IV të Dokumentit, që konsiston në synimin e Autoritetit të Mediave Audiovizive për hartimin e një metodologjie për matjen e audiencës të operatorëve televizivë, në kuadër dhe të përafrimit legjislacionit specifik me me Direktivën e BE 2018/1808.

8. Në këtë pjesë të dokumentit strategjik, përcaktohet qartë objektivi kryesor që AMA synon të arrijë nëpërmjet hartimit të një metodologjie për matjen e audiencës të operatorëve televizivë (OSHMA-të).
9. Në tregun audioviziv operojnë 136 OSHMA, që prodhojnë përmbajtje apo programe audio dhe audiovizive, në këtë larmi ofertash mediatike, matja e audiencës është një instrument për identifikimin e shtrirjes së ndikimit mediatik të OSHMA-ve në publik, si një mjet për forcimin e transparencës në tregun audioviziv, por edhe për vetë rritjen e shumëllojshmërisë së shërbimeve audiovizive. Matja e audiencës i shërben operatorëve për t'u treguar sasinë dhe përbërjen e audiencës që ndjek programacionin e tyre, kohën e duhur dhe prespektivën e përzgjedhjeve për të ardhmen.
10. Gjithashtu, vlerësimi i shikueshmërisë është tregues i sasisë dhe përbërjes së audiencës për programet televizive. Me këtë informacion, OSHMA-të mund të rregullojnë përmbajtjen e programeve të tyre dhe oraret e transmetimit, në përgjigje të reagimit të audiencës. Realizimi i matjes së audiencës është domosdoshmëri për realitetin e tregut audioviziv shqiptar, si një instrument i rëndësishëm për identifikimin e shtrirjes së ndikimit mediatik të OSHMA-ve në publikun e gjerë, për forcimin e transparencës në tregun audioviziv, rritjen e shumëllojshmërisë së shërbimeve audiovizive etj.
11. Veprimtaria e mediave audiovizive, rregullohet nga ligji nr. 97/2013 “Për median audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, si dhe aktet nënligjore dalë për zbatim të tij.
12. Në ligjin 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nuk gjendet rregullim mbi konceptin për matjen e audiencës së operatorëve audiovizivë, për këtë arsye, AMA ka përgatitur projekt-propozimet për ndryshimet përkatëse ligjore, duke përfshirë edhe konceptin e Matjes së Audiencës, në zbatim të ligjit organik 97/2013. Aktualisht ndryshimet e propozuara janë në fazë konsultimi publik.
13. Gjithashtu, në Planit e Veprimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive për periudhën 2024-2026, qëllimet strategjike të AMA-s janë parashikuar për një periudhë prej 3 vjetësh, duke u detajuar me objektiva dhe me një plan veprimi, të cilat do të ndihmojnë në përmbushjen e strategjisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive për këtë periudhë kohore, në këtë kuadër është dhe organizimi i takimeve paraqitur më poshtë:

14. *Sipas njoftimeve për shtyp publikuar në faqen e AMA-s, janë organizuar 3 tryeza pune, një në datën 15.01.2024¹ tjetra në datën 30.1.2024², si dhe në datë 06.02.2024³ në lidhje me matjen e audiences në në tregun audioviziv shqiptar.*
15. Nga informacioni paraqitur, në lidhje me të tre tryezat e punës, organizuar nga AMA për matjen e audiences në tregun audioviziv, konstatohet se:
16. Me qëllim arritjen e hartimit të një metodologjie për matjen e audiencës, nga përfaqësues të operatorëve audiotelvizivë publik/privat, është rënë dakort për ngritjen një Komitetit të Përbashkët të Industrisë, ku është ngritur fillimisht një Bord Themelues/Grup fillestar Pune, që ka përcaktuar mënyrën e ngritjes dhe organizimit vendimmarrës dhe financiar të Komitetit të Përbashkët të Industrisë (KPI).
17. Pjesë e Bordit Themelues me të drejtë vote, janë televizionet me shtrirje kombëtare si dhe shoqata përfaqësuese të kompanive reklamuese dhe të kompanive të marketingut, në këtë proces AMA si Rregullator i këtij tregu, nuk ka qenë pjesë e Komitetit të Përbashkët me të drejtë vote.
18. Në lidhje me metodologjinë që do të zbatohet, palët kanë rënë dakort për krijimin e Komitetit të Përbashkët të Industrisë, si një ent organizator e vendimmarrës i procesit të matjes së audiencës. Formula e pranuar është me 9 anëtarë, ku bëjnë pjesë: përfaqësues të 3 televizioneve private me licencë kombëtare, përfaqësues të 3 televizioneve rajonale, Televizioni Publik dhe dy anëtarë nga shoqata e agjencive të reklamave si dhe është miratuar formula e përzgjedhjes së 3 përfaqësuesve në Komitetin e Përbashkët të Industrisë, e cila do të bazohet në këto kriterë:
 - Rotacion vjetor, i përcaktuar nga rezultatet që do të dalin nga matja e audiences; dhe,
 - Numri i punonjësve të siguruar dhe vlera e sigurimeve shoqërore e dy viteve të fundit.
19. Në këtë proces, AMA, në cilësinë e autoritetit rregullator të pavarur, do të ketë rol nxitës, deri në krijimin e KPI, si dhe duke dhënë ndihmën e vet, për metodologjinë që do të zbatohet për matjen e audiencës.
20. Për sa më sipër, nga shqyrtimi dhe vlerësimi i Dokumentit të Planit Strategjik të Veprimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive për periudhën 2024-2026, konkludojmë se:

¹ <https://ama.gov.al/ama-organizon-tryezen-e-pare-per-matjen-e-audiences-palet-bien-dakort-per-krjimin-e-grupit-te-punes-dhe-diskutimin-e-modaliteteve-per-realizimin-e-procesit/>

² <https://ama.gov.al/ama-organizon-tryezen-e-dyte-per-matjen-e-audiences-palet-bien-dakort-per-ngritjen-e-komitetit-te-perbashket-te-industrise-me-9-anetare/>

³ <https://ama.gov.al/ama-mbledh-televizionet-lokale-dhe-rajonale-per-matjen-e-shikueshmerise-miratohet-formula-e-perzgjedhjes-se-3-perfaqesuesve-ne-komitetin-e-perbashket-te-industrise/>

- Dokumenti i Planit Strategjik i Veprimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive për periudhën 2024-2026, përgjithësisht ka synuar të sjellë një frymë drejt mbrojtjes së parimeve të konkurrencës së lirë dhe efektive në treg në mbështetje të ligjit 9121/2003;
- Në përmbajtje të Dokumentit Strategjik ka përcaktime që përmbajnë detyra të kryera nga AMA, që kanë synuar të mbrojnë parimet e konkurrencës, si p.sh. (i) mundësimi i operimit e rrjetit të shtatë në Shqipëri, në përmbushje të detyrimit për trajtimin dhe qasjen e barabartë të të shtatë operatorëve audiovizivë kombëtarë në veprim (publik/privat);
- Sipas përcaktimit të Kreut IV, pika 4, germa c; (ii) *licensimi/autorizimi si dhe rregullimi i shërbimeve mediatike audiovizive do të kryet bazuar në ruajtjen e një sistemi të drejtë në respektim të parimit të drejtësisë, të paanësisë dhe konkurrencës së lirë, duke lehtësuar procedurat nëpërmjet aplikimeve virtuale për licencim/autorizimet*, vlerësohet se, lehtësimi i procedurave administrative në shërbimet mediatike audiovizive, çojnë në shmangien e barrierave artificiale për konkurrencën potenciale në tregun përkatës, gjithashtu favorizon hyrjen e sipërmarrësve të rinj, për të siguruar një konkurrencë të drejtë në treg;
- Në lidhje me përcaktimin i Kreut IV të Dokumentit Strategjik, që konsiston në synimin e Autoritetit të Mediave Audiovizive për hartimin e një metodologjie të matjes së audiencës të operatorëve televizivë, ku është përcaktuar qartë objektivi kryesor që AMA synon të arrijë, konstatohet që, për periudhën në vazhdim, do të synohet që të bëhet e mundur nëpërmjet ngritjes të Komitetit të Përbashkët të Industrisë (KPI), me detyrë realizimin e matjes së audiencës, ku Autoriteti i Mediave Audiovizive do të ketë rol nxitës të këtij procesi;
- Gjithashtu, në ligjin 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nuk gjendet rregullim mbi konceptin për matjen e audiencës së operatorëve audiovizivë, për këtë arsye, AMA do kryejë ndryshimet përkatëse ligjore, duke përfshirë edhe konceptin e Matjes së Audiencës në zbatimin e ligjit të posaçëm 97/2013.

21. Nga sa më lart, në zbatim të neneve 69 dhe 70 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Autoriteti i Konkurrencës vlerëson ex-ante ose ex-post shkallën e kufizimit ose të pengimit të konkurrencës që mund të rrjedhë nga aktet apo projekt-aktet e administratës qendrore dhe vendore, që në mënyrë të veçantë, mund të çojnë në: a) kufizimet sasiore për hyrjen në treg dhe tregtimin; b) vendosjen e të drejtave ekskluzive ose të drejtave të veçanta, në zona të caktuara, për ndërmarrje ose për produkte të caktuara; c) imponimin e praktikave të njëjta në çmime dhe kushtet e shitjes. Autoriteti i Konkurrencës, në këto raste bën rekomandimet përkatëse për sektorët e rregulluar, duke bashkëpunuar me entet dhe institucionet e tjera rregullatore, në zbatim të këtij ligji.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, gërma d) e f), nenin 26, nenin 69 dhe ninin 70 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar.

VENDOSI:

1. T’i rekomandojë Autoritetit të Mediave Audiovizive që, në hartimin e metodologjisë për matjen e audiencës të operatorëve televizivë (OSHMA), të aplikojë metodat më të përshtatshme, duke reflektuar parimet bazë të konkurrencës që janë barazia, gjithpërfshirja, transparenca, mosdiskriminimi, përgjegjshmëria etj. Mbi bazën e të cilit të gjithë operatorët e tregut të shprehin opinionet dhe sugjerimet e tyre.
2. Të sjellë për vlerësim *ex ante* pranë Autoritetit të Konkurrencës, çdo projekt akt normativ që do të rrjedhë nga zbatimi i Planit Strategjik të Veprimit për periudhën 2024-2026, në lidhje me matjen e audiencës.
3. Pas formimit të Komitetit të Përbashkët të Industrisë (KPI), studimin e përbashkët të industrisë audiovizive që do të prodhohet, ta bëjë me dije në Autoritetin e Konkurrencës.
4. Çdo vendimmarrje e KPI-së që mund të ketë lidhje me pjesët e tregut sipas matjes së audiencës, të dërgohet për mendim pranë Autoritetit të Konkurrencës, për të vlerësuar nëse çënon konkurrencën e lirë dhe efektive në treg.
5. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr.1061, Datë 06. 03. 2024

“PËR DHËNIEN E DISA REKOMANDIMEVE ENTIT RREGULLATOR TË UJIT MBI APLIKIMIN PËR NDRYSHIMIN E NIVELIT TARIFOR PËR NDËRMARRJEN RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME LEZHË SHA”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 06.03.2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Dhënie e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit (ERRU) mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen Ujësjiellës Kanalizime Lezhë SHA.

Bazë ligjore: Neni 24, germa (d) dhe (f); neni 26; neni 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të:

- Relacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen rajonale Ujësjiellës Kanalizime Lezhë SHA

VËREN SE:

1. ERRU-ja nëpërmjet shkresës nr. 58/1 prot., datë 09.02.2024, informon Autoritetin e Konkurrencës se me projekt-vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator (KKRR) nr. 49 prot., datë 10.11.2023, ka filluar procedurën për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim tarife të ndërmarrjes rajonale Ujësjiellës Kanalizime Lezhë SHA, e cila ka propozuar me anë të projekt-vendimit, të aplikojë vendosjen e nivelit të ri të tarifave të shërbimit për furnizimin me ujë të pijshëm, largimin e ujërave të ndotura si edhe tarifën fikse për mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjiellës dhe të kanalizimit, në të gjithë zonën e shërbimit pas themelimit të ndërmarrjes rajonale Ujësjiellës Kanalizime Lezhë SHA më datë 09.09.2022, bazuar në VKM nr. 302, datë

11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”.

2. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i informacionit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor si dhe projekt-vendimit përkatës “Mbi miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për ndërmarrjen rajonale Ujësjiellës Kanalizime Lezhë SHA”, rezultoi se:
3. Aplikimi i metodologjisë për ndryshimin e tarifave ka filluar me analizën e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes, të cilat duhet të jenë të justifikueshme, si dhe në analizën e performancës, e cila tregon rritje të tarifave në mënyrë graduale për kategorinë e furnizimit me ujë (FU), të shërbimit të largimit të ujërave të ndotura (KUN) dhe tarifën fikse të shërbimit.
4. Ndërmarrja rajonale Ujësjiellës Kanalizime Lezhë SHA aktualisht ushtron aktivitetin e saj sipas tarifave të miratuara nga ERRU për ish shoqëritë UK ekzistuese. Konkretisht sipas tarifave të miratuara nga vendimi i KKRR nr. 45, datë 27.12.2013 për bashkinë Lezhë, Vendimin e KKRR nr. 53, datë 10.12.2010 për Bashkinë Kurbin, Vendimin e KKRR nr. 33, datë 14.12.2011 për Bashkinë Mirditë, Njësia administrative Rrëshen dhe Vendimin e KKRR nr. 29, datë 26.09.2008 për Bashkinë Mirditë, Njësia administrative Rubik. Kjo ndërmarrje e riorganizuar në nivel rajonal synon ndryshimin e tarifave aktuale në një nivel të ri tarifor, me qëllimin e qëndrueshmërisë financiare duke përmirësuar nivelin e kostove dhe përcaktimin e objektivave të treguesve kryesorë të performancës që ndërmarrja duhet të arrij në fund të vitit 2024 dhe 2025, për të ofruar një shërbim më cilësor tek konsumatori dhe që të përballoj kostot e operimit dhe të mirëmbajtjes
5. Ndërmarrja rajonale Ujësjiellës Kanalizime Lezhë SHA bën pjesë në grupin e ndërmarrjeve që nuk arrijnë të mbulojnë kostot të operimit dhe mirëmbajtjes, prandaj përmirësimi i këtij treguesi është objektivi kryesor i ndërmarrjes për vitin 2024 dhe 2025. Për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, aktualisht për konsumatorët familjar, ndërmarrja aplikon një nivel tarifimi volumetrik shërbimi për FU dhe për KUN, të cilat aplikohen jo në mënyrë uniforme për të gjithë zonën e shërbimit që mbulohet nga secila UK ekzistuese por që tashmë janë pjesë e ndërmarrjes rajonale Ujësjiellës Kanalizime Lezhë SHA.
6. Ndërmarrjen rajonale Ujësjiellës Kanalizime Lezhë SHA propozon tarifatat e reja si rezultat i nevojës për përmirësim të performancës financiare dhe mbulimin e kostove operationale; për shkak të rritje së çmimeve të materialeve; reduktimi i ujit pa të ardhura i cili vazhdon të jetë në nivele të larta; përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ujit, rritjen e vazhdimësisë së furnizimit me ujë; realizimi i të ardhurave për përballimin e kostove shtesë.

7. Ndërmarrja rajonale Ujësjiellës Kanalizime Lezhë SHA ka kërkuar ndryshimin e tarifave, për vendosjen në një nivel të ri pas katër vitesh, të tarifave për shërbimin e FU dhe KUN referuar vlerësimit dhe analizës së kostove për ofrimin e këtij shërbimi.
8. Bazuar në metodologjinë për vendosjen e tarifave, të përcaktuara në Vendimin e KKRR-së nr. 539, datë 30.12. 2021 lidhur me treguesit e performancës, për secilën prej tyre janë vendosur objektiva të arritshme sipas ERRU-së për vitin 2024 dhe 2025 duke synuar përmirësimin e performancës së shërbimeve të ofruara, reduktimin e kostove të mirëmbajtjes dhe operimit, duke mundësuar reduktimin e humbjeve teknike dhe administrative, rritjen e qëndrueshmërisë financiare si edhe rritjen e mundësisë për përfitime të investimeve në shërbimet e ofruar.
9. Nga analiza ekonomiko-financiare, sipas ERRU-së, rezulton se ndërmarrjen rajonale Ujësjiellës Kanalizime Lezhë SHA pas miratimit të tarifave të reja do të ketë një nivel të pranueshëm të mbulimit të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes totale, që varion nga 37.06 % për vitin 2022 me një rritje 52 % për në fund të vitit 2025. Nevoja për të ardhura synon përmirësimin e nivelit të mbulimit të kostove O&M, i cili parashikohet të jetë në nivelin 99.5% në fund të vitit 2025.
10. ERRU bazuar në projekt vendimin e miratimit të tarifave gjykon se ndërmarrjen rajonale Ujësjiellës Kanalizime Lezhë SHA duhet të instaloj matësat në burim (Bulk metër), si edhe matësit familjarë, sidomos në zonat rurale ku shpërdorimi i ujit për vaditje është i lartë në mënyrë që të realizojë objektivin e vendosur nga ERRU për treguesit e nivelit të matjes; të kryejë vlerësimin e “ujit të prodhuar” bazuar në regjistrimet ditore të prodhimit, në çdo pikë ku ai përfitohet; të organizojë taks- forcën me ndihmën edhe të Bashkisë Lezhë për evidentimin dhe eliminimin e lidhjeve të paligjshme në rrjetin e furnizimit dhe abuzuesit kryesisht për klientët privat (hotele, bare dhe restorante) si dhe për klientët familjarë në zonat rurale; të trajtojë stafin teknik profesionist mbi njohjen, hartimin e Bilancit të Ujit me të dhënat sa më afër realitetit dhe përlllogaritjen e komponentëve të tij sa më të saktë, për të patuar situatën reale mbi ujin pa të ardhura; të merren masat dhe të bëhen korigjimet përkatëse gjatë hartimit të bilancit të Ujit për vitin 2023 dhe 2024 në vazhdim; të gjejë mundësitë për të nxjerrë jashtë pune rrjetin e vjetër të furnizimit, i cili shkakton humbje fizike në nivele të lartë; të mbaj nën kontroll të gjithë sistemin e furnizimit për të reaguar në kohën e duhur ndaj riparimeve të defekteve, për të minimizuar sa me shumë humbjet nga rrjedhjet; të hartojë urgjentisht Planin e Menaxhimit të Aseteve për të orientuar investimet sipas prioriteteve të përcaktuara në të në mënyrë që të evitohen vjetrimi i tyre përtej jetëgjatësisë së dobishme për të zvogëluar humbjen nga rrjedhjet dhe eliminimin e rrezikut të cenimit të shëndetit publik nga ndotjet dhe çarjet; Të mirëmbajë sistemet e informacionit teknik dhe financiar në përputhje me metodologjinë e vendosjes së tarifave që të mundësohet verifikimi i të dhënave të parashikuara për t'u realizuar në vitin 2024;

11. Në aspektin ekonomik, ERRU gjykon se ndërmarrja rajonale Ujësjetës Kanalizime Lezhë SHA duhet të mbajë në sistemet e kontabilitetit kostot e amortizimit të aseteve sipas kërkesave të ERRU referuar ndarjes për këtë qëllim, që ka bërë në këtë model aplikimi, në mënyrë që të verifikohet realizimi i investimit të parashikuar për t'u realizuar në vitin 2024; të ndërmarrë masa për përmirësimin e treguesit të normës korrente të arkëtimit duke zbatuar masat e nevojshme për këtë qëllim si; monitorimi i klientëve, ndërprerja e shërbimeve të klientëve që nuk paguajnë, shtimi i qendrave ku paguhen faturat, pagesat bankare apo pagesa on-line; të hartojë një organigramë të detajuar të stafit dhe përshkrimet përkatëse të punës dhe detaje të tjera që justifikojnë numrin e punonjësve në shoqëri; të monitorohet konsumi i energjisë dhe të menaxhohet për të fituar kontrollin mbi këto kosto, duke zbatuar një sistem për menaxhimin e energjisë, e cila për shoqërinë do të ishte një mënyrë për të zhvilluar dhe zbatuar një strategji afatgjatë për energjinë, duke ndjekur hapat si më poshtë:

- Të reduktojë humbjet e ujit, për çdo m³ ujë të humbur që është pompuar dhe ka shkaktuar konsum të energjisë si një nga masat më të rëndësishme për reduktimin e konsumit të energjisë,
- Të hartojë një data basë me të gjithë konsumin e energjisë (bazuar tek matësit, faturat e energjisë etj.) duke përfshirë të gjitha elementet e energjisë dhe sasitë korresponduese të konsumit dhe kostos,
- Të krahasoj dhe kontrollojë konsumin mujor të energjisë me muajin paraardhës, me të njëjtin muaj të vitit paraardhës dhe të shpjegojë nëse është më shumë dhe pse ka ardhur ky ndryshim,
- Të realizojë trajnime për efijencën e energjisë për stafin operativ.

12. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) bazuar në pikën 1/b të nenit 14 të Ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë edhe të largimit të përpunimit të ujërave të ndotura” ka kompetencë të miratojë çmimet dhe tarifatat e shitjes së ujit me shumicë dhe pakicë, tarifatat për ujërat e përdorura dhe tarifatat e trajtimit të tyre, afatet dhe kushtet e shërbimit, të ofruar nga operatorët, që sigurojnë ujë për konsum publik, edhe në rastet kur sistemet e ujësjetës kanalizimeve kanë kaluar në administrim ose në pronësi të njësisve të qeverisjes vendore. KKRR me anë të vendimit nr. 539, datë 30.12.2021 “Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjetës kanalizime” ka miratuar rregullat, procedurat, politikën tarifore dhe metodologjinë e vendosjes së tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të përpunimit të ujërave të ndotura.

13. Mbështetur në nenet 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, autoritetet e administratës qendrore dhe vendore, entet dhe institucionet e tjera rregullatorë, gjatë kryerjes së detyrave për rregullimin e veprimtarisë ekonomike në territorin e Republikës së Shqipërisë, janë të detyruara të zbatojnë dispozitat e këtij ligji dhe të sigurojnë një konkurrencë të ndershme dhe efektive dhe për arsye të interesit të përgjithshëm, Autoriteti

i Konkurrencës vlerëson, në veçanti, barrierat rregulluese të konkurrencës, të përfshira në rregullimin ekonomik dhe administrativ.

14. Propozimet për ndryshim të tarifa të shërbimit nga ndërmarrja e Ujësjetllës Kanalizimeve janë paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës dhe me vendimin nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit e ujërave të ndotura”, Komisioni i Konkurrencës i ka rekomanduar Entit Rregullator të Ujit:
- a. Detyrimin për zbatimin e nenit 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, duke kërkuar vlerësimin ligjor të Autoritetit të Konkurrencës për çdo projekt-akt normativ që potencialisht mund të sjellë kufizime të konkurrencës në tregun përkatës.
 - b. Për çdo rast të rishikimit të tarifave të reja për ndërmarrjet e ujësjetllës kanalizime, të përcaktohet qartë struktura e kostos mbi bazën e së cilës miratohen tarifat, bazuar në metodologjinë “Për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimit e ujërave të ndotura”, në të cilën përfshihen kostot e: - Tarifës së ujit për shitje sipas kategorive të konsumatorëve; - Tarifës për Shërbimin e Grumbullimit, Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura ; - Tarifës së shërbimit.
 - c. Rritja e tarifave duhet të jetë graduale dhe në përputhje me kriteret e performancës, në mënyrë të veçantë të orarit të furnizimit me ujë.
 - d. Të rishikohen kostot në drejtim të rritjes së performancës së administrimit dhe të rishpërndahen burimet e të ardhurave të kërkuara për investime edhe nga ulja e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes pasi sipas vendimit të ardhurat do të vijnë në masën 96% nga rritja e tarifave, dhe vetëm 4% nga rritja e nivelit të faturimit.
 - e. Publikimin dhe bërjen transparente brenda 30 ditëve nga dalja e këtij vendimi të të gjithë informacionit në lidhje me aplikimet për ndryshimin e tarifave, kostot përkatëse mbi të cilat bazohen këto ndryshime, si dhe për vitet 2018 dhe 2019 të publikohen treguesit e parashikuar për “ujin pa të ardhura”, “Kohëzgjatjen e furnizimit” dhe “Eficiencën e stafit”.
15. Në zbatim të këtij vendimi, Komisioni i Konkurrencës ka vlerësuar disa vendime të marra nga ERRU për miratimin e ndryshimit të tarifave të shërbimit nga ndërmarrje të Ujësjetllës Kanalizimeve.
16. Komisioni i Konkurrencës me vendimin nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit mbi aplikimin për ndryshimin e nivelit tarifor për ndërmarrjen “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” SHA, i ka rekomanduar Entit Rregullator të Ujit si vijon:

- a. Tarifat e ndryshuara që do të miratohen nga ERRU për Ndërmarrjen Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Lezhë SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve dhe të jenë të bazuara në parimin e mosdiskriminimit.
 - b. ERRU të kërkoj nga Ndërmarrjen Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Lezhë SHA, ndarjen e kostove për të dyja shërbimet e ofruara duke njoftuar AK brenda 90 ditëve për realizimin e këtij rekomandimi.
 - c. ERRU të kryej auditimin (verifikimin) vjetor të përputhshmërisë në sistemin e llogaritjes së kostos. Të bëj transparente përshkrimin e sistemit të llogaritjes së kostos.
17. Nga analiza e konkurrencës rezulton se ndërmarrjen rajonale Ujësjetllës Kanalizime Lezhë SHA ka pozitë dominuese dhe si e tillë, në kuptim të nenit 9 pika 1 e Ligjit nr. 9121/2003 ka detyrimin e mos abuzojë me pozitën dominuese veçanërisht në vendosjen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të çmimeve të padrejta të blerjes ose shitjes apo e kushteve të tjera të padrejta të tregtimit. Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës i ka rekomanduar ERRU, si autoriteti përgjegjës për miratimin e tarifave, orientimin e çmimeve të shërbimit drejt kostos për ndërmarrjen rajonale Ujësjetllës Kanalizime Lezhë SHA.
18. Në aplikimin për nivel të ri të tarifës për FU dhe KUN, ERRU, e gjen të nevojshme ndryshimin e nivelit tarifor për tarifën variabël dhe fikse të FU dhe KUN për ndërmarrjen rajonale Ujësjetllës Kanalizime Lezhë SHA, por jo në nivelet që propozon Ndërmarrja. ERRU e ka bazuar analizën e përcaktimit të tarifave në Vendimin nr.539, datë 30.12.2021” Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve të ujësjetllës kanalizime” duke analizuar të dhënat që përcaktojnë tarifën (kostot operacionale, vëllimet e faturave dhe numrin e klientëve) të realizuar në vitin bazë (viti 2022) dhe duke aplikuar koeficientin tarifor për përcaktimin e tarifave për kategoritë e klientëve jo familjarë.
19. Procedura e miratimit të tarifave nga ERRU, bazuar në pikën 1 të nenit 13 të Metodologjisë së miratimit të tarifave sipas Vendimit të KKRR nr. 539/2021 përmban dhe aprovimin e prezantimit për në Seancën Dëgjimore me Publikun të tarifave dhe zhvillimin e tyre. Sipas verifikimit të faqes zyrtare të web-it të Bashkisë Lezhë, Kurbin, Mirëditë si edhe të Ndërmarrjes Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Lezhë SHA, konstatojmë se seanca dëgjimore në lidhje me propozimin për ndryshim tarife kundrejt konsumatorëve familjarë, publik dhe jo familjarë, nuk janë publike.
20. ERRU në analizën ekonomike financiare të saj ka marrë në konsideratë kostot për të dy shërbimet e ofruara, duke zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje

me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit e ujërave të ndotura”, pika (I), germa (b).

21. Konstatohet se vetëm vendimi për fillimin e procedurës për ndryshimin e tarifave është bërë transparent në faqen e ERRU-së, duke marrë në konsideratë rekomandimi i dhënë nga Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 492, datë 28.12.2017 “Për dhënien e disa rekomandimeve Entit Rregullator të Ujit dhe UKT në lidhje me ndryshimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit e ujërave të ndotura”, pika (I), germa (e).

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenet 24, germa (d) e (f); 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

I. T’i rekomandojë Entit Rregullator të Ujit si vijon:

1. Tarifat e ndryshuara, që do të miratohen nga ERRU për ndërmarrjen rajonale Ujës-jellës Kanalizime Lezhë SHA, të jenë të orientuara drejt kostos së shërbimeve dhe të jenë të bazuara në parimin e mosdiskriminimit.
2. Miratimi i ndryshimit të tarifave, të marra në shqyrtim nga KKRR, të jetë i publikuar në faqen zyrtare elektronike të ERRU-së.
3. Të bëhen transparente në faqen zyrtare të Bashkisë Lezhë, Kurbin, Mirditë ndërmarrjen rajonale Ujës-jellës Kanalizime Lezhë SHA seancat e zhvilluara të dëgjësës publike më palët e interesit për propozimin e ndryshimit të tarifave.

II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1062 , Datë 06. 03. 2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT, ME FUNKSIONE TË PLOTA, NGA SHOQËRITË FORD MOTOR COMPANY, BMW (US) HOLDING CORP. DHE AMERICAN HONDA MOTOR CO., INC.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 06.03.2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota, nga shoqëritë Ford Motor Company, BMW (US) Holding Corp. dhe American Honda Motor Co., Inc..

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota nga shoqëritë Ford Motor Company, BMW (US) Holding Corp. dhe American Honda Motor Co., Inc.,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës, u depozitua njoftimi në lidhje me krijimin e një ndërmarrje të përbashkët / joint – venture, me funksione të plota, nga shoqëritë Ford Motor Company, BMW (US) Holding Corp. dhe American Honda Motor Co., Inc..

Referuar dokumentit “Marrëveshje Master e Transaksionit”, palët në transaksion janë:

Pala 1: Ford Motor Company është një shoqëri globale, e themeluar nga themeluesi Henri Ford

sipas legjislacionit të shtetit Delaware. Ford Motor Company zhvillon dhe ofron kamionë inovativë Ford, automjete sportive, furgona dhe makina komerciale dhe automjete luksoze Lincoln, së bashku me shërbimet e lidhura.

Ford Motor Company është shoqëria mëmë fundore e Ford Group dhe është e listuar në bursën e Nju Jorkut dhe kontrollohet nga familja Ford, me pronësi në pakicë por me shumicë të të drejtave të votës.

Pala 2: BMW (US) Holding Corp. u themelua sipas legjislacionit të shtetit Delaware. Linja e biznesit të kompanisë përfshin prodhimin e produkteve të stampimit të automobilave.

BMW (US) Holding Corp. është një degë e zotëruar plotësisht nga BMW Group, e drejtuar nga Bayerische Motoren Werke Aktiengesellschaft, një shoqëri aksionare e listuar publikisht. BMW Group zhvillon dhe prodhon automobila dhe motoçikleta novatore, Premium në të gjithë botën.

Pala 3: American Honda Motor Co., Inc është një shoqëri aksionare e regjistruar sipas legjislacionit të Shtetit të Kalifornisë. Shoqëria mbikëqyr shitjet e produkteve dhe aktivitetet e shërbimit në SHBA si dhe koordinon funksionet rajonale midis shoqërive Honda në Amerikën e Veriut dhe është përgjegjëse për shpërndarjen, marketingun dhe shitjet e automobilave të markave Honda dhe Acura, produkteve Honda Powersports, produkteve Honda Engines dhe motorëve Honda Marine në Shtetet e Bashkuara.

American Honda Motor Co., Inc është dega Amerikano-Veriore e Honda Motor Co. Ltd., shoqëria mëmë fundore e Honda Group.

Ndërmarrja e Përbashkët (JV), ChargeScape LLC, do të organizohet si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e cila do të jetë aktive në ofrimin e shërbimeve të rrjetit për kompanitë e shërbimeve elektrike dhe operatorët e sistemit, nëpërmjet menaxhimit inteligjent të ngarkesës dhe grumbullimit të të dhënave të energjisë së baterisë së automjeteve elektrike.

Ndërmarrja e përbashkët do të krijohet me synimin që të jetë një sipërmarrje e përbashkët me funksione të plota, dhe të kryejë mbi baza të qëndrueshme të gjitha funksionet e një entiteti ekonomik autonom.

II. Përqendrimi

Më datë 30 gusht 2023, ndërmjet palëve Ford Motor Company, BMW (US) Holding Corp. dhe American Honda Motor Co., Inc është nënshkruar dokumenti “Marrëveshje Master i Transaksionit”.

Referuar kësaj Marrëveshje, përpara mbylljes, American Honda Motor Co., Inc do të krijojë ChargeScape LLC si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me Ligjin e Shoqërive me Përgjegjësi të Kufizuar të shtetit Delaware dhe do të zotërojë të gjitha njësitë fillestare.

Në varësi të kushteve të mëtejshme të kësaj Marrëveshje në lidhje me mbylljen (i) shoqëria American Honda Motor Co., Inc do të shesë dhe transferojë tek shoqëria Ford Motor Company

1/3 e njërive fillestare në pronësi të American Honda Motor Co., Inc (ii) dhe më pas shoqëria American Honda Motor Co., Inc do të shesë dhe transferojë tek shoqëria BMW (US) Holding Corp. po 1/3 e njërive fillestare në pronësi të American Honda Motor Co., Inc.

Secila nga Palët do të zotërojë më pas 1/3 e njërive fillestare në shoqërinë ChargeScape LLC. Palët pjesëmarrëse në transaksion dhe shoqëria ChargeScape LLC do të ekzekutojnë dhe dorëzojnë Marrëveshjen e Shoqërisë më Përgjegjësi të Kufizuar dhe secila nga palët do të pranohet si Anëtar Themelues i Shoqërisë.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar është krijimi i një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota (JV), nga shoqëritë Ford Motor Company, BMW (US) Holding Corp. dhe American Honda Motor Co., Inc, duke plotësuar kriteret e parashikuara në nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Në zbatim të nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i ofrimeve të shërbimeve të rrjetit për shoqëritë e shërbimeve elektrike, nëpërmjet menaxhimit inteligjent të ngarkesës dhe grumbullimit të të dhënave të energjisë së automjeteve elektrike.

Ford Motor Company është një korporatë, e cila zhvillon dhe ofron kamionë inovativë Ford, automjete sportive, furgona dhe makina komerciale dhe automjete luksoze Lincoln, së bashku me shërbimet e lidhura. Ford nuk ka filial, degë apo zyrë përfaqësimi në Shqipëri, por realizon xhiro nëpërmjet shitjeve të palëve të treta.

BMW (US) Holding Corp. është një prodhues mbarëkombëtar i automobilave dhe motoçikletave duke përfshirë pjesë këmbimi dhe pajisjet e nevojshme. BMW (US) Holding Corp. nuk ka filial të regjistruar në Shqipëri, por është e pranishme nëpërmjet distributorëve të pavarur.

American Honda Motor CO., Inc. është një prodhues pajisjesh origjinale me bazë në Japoni, e cila prodhon dhe shet automobila (përfshirë automjetet elektrike hibride plug-in dhe automjete elektrike me bateri (“BEVs”), motocikleta dhe produkte energjie etj. American Honda Motor Co., Inc nuk ka filial të regjistruar në Shqipëri dhe nuk realizon të ardhura.

Ndërmarrja e përbashkët (JV) ChargeScape LLC do të jetë aktive në ofrimin e shërbimeve të rrjetit për kompanitë e shërbimeve elektrike dhe operatorët e sistemit, nëpërmjet menaxhimit inteligjent të ngarkesës dhe grumbullimit të të dhënave të energjisë së baterisë së automjeteve elektrike (“EV”).

Shoqëria ChargeScape LLC do të jetë funksionale në SHBA dhe Kanada dhe nuk është planifikuar që ChargeScape LLC të ketë ndonjë aktivitet në Shqipëri.

Asnjë nga Palët dhe as Sipërmarrja e Përbashkët nuk kanë aktivitet në tregun përkatës të produktit në Shqipëri.

Transaksioni nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë Ford Motor Company, BMW (US) Holding Corp. dhe American Honda Motor Co., Inc..
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1063 , Datë 06. 03. 2024

“ MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PËRKOHSHËM, TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRIVE NEOEN RENEWABLES CROATIA D.O.O. DHE FAZAN SOL D.O.O. NGA SHOQËRIA STATKRAFT OIE D.O.O...”.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 06.03.2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të përkohshëm i realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërive Neoen Renewables Croatia d.o.o. dhe Fazan Sol d.o.o. nga shoqëria Statkraft OIE d.o.o..

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërive Neoen Renewables Croatia d.o.o. dhe Fazan Sol d.o.o. nga shoqëria Statkraft OIE d.o.o...

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi transaksionin e propozuar për blerjen e aksioneve të shoqërive Neoen Renewables Croatia d.o.o. dhe Fazan Sol d.o.o. nga shoqëria Statkraft OIE d.o.o..

Referuar dokumentit “Marrëveshje për shitblerjen e aksionesh”, Draft Paraparak, palët pjesëmarrëse në transaksion janë:

Pala blerëse: Statkraft OIE d.o.o. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit kroat, pjesë e Grupit Statkraft. Aktiviteti i shoqërisë kufizohet në projektimin dhe prodhimin e energjisë elektrike, konkretisht në: transmetim, organizim, tregtim, ruajtje, shpërndarje të energjisë elektrike; menaxhim i objekteve energjetike; projektim, ndërtim dhe mbikëqyrje të ekspertëve të ndërtimit; veprimtari të ekzaminimit dhe analizës teknike etj

Shoqëria zotërohet nga Statkraft European Wind and Solar Holding AS, një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit norvegjez. Aktiviteti i shoqërisë kufizohet në zotërimin e kuotave/aksioneve (direkt ose indirekt) në shoqëritë që zotërohen tërësisht ose pjesërisht nga Grupi Statkraft.

Grupi Statkraft është i pranishëm në Shqipëri, nëpërmjet filialeve të zotëruara tërësisht nga shoqëria Statkraft Markets B.V:

Statkraft Renewables Albania SHPK, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt: veprimtari studimi, projektimi, ndërtimi, operimi dhe administrimi i impianteve fotovoltaike dhe i sistemeve të lidhura me to, për prodhimin e energjisë nga dielli, riparimi i tyre si dhe mirëmbajtja dhe mbështetja teknike etj.

Devoll Hydropower SHA, një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt: planifikimi, ndërtimi, mirëmbajtja dhe funksionimi i tre njësisve prodhuese hidroelektrike me një kapacitet të kombinuar të instaluar përafërsisht 319 MW në Luginën e Devollit, përafërsisht midis lartësive 806 dhe 95 metra mbi nivelin e detit si edhe shitja e elektricitetit të prodhuar në Shqipëri dhe jashtë saj.

Pala shitëse:

1- Neoen, Soci t  Anonyme (Neoen SA) është një shoqëri anonime, e themeluar sipas legjislacionit francez.

2- Neoen Holdings Croatia I, S.A.S, është një shoqëri holding, e themeluar dhe në përputhje me legjislacionin francez.

Shoqëritë Target:

1- Neoen Renewables Croatia d.o.o. (NRC), është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e organizuar sipas legjislacionit të Kroacisë. Referuar ekstraktit të shoqërisë, objekt i saj i aktivitetit është: menaxhimi i projekteve të ndërtimit, veprimtari të ekzaminimit dhe analizës teknike; kryerja e investimeve jashtë vendit dhe dhënia e këtyre punimeve investuese personave të huaj në Republikën e Kroacisë; prodhim, transmetim, ruajtje, menaxhim, furnizim tregtim i energjisë elektrike; prodhim i pajisjeve për shpërndarjen dhe kontrollin e energjisë elektrike; projektim, prodhim, montim dhe mirëmbajtje e impianteve për prodhimin e energjisë elektrike, objekteve industriale etj

Shoqëria target zotërohet nga Neoen SA dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

2- Fazan Sol d.o.o. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e organizuar sipas legjislacionit

të Kroacisë. Referuar ekstraktit të shoqërisë, objekt i saj i aktivitetit është: menaxhimi i projekteve të ndërtimit, veprimtari të ekzaminimit dhe analizës teknike; prodhim, transmetim, ruajtje, menaxhim, furnizim tregtim i energjisë elektrike; prodhim i pajisjeve për shpërndarjen dhe kontrollin e energjisë elektrike; projektim, prodhim, montim dhe mirëmbajtje e impianteve për prodhimin e energjisë elektrike, objekteve industriale etj.

Shoqëria target zotërohet nga Neoen Holdins Croatia I, S.A.S dhe nuk realizon të ardhura në Shqipëri.

II. Përqendrimi

Referuar draft dokumentit “Marrëveshje shitblerje aksionesh”, shoqëritë Statkraft OIE d.o.o. (blerësi); shoqëritë Neoen, Soci  t   Anonyme dhe Neoen Holdins Croatia I, S.A.S (shit  sit), synojn   t   realizojn   transaksionin e shitblerjes s   aksioneve t   shoq  rive Neoen Renewables Croatia d.o.o. dhe Fazan Sol d.o.o.

Duke qen   se aktiviteti, pronar  t e fundit p  rfitues, bordi i administrimit dhe operacionet e biznesit jan   t   nd  rthurura (Neoen Holdins Croatia I, S.A.S kontrollohet nga Neoen, Soci  t   Anonyme), transaksioni parashikohet si nj   marr  veshje paket  .

Referuar dokumentacionit t   depozituar, transaksioni i propozuar p  rb  n nj   p  rqendrim n   kuptim t   nenit 10 dhe 12 t   ligjit nr. 9121 dat   28.07.2003 “P  r mbrojtjen e konkurrenc  s”, i cili   sht   objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrenc  s.

Sipas nenit 3, pika 7, t   ligjit nr. 9121, dat   28.07.2003 “P  r mbrojtjen e konkurrenc  s”, si edhe Udh  zimit nr.76, dat   07.04.2008 “P  r p  rcaktimin e tregut p  rkat  s”, treg p  rkat  s i produktit do t   konsiderohet tregu i prodhimit dhe ruajtjes s   energjis   elektrike nga burime t   rinovueshme, por duke qen   se transaksioni nuk do t   ket   ndikim n   tregun shqiptar, tregu p  rkat  s i produktit do t   lihet i hapur. Tregu p  rkat  s gjeografik do t   konsiderohet territori i Republik  s s   Shqip  ris  .

Pala njoftuese na b  n me dije se procesi i pritjes s   miratimit t   transaksionit t   propozuar nga Autoriteti i Konkurrenc  s shkakton vonesa p  r k  t   transaksion dhe pal  t do t   kishin pasoja t   pariparueshme p  r shkak se marr  veshja nuk do t   arrij   t   lidhet. N   zbatim t   nenit 60 pika 1 t   ligjit 9121/2003, pala njoftuese ka k  rkuar Autorizimin e P  rqendrimit t   P  rkohsh  m deri n   momentin e n  nshkrimit t   marr  veshjes nga pal  t.

P  rqendrimi i njoftuar pritet t   mos krijoj   mbivendosje ose marr  dh  nie t   rrjedh  s s   sip  rme apo t   poshtme midis aktiviteteve t   pal  ve n   nivel komb  tar.

P  r sa m   sip  r, bazuar n   nenin 60 t   ligjit nr. 9121, dat   28.07.2003 “P  r mbrojtjen e konkurrenc  s” dhe n   k  rkes  n e pal  s njoftuese p  r pajisjen me autorizim t   p  rqendrimit t   p  rkohsh  m, Autoriteti i Konkurrenc  s gjykon t   nevojsh  m dh  nien e autorizimit t   p  rqendrimit t   p  rkohsh  m deri n   depozitimin e marr  veshjes s   n  nshkruar nga pal  t pjes  marr  se n   transaksion.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d, nenit 60 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I.** Të autorizojë përkohësisht përqendrimin e realizuar nëpërmjet blerjes së propozuar të aksioneve të shoqërive Neoen Renewables Croatia d.o.o. dhe Fazan Sol d.o.o. nga shoqëria Statkraft OIE d.o.o..
- II.** Autorizimi i përqendrimit të përkohshëm do të jetë i vlefshëm deri në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes nga palët në transaksion.
- III.** Pala njoftuese ka detyrimin të depozitojë pranë Autoritetit të Konkurrencës marrëveshjen e nënshkruar nga palët pjesëmarrëse në transaksion, pas të cilës Sekretariati do të fillojë procedurën e kontrollit të përqendrimeve bazuar në nenet 53-64 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.
- IV.** Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr.1064, Datë 19. 03. 2024

“MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR MBI VEPRIMTARINË E AUTORITETIT TË KONKURENCËS PËR VITIN 2023 DHE PRIORITETET KRYESORE PËR VITIN 2024”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 19.03.2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Miratimin e Raportit Vjetor mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2023 dhe prioritetet për vitin 2024.

Baza Ligjore: Neni 24, shkronja (d) dhe (e), neni 26 dhe neni 29, pika 2, shkronja (ç) të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;
- Draft Raportit Vjetor mbi veprimtarinë e Autoritetit të konkurrencës për vitin 2023 dhe prioritetet për vitin 2024,

VËREN SE :

Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, bazuar në nenin 29, pika 2, shkronja (ç) të Ligjit nr.9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar, ka depozituar Draft Raportin vjetor mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2023 dhe prioritetet kryesore për vitin 2024.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d) dhe (e), nenin 26 dhe nenin 29, pika 2, shkronja (ç) të Ligjit nr.9121, date 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar;

VENDOSI:

1. Miratimin e "Raporti Vjetor mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2023 dhe prioritetet kryesore për vitin 2024", sipas tekstit që i bashkelidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1065 , Datë 19. 03. 2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT NGA SHOQËRITË MIELE BETEILIGUNGS-GMBH (INTERNATIONAL STEEL CO. S.P.A.) DHE METALL ZUG AG (BELIMED AG DHE BELIMED LIFE SCIENCE AG), ME KONTROLL TË VETËM NGA MIELE”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 19.03.2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti:

Autorizimi i përqendrimit të propozuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët nga shoqëritë Miele Beteiligungs-GmbH (International Steel Co. S.p.A.) dhe Metall Zug AG (Belimed AG dhe Belimed Life Science AG), me kontroll të vetëm nga Miele.

Baza Ligjore:

Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”; Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të propozuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët nga shoqëritë Miele Beteiligungs-GmbH (International Steel Co. S.p.A.) dhe Metall Zug AG (Belimed AG dhe Belimed Life Science AG), me kontroll të vetëm nga Miele,

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121,

datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e propozuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët nga shoqëritë Miele Beteiligungs-GmbH (International Steel Co. S.p.A.) dhe Metall Zug AG (Belimed AG dhe Belimed Life Science AG), me kontroll të vetëm nga Miele.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1066 , Datë 19. 03. 2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET KRIJIMIT TË NJË NDËRMARRJE TË PËRBASHKËT ME FUNKSIONE TË PLOTA, PERUTNINA PTUJ ALBANIA SHPK DHE PËRFTIMI I KONTROLLIT NGA KJO E FUNDIT MBI SHOQËRITË DRIZA SHPK, FRESH CHICKEN ALBANIA 2019 SHPK, INDUSTRIA FORAGJERE (VEAF) SHA DHE BIZNESIN E SHOQËRISË EURO ALB 2009 SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 19.03.2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti:

Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota, Perutnina Ptuj Albania SHPK dhe përfthimi i kontrollit nga kjo e fundit mbi shoqëritë Driza SHPK, Fresh Chicken Albania 2019 SHPK, Industria Foragjere (VEAF) SHA dhe biznesin e shoqërisë Euro Alb 2009 SHPK.

Baza Ligjore:

Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota, Perutnina Ptuj Albania SHPK dhe përfthimi i kontrollit nga kjo e fundit mbi shoqëritë Driza SHPK, Fresh Chicken Albania 2019 SHPK, Industria Foragjere (VEAF) SHA dhe biznesin e shoqërisë Euro Alb 2009 SHPK,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës u depozitua njoftimi në lidhje me krijimin e një ndërmarrje të përbashkët / joint – venture, me funksione të plota, Perutnina Ptuj Albania SHPK dhe përftimi i kontrollit mbi shoqëritë Driza SHPK, Fresh Chicken Albania 2019 SHPK, Industria Foragjere (VEAF) SHA dhe biznesit të shoqërisë Euro Alb 2009 SHPK.

Referuar dokumenteve të nënshkruara, palët në transaksion janë:

Pala blerëse: Perutnina Ptuj Albania SHPK do të jetë një ndërmarrje e përbashkët, e cila do të themelohet nga shoqëritë PERUTNINA PTUJ d.o.o. dhe Balfin - Balkan Finance Investment Group SHPK, sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Qëllimi dhe objekti i veprimtarisë së JV do të jetë investimi në industrinë e shpendëve duke blerë në mënyrë strategjike shoqëri, shoqëri në aktivitet dhe asete.

PERUTNINA PTUJ d.o.o. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Sllovenisë. Objekti i shoqërisë është mbarështimi i shpendëve, prodhimi i ushqimit për kafshët, prodhimi i mishit të shpendëve dhe produkteve, tregtia dhe shërbimet.

PERUTNINA PTUJ d.o.o. është pjesë e Grupit Perutnina, i cili është aktiv në shitjen e mishit të shpendëve dhe produkteve të mishit në tregjet vendase ku ka kapacitetet e veta të prodhimit.

Grupi Perutnina është aktiv në Shqipëri vetëm nëpërmjet një distributori Kosmonte Foods Tirana SHPK.

Balfin - Balkan Finance Investment Group SHPK (Balfin SHPK) është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti: investimin në instrument financiar (të cilët përfshijnë pa kufizime titujt e pjesëmarrjes në kapitalin e shoqërive tregtare, titujt e borxhit, aksionet ose kuotat në fonde investimesh etj), investimin në pasuri të paluajtshme dhe në asete (të prekshme apo të paprekshme), ofrimin e shërbimeve të konsulencës për shoqëritë e kontrolluara prej saj dhe/ose nga të tretë (të cilët përfshijnë pa kufizime konsulencën e natyrës financiare, manaxheriale, ligjore, IT, zhvillim softuare etj).

Balfin SHPK zotërohet plotësisht nga z. Samir Mane.

Balfin SHPK (përfshirë dhe filialet e tij) është kryesisht aktiv në shitjen me pakicë, pasuri të paluajtshme, menaxhim asetesh, sektorin bankar, sektorin energjetik dhe nuk është aktiv në Shqipëri në tregjet ku operojnë shoqëritë target.

Pala shitëse: z. Hyqmet Driza; z. Sulo Driza dhe z. Besnik Driza, shtetas shqiptar.

Shoqëritë target:

Driza SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti grumbullimin, përpunimin, paketimin dhe depozitim në frigorifer të artikujve bujqësorë e blegtoralë; rritjen, mbarështimin dhe prodhimin e shpendëve, të produkteve dhe nënprodukteve të tyre brenda dhe jashtë vendit etj. Driza SHPK zotërohet plotësisht nga z.

Hyqmet Driza.

Fresh Chicken Albania 2019 SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti therjen e shpendëve për nevojat e veta dhe për llogari të të tretëve; grumbullimin, përpunimin, paketimin dhe depozitimin në frigorifer të artikujve bujqësorë dhe blegtoralë, të të gjithë llojeve të produkteve të përgatitura ose gjysëm të gatshëm, me origjinë bimore ose shtazore etj. Fresh Chicken Albania 2019 SHPK zotërohet plotësisht nga z. Sulo Driza.

Industria Foragjere (VEAF) SHA është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, aktive në ndërtimin e fabrikës së foragjereve, prodhimin dhe tregtimin (shitje me shumicë e pakicë) e foragjereve plotësuese, koncentrate, vitamina etj; tregtimin e lëndëve të para (miell peshku, miell mishi, drithëra, krunde, pite pambuku dhe produkte të tjera të kësaj natyre etj.

Industria Foragjere (VEAF) SHA zotërohet nga z. Hyqmet Driza dhe nga shoqëria Driza SHPK.

Euro Alb 2009 SHPK (Biznesi target) është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt aktiviteti grumbullimin, përpunimin, arkëtimin dhe depozitimin në frigorifer të artikujve bujqësorë dhe blegtoralë, rritjen dhe mbarështimin e prodhimit të shpendëve, të produkteve dhe të nënprodukteve të tyre me shumicë e pakicë brenda dhe jashtë vendit etj. Euro Alb 2009 SHPK zotërohet plotësisht nga z. Besnik Driza.

II. Përqendrimi

Më datë 08 dhjetor 2023, shoqëritë PERUTNINA PTUJ d.o.o. dhe Balfin - Balkan Finance Investment Group SHPK kanë nënshkruar dokumentin “Marrëveshja e Ortakëve”.

Referuar kësaj marrëveshje, palët do të krijojnë si fillim një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota, të quajtur Perutnina Ptuj Albania SHPK, e cila do të zotërohet 81% nga PERUTNINA PTUJ d.o.o. dhe 19% nga Balfin SHPK dhe do të kontrollohet në mënyrë të përbashkët nga të dyja shoqëritë.

Më datë 29 dhjetor 2023, shoqëritë PERUTNINA PTUJ d.o.o. dhe Balfin - Balkan Finance Investment Group SHPK (blerësit) dhe z. Hyqmet Driza dhe z. Sulo Driza (shitësit) kanë nënshkruar dokumentin “Marrëveshje për Blerje Aksionesh”, ku blerësit ka rënë dakord të blejnë, nëpërmjet një subjekti për qëllime të veçanta / SPV (nëkupton shoqërinë Perutnina Ptuj Albania SHPK që do të themelohet nga blerësit), 100% të kapitalit të shoqërisë Driza SHPK, 100% të kapitalit të shoqërisë Fresh Chicken Albania 2019 SHPK dhe 100% të kapitalit të shoqërisë Industria Foragjere (VEAF) SHA.

Transferimi i pronësisë së kapitalit do të ndodhë në datën e finalizimit, me kusht që të jenë përmbushur të gjitha kushtet praraprake, ku përfshihet çdo miratim ose leje e nevojshme lidhur me transaksionin e parashikuar nga kjo Marrëveshje, në lidhje me konkurrencën ose rregullorë të ngjashëm sipas ligjit në fuqi.

Më datë 29 dhjetor 2023, shoqëritë Euro Alb 2009 SHPK (shitësi) dhe PERUTNINA PTUJ d.o.o. dhe Balfin - Balkan Finance Investment Group SHPK (blerësit) kanë nënshkruar dokumentin “Marrëveshja e Transferimit të Biznesit”.

Me anë të kësaj marrëveshje është rënë dakord që blerësit, nëpërmjet shoqërisë Perutnina Ptuj Albania SHPK, do të blejnë një pjesë të aktivitetit/ biznesit të shoqërisë Euro Alb 2009 SHPK.

Sipas Udhëzimit “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”, pika 1.3 “Objekti i Kontrollit” parashikohet se përftimi i kontrollit mbi asetet mund të konsiderohet një përqendrim, vetëm nëse këto asete përbëjnë ndërmarrjen si një e tërë ose një pjesë të saj, d.m.th. një biznes me një përfaqësim në treg, e cila ka një xhiro vjetore tregu.

Nga vlerësimi i dokumentacionit konstatohet se ortakëria e shoqërisë Euro Alb 2009 SHPK nuk do të ndryshojë, pasi nuk do të ketë transferim kuotash. Pjesa e biznesit që do të transferohet është pjesa më e rëndësishme e veprimtarisë së Euro Alb 2009 SHPK, që përbën një biznes me përfaqësim në treg, e cila krijon xhiro.

Në përfundim të transaksionit të propozuar, shoqëria Perutnina Ptuj Albania SHPK do të zotërojë 100% shoqëritë Driza SHPK, Fresh Chicken Albania 2019 SHPK, Industria Foragjere (VEAF) SHA dhe pjesën e biznesit të shoqërisë Euro Alb 2009 SHPK.

Referuar Udhëzimit “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” parashikohet se dy ose më shumë transaksione përbëjnë një përqendrim të vetëm nëse ato janë unike në natyrë. Me qëllim që të përcaktohet natyra unike e transaksionit, është e nevojshme që këto transaksione të jenë të ndërvarura, në mënyrë të tillë që një transaksion nuk do të ishte kryer pa tjetrin. Kriteri që përcakton nëse transaksioni është i ndërvarur, kërkon që transaksionet të jenë të lidhura me kusht.

Transaksionet e mësipërme janë unike në natyrë, pasi janë të lidhura me njëra tjetrën dhe janë të kryera nga i njëjti blerës, Perutnina Ptuj Albania SHPK. Këto transaksione janë kushte dhe pasoja të njëri-tjetrit. Marrëveshjet e nënshkruara referojnë njëra-tjetrën në hyrje dhe paraqiten si të ndërlidhura. Marrëveshja për Blerje Aksionesh dhe Marrëveshja për Transferimin e Biznesit të shoqërisë Euro Alb 2009 SHPK, nuk do të përfundojnë pa u marrë miratimet për krijimin e ndërmarrjes së përbashkët.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i njoftuar është krijimi i një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota, Perutnina Ptuj Albania SHPK dhe përfitim të kontrollit nga kjo e fundit mbi shoqëritë Driza SHPK, Fresh Chicken Albania 2019 SHPK, Industria Foragjere (VEAF) SHA dhe biznesin e shoqërisë Euro Alb 2009 SHPK. Ky transaksion është në përputhje me pikën 2 dhe pikën 3 të nenit 10, nenin 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Kapitullit II, pjesa 1.3 “Objekti i kontrollit” dhe pjesa 1.5 “Transaksionet e ndërlidhura”, të Udhëzimit “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve”.

III. Analiza e Konkurrencës

Transaksioni i njoftuar konsiston në krijimin e një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota

(JV) Perutnina Ptuj Albania SHPK dhe përfitim të kontrollit nga kjo e fundit mbi shoqëritë Driza SHPK, Fresh Chicken Albania 2019 SHPK, Industria Foragjere (VEAF) SHA dhe biznesin e shoqërisë Euro Alb 2009 SHPK.

Grupi Perutnina operon në tregun e shitjes së mishit të shpendëve dhe produkteve të mishit. Grupi Perutnina realizon të ardhura në Shqipëri, nëpërmjet shitjeve përmes një distributori, të cilat për vitin 2023 përfaqësonin më pak se 1% të vlerës totale të shitjeve të mishit të shpendëve dhe produkteve të Grupit Perutnina.

Balfin SHPK nuk është aktiv në Shqipëri në tregjet ku operojnë shoqëritë target. Nëpërmjet filialeve të saj (Spar SHPK dhe Tirana East Gate SHPK) Balfin mund të konsiderohet se vepron në mënyrë të tërthortë në një marrëdhënie vertikale me shoqëritë target.

Shoqëritë Driza SHPK operon kryesisht në tregun e furnizimit me mish të freskët shpendësh; Fresh Chicken Albania 2019 SHPK operon në tregun e rritjes së shpendëve për therje; Industria Foragjere (VEAF) SHA operon në tregun e prodhimit të ushqimit të kafshëve dhe Euro Alb 2009 SHPK operon në tregun e tregtimit të artikujve të ndryshëm të konsumit të gjerë.

Nga objekti i aktivitetit të shoqërive target, vihet re se ato janë të lidhura midis tyre në proceset teknologjike, duke qenë pjesë e një zinxhiri, duke filluar nga mbarështimi i shpendëve, rritja e shpendëve për therje, furnizimi me mish të shpendëve dhe produkteve nga mishi i shpendëve, si dhe prodhimi i ushqimit të kafshëve.

Sipas nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, tregu përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i rritjes, mbarështimit dhe furnizimit me mish të shpendëve dhe nënprodukte të mishit të shpendëve, si dhe tregu i prodhimit të ushqimit të kafshëve. Tregu përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Në tregun e rritjes, mbarështimit dhe furnizimit me mish të shpendëve dhe nënprodukte të mishit të shpendëve, si dhe në tregun e prodhimit të ushqimit të kafshëve nuk ka mbivendosje të aktivitetit të palëve në transaksion, për më tepër tregjet paraqiten me një numër të konsiderueshëm konkurrentësh, duke bërë që konsumatorët të kenë një gamë të gjerë zgjedhjesh.

Pjesët e kombinuara të tregut të shoqërive në tregun shqiptar janë nën 20% dhe kjo përqindje nuk ndryshon pas realizimit të transaksionit.

Transaksioni i propozuar nuk do të rritë fuqinë e tregut të ndonjëres nga palët pjesëmarrëse në transaksion dhe pritet të mos sjell probleme për konkurrencën për sa i përket efekteve horizontale dhe vertikale.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të përbashkët, me funksione të plota, Perutnina Ptuj Albania SHPK dhe përftimi i kontrollit nga kjo e fundit mbi shoqëritë Driza SHPK, Fresh Chicken Albania 2019 SHPK, Industria Foragjere (VEAF) SHA dhe biznesin e shoqërisë Euro Alb 2009 SHPK.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1067, Datë 29. 03. 2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË PROPOZUAR MBI PËRFTIMIN E KONTROLLIT TË VETËM TË SHOQËRISË FORTENOVA GROUP MIDCO B.V. DHE TËRTHORAZI MBI FORTENOVA GROUP NGA SHOQËRIA OPEN PASS LIMITED”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29.03.2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit lidhur me përfitim e kontrollit të vetëm të shoqërisë Fortenova Group MidCo B.V. dhe tërthorazi mbi Fortenova Group nga shoqëria Open Pass Limited.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të propozuar mbi përfitim e kontrollit të vetëm të shoqërisë Fortenova Group MidCo B.V. dhe tërthorazi mbi Fortenova Group nga shoqëria Open Pass Limited,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës u depozitua njoftimi mbi përfitim e kontrollit të vetëm të shoqërisë Fortenova Group MidCo B.V. dhe tërthorazi mbi Fortenova Group nga shoqëria Open Pass Limited.

Referuar dokumentacionit të depozituar nga pala njoftuese, palët në transaksion janë:

-Open Pass Limited është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas legjislacionit

të Maltës. Open Pass Limited është një shoqëri holding e kontrolluar nga Gain Alliance Limited, shoqëri e cila zotërohet 70% nga Z. Pavao Vujnovac. Shoqëri të ndryshme të kontrolluara drejtpërdrejt apo tërthorazi nga Z.Pavao Vujnovac referohen si Grupi PV. Aktivitete kryesore të Grupi PV janë furnizimi me shumicë të frutave dhe perimeve, operimi i shoqërive të ndryshme në sektorin e energjisë, tregtimi, importi dhe furnizimi me gaz natyror dhe operimi në fushën e transportit hekurudhor në Kroaci.

-Fortenova Group Topco B.V. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Hollandës. Fortenova Group Topco B.V. zotërohet 100% nga shoqëria Fortenova Group STAK Stichting.

-Target: Fortenova Group MidCo B.V. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, sipas legjislacionit të Hollandës, me aktivitet të saj: Pronat Financiare. Fortenova Group MidCo B.V. operon si shoqëri holding për Grupin Fortenova. Aktualisht shoqëria target zotërohet 100% nga shoqëria Fortenova Group Topco B.V..

- Fortenova Group STAK Stichting është një fondacion i themeluar sipas legjislacionit të Hollandës.

-Iter BidCo B.V. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar rishtazi sipas legjislacionit të Hollandës dhe e zotëruar tërësisht nga shoqëria Iter STAK Stichting.

-Iter STAK Stichting është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar rishtazi sipas legjislacionit të Hollandës.

- Fortenova Group HoldCo B.V. është një shoqëri e organizuar sipas legjislacionit të Holandës.

- Fortenova Grupa d.d. është një shoqëri e organizuar sipas legjislacionit të Kroacisë.

Palët pjesëmarrëse në transaksionin e propozuar nuk kanë filiale të regjistruara në Republikën e Shqipërisë, por Grupi Fortenova ka realizuar xhiro në Shqipëri nëpërmjet tre shoqërive të grupit, të themeluara jashtë Shqipërisë.

II. Përqendrimi

Ndërmjet palëve pjesëmarrëse në transaksionin e propozuar, është lidhur “Marrëveshje për mbështetjen e transaksionit”, nënshkruar më datë 29 nëntor 2023, ndërmjet Fortenova Group Topco B.V., Fortenova Group STAK Stichting, Open Pass Limited, Iter STAK Stichting dhe Iter BidCo B.V..

Referuar pjesës së kushteve, bashkëlidhur Marrëveshjes, Fortenova Group Topco B.V. do të transferojë 100% të kuotave të shoqërisë target, Fortenova Group MidCo B.V., tek shoqëria Iter BidCo B.V., e cila zotërohet tërësisht nga shoqëria Iter STAK Stichting.

Pronësia e Iter STAK Stichting do të konsistojë fillimisht në një klasë të vetme çertifikatash

depozitimi/pronësie, Çertifikata/ DR dhe mbajtësi i secilës çertifikatë, të cilët kanë një status të ngjashëm si ortakë apo aksionarë në një shoqëri tradicionale me kapital, ku secila Çertifikatë/ DR do të japë të drejtën e një vote në lidhje me kuorumin, votat dhe pragjet e votave.

Open Pass Limited, do të nënshkruajë Çertifikatë/ DR në Iter STAK Stichting sipas një marrëveshje nënshkrimi dhe sigurie, së bashku me disa ortakë specifikë të tjerë të Fortenova Group Topco B.V., të cilët tregojnë interes.

Pas transaksionit ku përqindja e saktë e ortakërisë së Open Pass Limited do të varet nga masa e pjesëmarrjes/ interesit të mbajtësve të Çertifikatë/ DR nga mbajtësit specifikë, Open Pass Limited pritet të blejë të paktën 53% të Çertifikatave/kapitalit të Iter STAK Stichting, në varësi të pjesëmarrjes së mbajtësve të tjerë të Çertifikatave që do të riinvestojnë, duke fituar kështu kontrollin e vetëm mbi Iter STAK Stichting dhe tërthorazi, mbi Fortenova Group.

Referuar dokumentacionit të depozituar, transaksioni i propozuar përbën një përqendrim në kuptim të nenit 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i cili është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Analiza e konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, përcaktimi “treg përkatës”, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur, duke qenë se transaksioni nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar. Për analizimin e këtij rasti, treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Aktiviteti i Grupit Fortenova në Shqipëri përfshin: vajra ushqimorë, mish i përpunuar, erëza / salca të ftohta, pije joalkoolike, salca për bukën, yndyrë perimesh, pije me bazë kakao, salca ëmbëlsirash, yndyrna bimore etj.

Transaksioni i propozuar është përfitim i kontrollit të vetëm të shoqërisë Fortenova Group MidCo B.V. dhe tërthorazi mbi Fortenova Group nga shoqëria Open Pass Limited.

Shoqëria Open Pass Limited dhe Grupi PV nuk kanë prezencë ligjore në Shqipëri dhe nuk realizojnë të ardhura nga ofrimi i mallrave dhe shërbimeve për klientët që ndodhen në Shqipëri.

Grupi Fortenova nuk ka prezencë ligjore në Shqipëri por ka realizuar të ardhura nëpërmjet tre shoqërive të grupit, të themeluara jashtë Shqipërisë.

Transaksioni nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin lidhur me transaksionin e propozuar mbi përftimin e kontrollit të vetëm të shoqërisë Fortenova Group MidCo B.V. dhe tërthorazi mbi Fortenova Group nga shoqëria Open Pass Limited.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM

Nr. 1068 , Datë 29. 03. 2024

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË EUROSIG SHA NGA SHOQËRIA EURO-ALBA-EA SHPK”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Znj. Rezana KONOMI	Anëtar
Z. Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29.03.2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë EUROSIG SHA nga shoqëria EURO-ALBA-EA SHPK.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit”; Udhëzimi “Mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë EUROSIG SHA nga shoqëria EURO-ALBA-EA SHPK,

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës u depozitua njoftimi mbi zmadhimin e kapitalit të shoqërisë EUROSIG SHA dhe ndryshimin e pjesëmarrjes së aksionarëve ekzistues të kësaj shoqërie.

Referuar dokumentacionit të depozituar nga pala njoftuese, palët në transaksion janë:

EURO-ALBA-EA SHPK është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me objekt të aktivitetit të saj tregtimin e artikujve ushqimorë, industrialë,

import-eksport të mallrave, transportim i mallrave dhe pasagjerëve në linja urbane dhe ndërkombëtare, veprimtari në fushën e turizmit, të investimeve themelore duke marrë pjesë me mjetet e veta, veprimtari në fushën e prodhimit dhe të tregtisë së bukës dhe të prodhimeve të tjera ushqimore, shfrytëzim / tregtim dru zjarri e lëndë druri, materiale ndërtimi, tregtim çimento e gëlqere; prodhim, përpunim, mobilim dhe tregtim të prodhimeve, mallrave e materialeve duralumini, plastike, druri e guri, të materialeve të ndërtimit etj.

EURO-ALBA-EA SHPK zotërohet 100% nga z. Gazmen Neza.

EUROSIG SHA është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas legjislacionit shqiptar, e cila ka për objekt të veprimtarisë së saj ushtrimin e veprimtarisë së sigurimit dhe ri sigurimit, nëpërmjet përgatitjes, ofrimit, nënshkrimit dhe zbatimit të kontratave të sigurimit “Jo-Jetë”, sipas termave dhe klasave të përcaktuara në Ligjin Nr.52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimit”, akteve të tjera normative dhe për të cilat është e licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me licencën Nr. 7/2004, datë 22.06.2012.

EUROSIG SHA përpara transaksionit zotërohej: 58.207% nga z. Kadri Morinaj, 15.819% nga z. Xhevdet Morina, 0.281% nga z. Ylli Merkaj dhe **25.693% nga shoqëria EURO-ALBA-EA SHPK.**

EUROSIG SHA zotëron në mënyrë të drejtpërdrejtë 99.46% në Bankën e Bashkuar të Shqipërisë, 100% shoqërinë INSIG SH.A, 100% shoqërinë INSIG JETE SH.A; në mënyrë të tërthortë 100% shoqëritë EURO CREDIT SHPK dhe EUROSIG INVEST-Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive SHA (shoqëri me status pezulluar sepse është ende në proces licencimi). EUROSIG SHA operon në Kosovë nëpërmjet shoqërisë së zotëruar prej saj, EUROSIG KOSOVË SHA.

II. Përqendrimi

Me datë 22.12.2023, shoqëria EURO-ALBA-EA SHPK, me anë të vendimit të ortakut të vetëm, Z. Gazmen Neza, ka vendosur të kontribuojë në kapitalin themeltar të shoqërisë EUROSIG SHA, nëpërmjet kontributeve në mjete monetare, për shumën e xxx leke.

Me Vendimin nr. 21, datë 26.12.2023, Asambleja e Aksionarëve të shoqërisë EUROSIG SHA, ka vendosur: 1. Të miratojë zmadhimin e kapitalit të shoqërisë EUROSIG SHA nëpërmjet emetimit të aksioneve të reja, në vlerën e xxx lekë, të pagueshme me kontribute në mjete monetare, nga aksionari ekzistues, shoqëria EURO-ALBA.EA SHPK, duke e rritur kapitalin e shoqërisë nga xxx lekë në xxx lekë; 2. Të miratojë ndryshimet që vijnë si rezultat i kësaj rritje kapitali të paguar në mjete monetare, në numrin e aksioneve, si dhe vlerat e pjesëmarrjeve aksionare dhe kapitalin themeltar aksionar të shoqërisë EUROSIG SHA.

Me Vendimin nr. 21/1, datë 26.12.2023, Asambleja e Aksionarëve të shoqërisë EUROSIG SHA, ka vendosur që në statutin e shoqërisë EUROSIG SHA të ndryshohet neni 7, i cili pas ndryshimeve do të formulohet si vijon: Kapitali themeltar i shoqërisë është xxx lekë. Ai është i ndarë në xx aksione të themeluesve të shoqërisë, të cilat janë të së njëjtës kategori me vlerë xx lekë, për çdo

aksion. Pjesëmarrja e aksionarëve në kapitalin themeltar të shoqërisë do të jetë: 54.49% shoqëria EURO-ALBA-EA SHPK, 35.65% z. Kadri Morinaj, 9.69% z. Xhevdet Morina dhe 0.17% z. Ylli Merkaj.

Referuar Statutit të shoqërisë EUROSIG SHA, organet e shoqërisë janë: a) Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve, b) Këshilli Mbikëqyrës dhe c) Drejtori i Përgjithshëm /Administratori.

Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet të tilla si ndryshime në statut, emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, përcaktimin e politikave tregtare, emërimin dhe shkarkimin e administratorit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit, etj., me shumicën e votave të aksionarëve, që marrin pjesë.

Këshilli Mbikëqyrës i EUROSIG SHA përbëhet nga 3 anëtarë dhe merr vendime për zbatimin e legjislacionit në fuqi nga shoqëria e sigurimit; raportimin dhe informimin e Autoritetit Mbikëqyrës sipas dispozitave të ligjit nr.52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimit”; përgatit me kërkesë të Asamblesë së Përgjithshme marrjen e masave që janë në kompetencë të kësaj të fundit, i rekomandon asaj vendime të nevojshme për t’u marrë, si dhe zbaton vendimet e Asamblesë; thërret mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme sa herë vlerësohet e nevojshme në funksion të interesave të shoqërisë, etj.

Mbështetur në përqindjen e aksioneve të zotëruara nga shoqëria EURO-ALBA-EA SHPK pas kontributit në kapitalin e shoqërisë, si dhe vendimmarrjen nga organet drejtuese të shoqërisë, vlerësojmë se transaksioni i njoftuar konsiston në ndryshimin e kontrollit të shoqërisë EUROSIG SHA dhe përfundimin e kontrollit nga shoqëria EURO-ALBA-EA SHPK, transaksion i cili është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

III. Analiza e Konkurrencës

Sipas nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës i produktit do të konsiderohet tregu i sigurimeve (sigurimi i jetës dhe i jo jetës). Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

a) Struktura e tregut

Tregu i sigurimeve funksionon në zbatim të ligjit nr. 52, datë 22.05.2024 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe ri sigurimit” dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) është autoritet mbikëqyrës dhe rregullator i integruar i tregut të sigurimeve, të titujve, të sipërmarrjeve, të investimeve kolektive dhe të pensioneve private vullnetare në Shqipëri.

Referuar të dhënave të raportit vjetor të AMF-së konstatohet se gjatë vitit 2022 në tregun e sigurimeve ushtruan veprimtarinë e tyre 12 shoqëri sigurimi Jetë dhe Jo-Jetë, nga të cilat katër shoqëri sigurimesh ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sigurimet e Jetës dhe tetë shoqëri sigurimesh ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sigurimet e Jo-Jetës.

Shoqëria target, EUROSIG SHA, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe nëpërmjet shoqërive të kontrolluara prej saj, ushtron aktivitetin në tregun e sigurimit të Jetës dhe Jo-Jetës.

Tregu i sigurimit të Jo-Jetës.

Sipas nenit 4, pika 39 të ligjit, “Sigurim jo-jete” është sigurimi i rrezikut, i cili përfshin sigurimin e aksidenteve, sigurimin e sëmundjeve, sigurimin e mjeteve tokësore, sigurimin e mjeteve lëvizëse mbi shina, sigurimin e anijeve, etj.

Referuar vlerës së primeve të shkruara bruto gjatë vitit 2022 konstatohet rritje me 8.51% të primeve krahasuar me vitin 2021, të cilat erdhën kryesisht nga portofoli i sigurimit të detyrueshëm motorik, me rreth 80.35% e totalit të primeve në sigurimin e Jo-Jetës.

Në produktin e sigurimit të Jo-Jetës, shoqëria EUROSIG SHA ofron shërbimet vetë dhe nëpërmjet shoqërisë INSIG SHA. Sipas treguesit të primeve të shkruara bruto rezulton se pjesa e tregut e shoqërisë EUROSIG SHA gjatë dy viteve 2021-2022 dhe periudhës janar-shtator 2023 është xx%, ndërkohë që për shoqërinë INSIG SHA pjesa e tregut për të njëjtën periudhë është në vlerën xx%.

Tregu i sigurimit të jetës.

Sipas nenit 4, pika 38 të ligjit “Sigurim jete” është sigurimi i rrezikut, i cili përfshin: sigurimi i jetës, sigurimi martesë – lindje, sigurimi i jetës i lidhur me sipërmarrjet e investimeve kolektive, anuitetet (lloj pensioni), sigurimi shtesë i cili lidhet me kontratën e sigurimit të jetës, etj.

Në tregun e sigurimeve të Jetës ushtrojnë veprimtarinë e tyre 4 shoqëri. EUROSIG SHA, nëpërmjet shoqërisë së kontrolluar prej saj INSIG JETE SHA, ofron shërbimin e sigurimit të jetës.

Sipas të dhënave mbi primet e nënshkruara për sigurimin e jetës për periudhën 2021-2022 rezulton se pjesa e tregut e shoqërisë INSIG JETE SHA gjatë vitin 2021 ka qenë xx% me një trend rritës në vitin 2022 drejt vlerës xx%. Referuar të dhënave të AMF mbi primet e shkruara bruto, për periudhën janar – shtator 2023, pjesa e tregut të INSIG JETE SHA është xx%.

b) Efektet e përqendrimit.

Shoqëria EURO-ALBA-EA SHPK ushtron aktivitetin kryesisht në sektorin e ndërtimit, prodhim, përpunim, tregtim të mallrave e materialeve të ndërtimit (pavarësisht se objekti i veprimtarisë së saj është më i gjerë, ku përfshihen dhe aktivitetet në sektorët e tregtisë së artikujve ushqimorë, industrialë, import – eksport të mallrave, etj.).

Referuar Udhëzimit “Për vlerësimin e përqendrimeve jo horizontale dhe konglomerate”, konstatohet se transaksioni i njoftuar përbën një përqendrim konglomerat, pasi përqendrimet konglomerate ndodhin kur ndërmarrjet që marrin pjesë në përqendrim nuk kanë as marrëdhënie horizontale (si konkurrentë në të njëjtin treg përkatës) dhe as vertikale (si prodhues edhe klientë). Palët në transaksion operojnë në tregje të ndryshme.

Në përgjithësi, përqendrimet jo-horizontale nuk përbëjnë një kërcënim për konkurrencën efektive, vetëm nëse njëسيا e përqendruar ka një shkallë të konsiderueshme të fuqisë në treg në të paktën

një nga tregjet përkatëse, por kjo nuk do të thotë se njësia e përqendruar duhet të ketë pozitë dominuese. Referuar strukturës së tregut konstatohet se shoqëria EUROSIG SHA, për 9-mujorin e vitit 2023, zotëron rreth xx% të tregut të sigurimit të Jo-Jetës dhe xx% të tregut të sigurimit të Jetës.

Problemi kryesor në përqendrimet konglomerate është ai i përjashtimit nga tregu. Kombinimi i produkteve në tregjet e lidhura, mund t'i japë njësisë së përqendruar mundësinë dhe ta nxitë që të transmetojë një pozicion tregu të fuqishëm nga një treg në një tjetër me anë të praktikave kushtëzuese ose praktikave të tjera përjashtuese (të lidhura).

Referuar objektit të aktivitetit të palëve në transaksion, veprimtaria e EUROSIG SHA në tregun e sigurimit (jete dhe jo-jetë) është e ndarë nga aktivitetet e ndryshme tregtare që kryen EURO-ALBA-EA SHPK, pra tregjet përkatëse ku operojnë shoqëritë janë të ndryshme dhe nuk evidentohen tregje apo produkte të lidhura nga palët në transaksion.

Fushat e veprimtarisë së palëve pjesëmarrëse në transaksion janë të ndryshme nga njëra – tjetra dhe për këtë arsye ky përqendrim nuk pritet të ketë ndikim në asnjërin prej tregjeve në të cilin operon secila nga shoqëritë. Transaksioni pritet të mos sjellë shqetësime për konkurrencën në treg, duke mos ndikuar në përjashtimin e konkurrentëve të tjerë nga tregu.

Sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës konstaton se ky përqendrim nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë EUROSIG SHA nga shoqëria EURO-ALBA-EA SHPK.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

VENDIM
Nr.1069, Datë 29. 03. 2024

**“PËR DHËNIEN E DISA REKOMANDIMEVE AUTORITETIT TË
KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE LIDHUR ME DOKUMENTIN
PËR KËSHILLIM PUBLIK “ANALIZA E TREGJEVE ME SHUMICË TË AKSESIT
BROADBAND FIKS”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 29.03.2024, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Dhënia e disa rekomandime Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare lidhur me dokumentin nxjerrjen për këshillim publik “Analiza e tregjeve me shumicë të aksesit broadband fiks”.

Baza Ligjore: Neni 24, shkronja (d), neni 26 dhe neni 70 e Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm, të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE :

1. Këshilli Drejtues i AKEP-it me Vendimin nr. 1, datë 10.01.2024, miratoi nxjerrjen për këshillim publik të dokumentit “Analiza e tregjeve me shumicë të aksesit broadband fiks”.
2. AKEP në vijim të bashkëpunimit dhe detyrimeve që përcakton neni 38 i Ligjit nr. 9918/2008, dhe nenet 69 dhe 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (Ligji nr. 9121/2003), me shkresën nr. 865/50 prot., datë 12.01.2024 (protokolluar pranë AK me nr. 62 prot., datë 16.01.2024), mirëpret komentet e Autoritetit të Konkurrencës për dokumentin e nxjerrë për këshillim publik, lidhur me “Analiza e tregjeve me shumicë të aksesit broadband fiks”.
3. Në përputhje me praktikatat rregullatore Europiane dhe legjislacionin kombëtar, AKEP propozoi të ndërmarrë një rishikim të rregullimit ekzistues ex-ante të tregjeve me shumicë,

për të përshtatur masat rregullatore duke marrë në konsideratë ndryshimet në produktet dhe shërbimet në dispozicion, si dhe dinamikës në zëvendësimin e produkteve nga ana e kërkesës dhe ofertës për shkak të progresit teknologjik, ecurisë në kushtet e tregut dhe zhvillimeve rregullatore.

4. Në përputhje me nenin 7 të Ligjit nr. 9918/2008, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, AKEP-i kryen funksionet e tij në përputhje me ligjin dhe aktet e tjera nënligjore, si dhe në përputhje me politikat sektoriale kombëtare për zhvillimin e komunikimeve elektronike dhe në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare. Ndërhyrjet e AKEP-it kryhen në respekt të parimit të asnjësisë teknologjike dhe me objektivin e nxitjes së konkurrencës efektive në ofrimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike, shërbimeve të komunikimeve elektronike, faciliteteve shoqëruese dhe shërbimeve.
5. Në kuadër të kompetencave të AKEP-it të parashikuara në nenin 8 të Ligjit nr.9918/2008, Autoriteti merr masa dhe përcakton masa mbrojtëse ndaj operatorëve të rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe ofruesve të shërbimeve të komunikimeve elektronike për mos lejimin e praktikave antikonkurruese. Kur është e nevojshme, AKEP është gjithashtu kompetent për të përcaktuar operatorët me fuqi të konsiderueshme në treg (FNT).
6. Në përmbushje të objektivave të sipërpërmendur dhe duke pasur parasysh kompetencat e tij, AKEP ndërmer në këtë dokument analizën e tregjeve broadband fikse të paraqitur për të përcaktuar tregjet përkatëse, për të vlerësuar kushtet e konkurrencës në tregjet e përcaktuara, për të përcaktuar një operator me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT) dhe për të zbatuar masat rregullatore nëse është e nevojshme. Këto tregje korrespondojnë me listën e tregjeve përkatëse të përfshira në rekomandimin e Komisionit Europian i vitit 2014 për tregjet e produkteve dhe shërbimeve brenda sektorit të komunikimeve elektronike të ndjeshme ndaj rregullimit ex ante si dhe lista e tregjeve në të cilat AKEP arriti në përfundimin për ekzistencën e një operatori me FNT në vendimin e saj të analizës së tregut nr. 2701, datë 22.12.2016.
7. Tregjet me shumicë të aksesit broadband kanë qenë pjesë e rekomandimeve të Komisionit Europian për tregjet përkatëse të produkteve dhe shërbimeve brenda sektorit të komunikimeve elektronike të ndjeshme ndaj rregullimit ex ante që nga viti 2003. Në nivel kombëtar, bazuar në rregulloren nr. 9, datë 17.07.2009 “Për Analizën e Tregut”, i ndryshuar, AKEP kreu analizën e tregut të tregjeve të mëposhtme:
 - i. Tregu me shumicë të aksesit në nivel lokal në vendndodhje fikse (WLA);
 - ii. Tregu me shumicë të aksesit në nivel qendror për produkte të tregut të përgjithshëm (WCA);
dhe
 - iii. Tregu me shumicë të aksesit me cilësi të lartë në vendndodhje fikse (WHQA).

8. Tregu i shitjes me pakicë për aksesin broadband fiks në Shqipëri dëshmoi një rritje të rëndësishme të volumit të linjave të shitura që nga analiza e fundit e tregut të kryer nga AKEP në 2016, pasi numri total i linjave u dyfishua (+122%), duke arritur në mbi 585 mijë lidhje aktive deri në fund të vitit 2022, krahasuar me rreth 264 mijë lidhje në vitin 2016. Kjo rritje e numrit të lidhjeve broadband shoqërohet me një rritje të normës së penetrimit kombëtar pasi kjo e fundit arriti në 81% e familjeve në 2022, nga 37% në 2016. Për më tepër, Shqipëria përmirësoi pozicionin e saj në krahasim me vendet e tjera pasi norma e penetrimit të saj në vitin 2021 ishte më e mirë se shumë vende të Evropës Lindore, pasi kishte mbetur pas tyre në vitin 2016.
9. Konkurrenca ndërmjet operatorëve është zhvilluar në tregun me pakicë. Faktorë të shumtë e tregojnë këtë zhvillim: tendenca e përgjithshme rënëse e çmimeve me pakicë (për një ofertë të caktuar) të propozuar nga operatorët kryesorë në treg, konvergjenca e çmimeve të ofruesve të ndryshëm dhe, më e rëndësishmja, ecurisë në pjesët e tregut të operatorëve të ndryshëm.
10. Me normë penetrimi prej 77% në vitin 2021, shkalla e normës së penetrimit të shërbimit të aksesit broadband fiks në Shqipëri rezultoi më mirë se disa vende të Evropës Lindore (Kroaci, Poloni, Lituani, Rumani dhe Bullgari), Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vende të tjera të Amerikës Latine, por mbeti më e ulët se shumica e vendeve të OECD të Evropës Perëndimore.
11. Sipas të dhënave, gjatë 4 viteve të fundit, çmimet e ofruara nga disa prej operatorëve kryesorë në Shqipëri mbetën të krahasueshme dhe tentojnë të konvergojnë drejt një çmimi më të ulët, ndoshta duke reflektuar më nga afër kostot bazë të shërbimit.
12. Në përgjithësi, çmimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve broadband në Shqipëri janë në përputhje me nivelin e çmimeve të propozuara në vendet e tjera të Bashkimit Europian.
13. Deri në fund të vitit 2021, ishin gjithsej 240 operatorë fiks të licensuar që ofrojnë shërbime në Shqipëri. Prania e një numri kaq të madh ofruesish aktivë në tregje sinjalizon barriera të ulëta për hyrjen, një tipar i rëndësishëm i një konkurrence të shëndetshme.
14. Në nivel kombëtar, konkurrenca është zhvilluar që kur AKEP publikoi analizën e mëparshme të tregut. Gjatë gjashtë viteve të fundit, pjesa e tregut të operatorit më të madh, One Albania, u përgjysmua pasi arriti vetëm 20% në 2022 krahasuar me 40% në 2017. Për më tepër, në vitin 2022, dhe për herë të parë, One Albania humbi pozicionin historik si lider në treg pasi Vodafone u bë operatori më i madh në treg me 22% të pjesës së tregut.
15. *Pyetje nr.1: A keni komente në lidhje me analizën e zhvillimeve kryesore të tregut broadband fiks të paraqitur në seksionin 1?*
16. *Lidhur me pyetjen nr. 1: Autoriteti i Konkurrencës lidhur me analizën e AKEP mbi zhvillimet*

kryesore të tregut broadband fikse, gjykon se janë pasqyruar në mënyrë të drejtë, duke treguar se aksesit në shërbime broadband fikse u rrit me kalimin e viteve për të arritur në 81% në fund të 2022, pjesa e lidhjeve të bazuara në fibra, në vitin 2022 është bërë teknologjia dominuese e aksesit me 61% të popullsisë si dhe përqindja e lidhjeve broadband të shpejta dhe ultra të shpejta është rritur ndjeshëm si dhe pritjet të rritet në vitet e ardhshme. Lidhur me çmimet e ofruara nga ofruesit e shërbimeve broadband në Shqipëri është pasqyruar se janë në përputhje me nivelin e çmimeve të propozuara në vendet e tjera të Bashkimit Europian dhe se çmimet e ofruara nga disa prej operatorëve kryesorë në Shqipëri mbetën të krahasueshme dhe tentojnë të konvergojnë drejt një çmimi më të ulët, ndoshta duke reflektuar më nga afër kostot bazë të shërbimit.

17. Tregu në rrjedhën më të sipërme me shumicë është tregu i aksesit në infrastrukturën fizike. Në të vërtetë, në shumicën e rasteve, të gjitha shërbimet e komunikimeve elektronike fikse ofrohen nëpërmjet një infrastrukture fizike të përbashkët.
18. Si e tillë, pikënisja e kësaj analize do të ishte analiza e infrastrukturës fizike dhe vlerësimi nëse është e rëndësishme dhe/ose e mjaftueshme për të përcaktuar masa rregullatore ex-ante në lidhje me aksesin në infrastrukturën fizike në mënyrë që të adresohen çështjet e mundshme të konkurrencës në tregjet e shitjes me pakicë.
19. One Albania mbetet ofruesi kryesor i tubacioneve në nivelin e shumicës në vend me 92% (67 km) në vitin 2022, por ofron çdo vit një volum në rënie që nga viti 2019. Në tremujorin e dytë të 2023, volumi i aksesit në tubacione e ofruar nga One Albania u ul më tej në 63 km.
20. Mungesa e një lidhjeje midis volumit të tubacioneve të marra me qira në treg dhe rritjes së përgjithshme të lidhjeve broadband tregon se operatorët alternativë zakonisht përdorin infrastrukturën e tyre fizike për të ndërtuar rrjetet lokale, pavarësisht disponueshmërisë së një oferte aksesit të rregulluar në tubacionet lokale nga One Albania.
21. Megjithatë, gjurma e pothuajse të gjitha rrjeteve fikse alternative mbetet e kufizuar në zonat lokale si qytetet apo zonat tërheqëse rurale. Pavarësisht investimeve të rëndësishme të bëra nga operatorët alternativë në rrjetet lokale, investimet në rrjetin kryesor kombëtar/ndër urban mbeten të kufizuara në vetëm dy ofrues: One Albania dhe ATU.
22. Rrjetet e tubacioneve të One Albania dhe ATU kanë një mbulim gjeografik dukshëm më të lartë të rrugëve kryesore ndër-urbane sesa operatorët e tjerë, rrjetet e tubacioneve të cilëve ekzistojnë pothuajse ekskluzivisht brenda qyteteve.
23. Për sa i përket tregu i produkteve me shumicë është identifikuar: Tregu me shumicë për aksesin pasiv në infrastrukturën fizike ndër-urbane, i cili përfshin si aksesin në rrjetet e tubacioneve ashtu edhe linjat me fibra të errëta.

24. Për sa i përket dimensionit gjeografik, AKEP propozon të përcaktojë që tregu me shumicë për aksesin pasiv në infrastrukturën fizike ndër-urbane si kombëtar. Dimensioi gjeografik i këtij tregu kufizohet vetëm në gjurmën e rrjetit të operatorit përkatës që zotëron infrastrukturë me tubacione dhe/ose fibër optike në akset e rrugëve kombëtare ose që lidhin zonat urbane.
25. *Pyetje nr. 2: A jeni dakort me përkufizimin e tregut të produktit dhe atij gjeografik të propozuar nga AKEP për tregun me shumicë për aksesin pasiv në infrastrukturën fizike ndër-urbane në seksionin 2.1?*
26. *Lidhur me pyetjen nr. 2: Referuar analizës së AKEP vihet re se, investimet në rrjetin kryesor kombëtar/ndër urban mbeten të kufizuara në vetëm dy ofrues, One Albania dhe ATU, si dhe rrjetet e tyre kanë një mbulim gjeografik dukshëm më të lartë të rrugëve kryesore ndër-urbane sesa operatorët e tjerë, rrjetet e tubacioneve të cilëve ekzistojnë pothuajse ekskluzivisht brenda qyteteve. One Albania mbetet ofruesi kryesor i tubacioneve në nivelin e shumicës në vend me 92% (67 km) në vitin 2022, dhe në tremujorin e dytë të 2023, volumi i aksesit në tubacione e ofruar nga One Albania u ul më tej në 63 km.*
- Autoriteti i Konkurrencës e gjykon të drejtë përkufizimin e tregut të produktit dhe atij gjeografik, pasi tregu dimensionit gjeografik i këtij tregu kufizohet vetëm në gjurmën e rrjetit të operatorit përkatës që zotëron infrastrukturë me tubacione dhe/ose fibër optike në akset e rrugëve kombëtare ose që lidhin zonat urbane, dhe duke qenë se të vetmit operatorë që kanë shtrirje të rrjetit në pjesët ndërrurbane dhe në akset kryesore të rrugëve nacionale janë One Albania dhe ATU, duke rezultuar në një mungesë të prezencës së operatorëve të tjerë në këtë treg.*
27. Aktualisht, ka një numër të kufizuar të ofruesve të shërbimeve që ofrojnë kapacitete me shumicë të rrjetit backbone në Shqipëri duke përdorur infrastrukturën e tyre fizike. (One Albania, Albanian Telecommunication Union (ATU) dhe OST).
28. Midis 2018 dhe 2022, volumi i përgjithshëm i fibrave të errëta të ofruara përmes tregut me shumicë u rrit me 63%, nga 1 809 km në 2 943 km. Kjo rritje është kryesisht për shkak të One Albania, e cila pothuajse dyfishoi kapacitetet e saj me shumicë të fibrave të errëta midis 2018 dhe 2022 dhe rriti pjesën e saj të tregut me 10 pikë përqindje nga 66% në 76%. ATU ka rritur gjithashtu kapacitetet e saj të fibrave të errëta nga 137 km në 325 km (+137%) midis 2018 dhe 2022 për të zënë 11% të aksioneve të tregut.
29. Kërkesa për kapacitete tubacionesh në Shqipëri nuk është zhvilluar në vitet e fundit. Nga njëra anë, One Albania, ofruesi kryesor i kapaciteteve të tilla (me 92% të pjesëve të tregut në vitin 2022), siguron një volum kapacitetesh në rënie çdo vit. Nga ana tjetër, ATU aktualisht nuk ofron asnjë kapacitet të tubacioneve në tregun me shumicë. Megjithatë, të dy operatorët kanë

hapësirë të lirë në tubacionet e tyre që mund të përdoret nga operatorë të tjerë ose për të vendosur fibrat e tyre ose për të marrë me qira fibra të errët.

30. *Pyetje nr.3: A keni komente për kushtet e ofertës dhe kërkesës për kapacitetet backbone me shumicë të paraqitura në seksionin 2.2?*

31. *Lidhur me pyetjen nr. 3: Lidhur me këtë seksion të analizuar nga AKEP, pavarësisht se dy ofruesit kryesorë janë One Albania dhe ATU, vihet re se ende ka një numër të kufizuar të ofruesve të shërbimeve që ofrojnë kapacitete me shumicë të rrjetit backbone në Shqipëri, pavarësisht se të dy ndërmarrjet kanë hapësirë të lirë në tubacionet e tyre që mund të përdoret nga operatorë të tjerë ose për të vendosur fibrat e tyre ose për të marrë me qira fibra të errët.*

Kërkesa për kapacitete tubacionesh në Shqipëri nuk është zhvilluar në vitet e fundit. Nga njëra anë, One Albania, ofruesi kryesor i kapaciteteve të tilla (me 92% të pjesëve të tregut në vitin 2022), siguron një volum kapacitetesh në rënie çdo vit, nga ana tjetër, ATU aktualisht nuk ofron asnjë kapacitet të tubacioneve në tregun me shumicë. Si dhe vihet re se, në vitin 2022, pjesa e tregut të ndërmarrjes One Albania përfaqëson 76% të volumit total të fibrave të errëta me shumicë (lokale+urbane), krahasuar me vetëm 11% për ATU. Ndërkohë të dy ndërmarrjet se bashku zotërojnë 86% të totalit të volumit të fibrave të errëta me shumicë në Shqipëri.

32. *Dy operatorë kryesorë janë aktualisht të pranishëm në tregun me shumicë të infrastrukturës pasive ndërrurbane. Të dy operatorët kanë një rrjet me shtrirje të gjerë kombëtare që mbulon akset kryesore ndërrurbane.*

33. *Në të gjitha rastet, ndërkohë që aksesit në tubacion nuk është zhvilluar si produkt për rrjetin core, kjo nuk tregon domosdoshmërisht se një akses i tillë është i pamundur. Në të vërtetë, siç u përmend më lart, evidencat tregojnë se si ATU ashtu edhe One Albania kanë kapacitete të lira në tubacionet e tyre dhe u është kërkuar të ofrojnë akses në tubacionet e tyre për kërkuesit e aksesit sipas kushteve të përcaktuara në Ligjin nr.120/2016, edhe pse nuk janë përcaktuar si operatorë me FNT në këtë treg.*

34. *Ndërkohë që ekzistojnë dy konkurrentë në treg (One Albania dhe ATU) për infrastrukturën pasive ndërrurbane me shumicë, ekziston një hendek i rëndësishëm në pjesët e tregut midis të dy operatorëve. Pjesa e tregut të One Albania përfaqëson 76% të volumit total të fibrave të errëta me shumicë (lokale + ndërrurbane) krahasuar me vetëm 11% për ATU. Përveç kësaj, midis dy konkurrentëve, vetëm One Albania ofroi akses në tubacione për operatorët e tjerë (lokal + ndërrurban).*

35. *Për më tepër, zhvillimi i produkteve të linjave aktive me qira nga operatorë alternativë të rrjetit, si OST, ushtron presion konkurrues si mbi ATU ashtu edhe mbi One Albania për të*

propozuar oferta konkurruese. Në të vërtetë, pavarësisht mungesës së zëvendësueshmërisë midis ofertave pasive dhe aktive, si dhe midis ofertave nga operatorët e telekomunikacionit dhe operatorët e utiliteteve, ekzistenca e një oferte nga një operator alternativ në treg luan një rol të rëndësishëm në kufizimin e aftësisë së One Albania ose ATU për të adoptuar një sjellje antikonkurruese.

36. Duke pasur parasysh se tregu me shumicë për aksesin pasiv në infrastrukturën fizike ndërurbane nuk është pjesë as e rekomandimit të Komisionit Europian dhe as e ligjit shqiptar që specifikon tregjet e përjashtuara nga testi i tre kritereve, AKEP ka kryer testin e kritereve ku ka konkluduar së asnjë nga 3 kriteret nuk plotësohet.
37. Në mënyrë të përmbledhur, duke pasur parasysh mungesën e barrierave të larta dhe jo kalimtare të hyrjes, mbi tendencën drejt konkurrencës efektive dhe mbi mjaftueshmërinë e ligjit të konkurrencës në vetvete për të adresuar dështimet e vazhdueshme të tregut, AKEP propozon që nuk është e përshtatshme futja e rregullimit *ex-ante* në tregun me shumicë për infrastrukturën pasive ndër-urbane.
38. *Pyetje nr.4: A jeni dakort me analizën e AKEP për testin e tre kritereve për tregun me shumicë për infrastrukturën fizike pasive ndër-urbane të paraqitur në seksionin 2.3?*
39. *Pyetje nr.5: A jeni dakort me konkluzionin e AKEP në lidhje me mungesën e nevojës për vendosjes së rregullimit ex-ante në tregun me shumicë për infrastrukturën fizike pasive ndër-urbane?*
40. *Lidhur me pyetjen nr. 4 dhe nr. 5: Pranë Autoritetit të Konkurrencës nëpërmjet shkresës nr. 128 prot., datë 11.02.2019 është depozituar kërkesa drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARRSH) dhe për dijeni Kryeministrit, Autoritetit të Konkurrencës, Autoritetit të Komunikimeve Elektronike e Postare (AKEP) dhe Zëvendësministrit të MIE, lidhur me kërkesën për takim, për mbështetje për ndërtimin dhe përdorimin e infrastrukturës nëntokësore për rrjetet e komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë.*

Në këtë shkresë grupi i operatorëve alternativë të komunikimeve elektronike që kanë nënshkruar një marrëveshje mirëkuptimi i përbërë nga ABCom SHPK, Albanian Satellite Communication SHPK, Abissnet SHA, Bleta SHPK dhe MCN Services SHPK kanë ngritur problematikën që lidhet me zhvillimin e teknologjive dixhitale dhe rritjen e aksesit internet broadband në vend, ku ndër të tjera ka ngritur problematikën se situata monopol çmimet që ofrohen në treg për qiranë e infrastrukturës nëntokësore dhe tubacioneve të saj janë 3-4 herë më të larta dhe deri ne 10 herë më të larta se vendet e zhvilluara evropiane dhe se situata e krijuar pengon çdo përpjekje të operatorëve të rinj të hyjnë në treg.

Gjithashtu janë shprehur se, Ligji nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e të drejtës së kalimit”, është një tregues i vendosmërisë së qeverisë për zgjidhjen e problemeve që ekzistojnë në ndërtimin e infrastrukturës së rrjeteve broadband. Por zbatimi i tij në praktikë nuk është në pritshmëritë e operatorëve të tregut e cila përbën një pengesë në zhvillimet e shërbimeve broadband në Shqipëri dhe njëkohësisht pamundëson optimizimin e shpenzimeve për infrastrukturën e rrjeteve.

Një nga kërkesat e grupit të operatorëve ka qenë edhe përshpejtimi i miratimit të akteve nënligjore dhe zbatimin me korrektësi të Ligjit nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e të drejtës së kalimit”.

Referuar analizës së fundit të AKEP të 2016 edhe analizës aktuale, vihet re, se pas hyrjes së OST i cili është i angazhuar në mënyrë aktive në tregun e komunikimeve elektronike, pasi ofron, që prej vitit 2021, kapacitete me shumicë të transmetimit të të dhënave, nëpërmjet linjave aktive me qira të ofruara nëpërmjet një teknologjie DÈDM, për operatorët kombëtar dhe ndërkombëtar të telekomunikacionit, tregu vijon të mbetet i kufizuar në vetëm dy ofrues, One Albania dhe ATU.

Për sa më sipër, Autoriteti i Konkurrencës gjykon se konstatohet ekzistenca e barrierave të larta dhe jo kalimtare ligjore dhe rregullatore për hyrjen dhe se struktura e tregut nuk priret drejt konkurrencës efektive brenda horizontit kohor përkatës.

Siç dhe është evidentuar dhe në këtë analizë, kemi një mungesë të konkurrencës, gjë e cila e bën të domosdoshme ndërhyrjen rregullatore dhe marrjen e masave përkatëse nga ana e AKEP për të adresuar problematikat që shkaktohen nga mospasja e konkurrencës në këtë treg për arsye se operatorët One Albania dhe ATU janë ndërmarrjet që dominojnë plotësisht këtë treg aksesit në nivel kombëtar.

41. Në kuadër të sa më sipër, nga pikëpamja e produktit, AKEP identifikon dy tregje të shitjes me pakicë:
- Tregu i shitjes broadband me pakicë për shërbimet e kategorisë së përdoruesve familjarë që adreson përdoruesit rezidencialë dhe bizneseve të vogla dhe të mesme me nevoja konektiviteti të krahasueshme me përdoruesit familjarë; dhe
 - Tregu i shitjes broadband me pakicë për kategorinë e biznesit që adreson bizneset më të mëdha dhe institucionet publike që kanë nevojë për produkte specifike të konektivitetit, shpesh të shoqëruara me një cilësi të lartë shërbimesh.
42. Të dy tregjet përfshijnë lidhje broadband, ose të kombinuara me shërbime të tjera si TV dhe telefonia zanore ose të ofruara në baza standalone, të ofruara nëpërmjet bakrit (xDSL), fibrës

optike (FTTX) ose kablllos koaksiale (HFC).

43. *Pyetje nr.6: A jeni dakort me përkufizimin e produktit për shërbimet broadband me pakicë të propozuar nga AKEP në seksionin 3.1.1.1?*
44. *Lidhur me pyetjen nr. 6: Autoriteti i Konkurrencës vlerëson si të drejtë përkufizimin e produktit për shërbimet broadband me pakicë të propozuar nga AKEP, si dy tregje të shitjes me pakicë (i) Tregu i shitjes broadband me pakicë për shërbimet e kategorisë së përdoruesve familjarë dhe (ii) Tregu i shitjes broadband me pakicë për kategorinë e biznesit, pasi adresojnë nevojat e kërkesës së konektivitetit si dhe të dy të dy tregjet përfshijnë lidhje broadband, ose të kombinuara me shërbime të tjera si TV dhe telefonia zanore ose të ofruara në baza standalone, të ofruara nëpërmjet bakrit (xDSL), fibrës optike (FTTX) ose kablllos koaksiale (HFC).*
45. AKEP ka bërë një dallim të mëtejshëm midis zonave urbane dhe rurale. Një “zonë lokale” përkufizohet kështu si një zonë rurale ose urbane e një bashkie administrative.
46. Në vitin 2022, vetëm 13 zona lokale (11%) kishin vetëm një ofrues shërbimi me broadband krahasuar me 22 (18%) në 2021. Midis këtyre 13 zonave, One Albania është ofruesi i vetëm në vetëm 4 zona lokale, ndërsa 9 zonat e mbetura lokale kanë ofrues lokalë me prezencë në një numër shumë të kufizuar zonash (vetëm dy deri në katër zona lokale). Për më tepër, midis 2021 dhe 2022, numri i zonave lokale të mbuluara nga më shumë se tre ofrues shërbimesh u rrit nga 55 (47%) në 66 (56%).
47. Me një prani në gjithsej 93 (79%) të bashkive në vitin 2022, One Albania është operatori me mbulimin më të gjerë gjeografik. Megjithatë, One Albania është lider në vetëm 33 në zonat lokale (28%), ndër të cilat 26 janë urbane dhe 7 janë rurale. Në ato zona urbane, One Albania kishte më shumë se 50% të pjesëve të tregut në 23 zona urbane lokale dhe mbi 80% të pjesëve të tregut në 10 zona lokale urbane. Në zonat rurale, One Albania kishte më shumë se 50% të pjesës së tregut në pesë zona lokale, ku në katër prej të cilave pjesa e tregut të operatorit incumbent tejkalonte 80%.
48. Në vitin 2022, Vodafone ishte operatori lider në 9 zona urbane lokale, nga të cilat pjesa e tregut të operatorit tejkaloi 50% në tre zona lokale. Edhe pse është lider në pesë zona lokale, ASC kishte më shumë se 50% të pjesës së tregut, është vetëm një zonë lokale, një zonë në të cilën pjesa e tregut të operatorit tejkaloi 80%.
49. Të dhënat e mbledhura nga faqet e internetit të operatorëve në përgatitjen e këtij vendimi çuan në përfundimin se ekzistojnë disa dallime në çmime ndërmjet ofruesve lokal. Për shembull, për lidhjet bazike broadband (d.m.th., më pak se 30 Mbps), çmimi i ofruar nga operatorët kryesorë ishte mesatarisht rreth 1 200 LEK, ndërsa operatorët të tjerë leader lokalë ofruan

çmime që variojnë nga 1 200 LEK deri në 2 000 LEK, me shumicën e operatorëve duke ofruar nga 1 200 LEK dhe 1 600 LEK. Në mënyrë të ngjashme, për lidhjet më të ulëta broadband ultra të shpejtë (d.m.th., 100 Mbps), çmimi i ofruar nga operatorët kryesorë varionte nga 1 300 LEK dhe 1 700 LEK, ndërsa operatorët e tjerë leader lokal ofruan çmime që variojnë nga 1 500 LEK deri në 5 000. LEK. Sidoqoftë, këto rezultate duhet të interpretohen me kujdes. Në të vërtetë, niveli i shpejtësisë së shkarkimit mund të ndryshojë nga një operator në tjetrin duke ndikuar në krahasueshmërinë midis çmimeve (ky është rasti për lidhjet bazike broadband), këto të dhëna bazohen në informacionin publik që mund të mos jetë i përditësuar dhe teknologjia bazë mbi të cilin ofrohet shërbimi mund të mos jetë gjithmonë i njëjtë.

50. Së pari, në vitin 2022, rrjeti i operatorëve kryesorë mbulonte 95 (81%) zona lokale, ndër të cilat 93 mbulohen nga operatori incumbent. Këta operatorë ushtrojnë presion konkurrues në shumicën e zonave në të cilat ata janë të pranishëm pasi pjesa e tyre e kombinuar e tregut kalon 20% në 87 (74%) zona lokale. Së dyti, Figura 33 tregon se çmimet e ofruara nga disa prej dy operatorëve kryesorë që kanë mbulimin më të madh gjeografik dhe pjesët më të larta të tregut janë, në një masë të madhe, të krahasueshme në shpejtësi të afërta. Së treti, operatorët me një mbulim të gjerë gjeografik priren të aplikojnë të njëjtat çmime me pakicë për të gjithë klientët e tyre (veçanërisht klientët familjarë) pavarësisht nga zona në të cilën ata ndodhen.
51. Prandaj, ka evidenca që tregojnë se kushtet e çmimeve janë homogjene në një pjesë të madhe të zonave lokale (81%) në të cilat është të paktën një nga operatorët kryesorë në ofrimin e shërbimeve, veçanërisht në zonat ku një prani e tillë ushtron një presion konkurrues në vend.
52. Nisur nga ecuria e vazhdueshme e konkurrencës në shumicën e zonave lokale dhe homogjeniteti i kushteve të konkurrencës në të gjithë territorin shqiptar, AKEP nuk beson se një përkufizim gjeografik nën-kombëtar është i përshtatshëm pasi një përkufizim i tillë nuk do të përmbushte kushtin për të pasur kufij të qartë dhe të qëndrueshëm në kohë. Për më tepër, AKEP beson se një përkufizim nënkombëtar i tregut do të kërkonte analizë më të thellë dhe mund të çonte në një fragmentim joefikas të tregut.
53. Prandaj, AKEP propozon ruajtjen e përcaktimit të tregut të shitjes me pakicë si kombëtar, si për shërbimet broadband fiks për familjet ashtu edhe për biznes.
54. *Pyetje nr.7: A jeni dakort me përkufizimin gjeografik të shërbimeve broadband me pakicë të propozuar nga AKEP në seksionin 3.1.1.2?*
55. *Lidhur me pyetjen nr. 7: Autoriteti i Konkurrencës vlerëson si të drejtë përkufizimin gjeografik të shërbimeve broadband me pakicë të propozuar nga AKEP si kombëtar, pasi ashtu si dhe përcaktimi i tregut të produktit, edhe tregu gjeografik adreson nevojat e kërkesës në treg.*

Referuar analizës së AKEP, pavarësisht se deri në fund të vitit 2021, ishin gjithsej 240 operatorë fiks të licensuar që ofrojnë shërbime broadband në Shqipëri, vihet re se operatori incumbent (One Albania) ka një mbulim të gjerë gjeografik, ku nga 122 zona lokale, mbulon 93 zona (79% e bashkive) në vitin 2022.

Lidhur me dallimet e çmimeve midis zonave vihet re se, çmimet që operatorët lider për lidhjet bazike broadband (d.m.th., më pak se 30 Mbps) ofruan çmime që variojnë nga 1 200 LEK deri në 2 000 LEK krahasuar me çmimin e ofruar nga operatorët kryesorë që ishte mesatarisht rreth 1 200 LEK, si dhe për lidhjet më të ulëta broadband ultra të shpejtë (d.m.th., 100 Mbps), çmimi i ofruar nga operatorët leader variojnë nga 1 500 LEK deri në 5 000 LEK, krahasuar me operatorët kryesorë që varionte nga 1 300 LEK dhe 1 700 LEK. Si dhe referuar analizës së AKEP, operatorët zakonisht ofrojnë të njëjtën cilësi shërbimi dhe përdorin të njëjtat burime për të tregtuar ofertat e tyre në të gjitha zonat lokale ku ata janë të pranishëm. Nga krahasimi i çmimeve vihet re se, operatori me pozitë dominuese (One Albania) pavarësisht se cilësia, shërbimi dhe përdorimi i të njëjtave burime, aplikon tarifa më të larta se ndërmarrjet e tjera që ofrojnë mbulim në një zonë të caktuar.

56. Aksesi me shumicë broadband mund të jepet në nivel qendror ose lokal. Në analizën e fundit të tregut dhe në përputhje me Rekomandimet e Komisionit Evropian të vitit 2014, AKEP përcaktoi në vitin 2016 tre tregje me shumicë:
- Tregu me shumicë i aksesit në nivel lokal në vendndodhje fikse (WLA);
 - Tregu me shumicë i aksesit në nivel qendror për produkte të tregut të përgjithshëm (WCA); dhe
 - Tregu me shumicë i aksesit me cilësi të larta në vendndodhje fikse (WHQA).
57. Në përcaktimin e tregjeve të aksesit me shumicë, AKEP u mbështet në kriteret e mëposhtme:
- vendndodhjen aktuale të pikës së dorëzimit: kryesisht duke bërë dallimin midis aksesit të ofruar në nivel lokal nga aksesi i ofruar në një nivel më të lartë rrjeti;
 - topologjinë dhe karakteristikat kryesore të transmetimit core të produkteve me shumicë, veçanërisht në lidhje me contention në rrjet: dhe
 - shkalla e fleksibilitetit që kontrolli i rrjetit u lë kërkuesve të aksesit për të diferencuar ofertat e tyre me pakicë.
58. Për sa më sipër, nga pikëpamja e produktit AKEP propozon ruajtjen e të njëjtave tregje me shumicë siç përcaktohen në vendimin e analizës së tregut të AKEP 2016.
59. Pavarësisht ekzistencës së ndryshimeve të evidentuara të konkurrencës në zona të ndryshme gjeografike, AKEP ruan një përkufizim kombëtar të të tre tregjeve të aksesit me shumicë të identifikuar. Kjo zgjedhje është motivuar nga mbulimi i gjerë i rrjetit të operatorit incumbent,

i cili mbulon në vitin 2022, sipas raportimit të operatorit në AKEP, 93 nga 122 zonat lokale.

60. *Pyetje nr. 8: A jeni dakort me përkufizimin gjeografik dhe të produktit për shërbimet e aksesit me shumicë në rrjet të propozuar nga AKEP në seksionin 3.1.2?*
61. *Lidhur me pyetjen nr. 8: Autoriteti i Konkurrencës vlerëson si të drejtë përkufizimin e produktit për shërbimet e aksesit me shumicë në rrjet të propozuar nga AKEP të cilat janë në përputhje dhe me Rekomandimet e Komisionit Evropian të vitit 2014. Gjithashtu vlerëson si të drejtë edhe përkufizimin e tregut gjeografik si kombëtar, për arsye se operatori i cili ka një mbulim më të gjerë gjeografik është ndërmarrja One Albania.*
62. Duke marrë parasysh analizën e propozuar të AKEP-it për përkufizimin përkatës të tregjeve me pakicë nga të dyja perspektivat e produktit (3.1.1.1) dhe ajo gjeografike (3.1.1.2), AKEP identifikon dy tregje të shitjes me pakicë:
- Një treg kombëtar me pakicë për shërbimet broadband për familje; dhe
 - Një treg kombëtar me pakicë për shërbimet broadband biznes.
63. Për evolucionin e pjesëve të tregut të operatorëve midis 2017 dhe 2022 për shërbimet rezidenciale të aksesit në internet, pjesët e tregut të One Albania janë përgjysmuar, duke arritur në 20% në 2022 nga 40% në 2017, dhe Vodafone si operatori me më të madhin në treg dhe rritjen e pjesës së tregut të operatorëve më të vegjël.
64. Duke marrë parasysh ecurinë e konkurrencës në treg gjatë 6 viteve të fundit, AKEP e konsideron tregun me pakicë për shërbimet broadband të kategorisë familje si mjaft konkurrues.
65. Brenda tregut të shitjes me pakicë për shërbimet broadband të kategorisë së biznesit, AKEP bën dallimin midis dy produkteve kryesore, aksesit në internet dhe shërbimeve të linjave/kapacitetit me qira.
66. Për shërbimet e aksesit në internet të nivelit të biznesit, bazuar në të dhënat e mbledhura nga AKEP nga operatorët mes viteve 2017 dhe 2022, operatori incumbent humbi 20 pikë përqindje të pjesës së tregut, pasi mbante 16% në 2022. Përkundrazi, konkurrentët e tjerë, si Vodafone dhe Abissnet fituan pjesën e tregut pasi ata u bënë operatorët kryesorë me përkatësisht 26% dhe 20% të pjesëve të tregut në vitin 2022.
67. Duke marrë parasysh ecurinë e konkurrencës në treg gjatë periudhës 2017-2022, AKEP e konsideron tregun me pakicë të shërbimeve të internetit të kategorisë biznes të jetë mjaft konkurrues.
68. Bazuar në të dhënat e mbledhura nga operatorët nga AKEP, tregu i shitjes me pakicë për linjat

me qira duket të jetë i paqëndrueshëm pasi pjesët e tregut të operatorëve rriten dhe ulen pa një model specifik. Kjo paqëndrueshmëri mund të shkaktohet ose nga volumet e ulëta të lidhjeve në treg (maksimumi 4 528 lidhje në 2022) dhe/ose nga çështjet që lidhen me cilësinë e të dhënave. Në çdo rast, sipas të dhënave të disponueshme, One Albania është operatori kryesor i linjave me qira me pakicë me një pjesë tregu që varion nga 42% në 62% gjatë periudhës 2017-2022.

69. Vlen të përmendet se linjat me qira të One Albania janë kryesisht kombëtare pasi operatori ofron shumë pak lidhje ndërkombëtare. Ndërsa volumet e përgjithshme të lidhjeve ndërkombëtare janë të ulëta (total of 114 connections in 2022), Vodafone is the largest provider providing close to 90% of international leased lines in Albania.

70. Në terma të numrit të bizneseve të lidhura nga secili operator, Vodafone ishte ofruesi leader në vitin 2022 me 150 klientë, pas një rritje të konsiderueshme krahasuar me 85 klientë që operatorët u ofronin shërbim në vitin 2021 (+76%). Kjo rritje e bazës së pajtimtarëve është reflektuar gjithashtu në rritjen e pjesës së tregut të operatorit në terma të volumit të lidhjeve në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021. One Albania ishte operatori i dytë me 105 klientë në vitin 2022, nga 85 klientë që kishte në vitin e mëparshëm (+24%).

71. Pyetje nr. 8: A jeni dakort me vlerësimin e konkurrencës në tregjet broadband me pakicë të kryer nga AKEP në seksionin 3.2.1?

72. *Lidhur me pyetjen nr. 8: Autoriteti i Konkurrencës, në vijim të ecurisë së tregut nga 2017 deri në 2022, vlerëson si të drejtë përcaktimin se tregu me pakicë për shërbimet broadband të kategorisë familje dhe tregun me pakicë për shërbimet broadband të kategorisë së biznesit, për produktin e aksesit në internet si një treg konkurrues.*

Lidhur me tregun me pakicë të shërbimeve të internetit të kategorisë biznes për produktin e shërbimeve të linjave/kapacitetit me qira, One Albania është operatori kryesor i linjave me qira me pakicë me një pjesë tregu që varion nga 42% në 62% gjatë periudhës 2017 -2022, duke u konsideruar një ndërmarrje FNT në këtë treg, pra duke mos pasur një konkurrencë efektive në treg.

Vendosja e detyrimeve në zbatim të Ligjit nr. 9918/2008 është e nevojshme ndaj ndërmarrjes One Albania, për të nxitur konkurrencën në treg.

73. Volumi i produkteve të aksesit me shumicë që shiten aktualisht në Shqipëri është shumë i ulët. Deri në fund të vitit 2022, kishte gjithsej 578 aksese bitstream, nga 4 633 aksese në vitin 2016. Për sa i përket pjesës së tregut, akseset e shitura nga One Albania përfaqësonin 44% të akseseve totale të shitura në 2022, të cilat përfaqësonin pjesën më të ulët të tregut të operatorit

incumbent që nga viti 2016. Me 50% të pjesës së tregut, ASC ishte në vitin 2022 ofruesi më i madh i aksesit në bitstream në Shqipëri.

74. Ngjashëm me tregun me pakicë, tregu me shumicë për linjat me qira duket të jetë gjithashtu i paqëndrueshëm. Për sa i përket volumeve, ka pasur një rritje të ndjeshme midis 2017 dhe 2018 pasi numri total i linjave me qira të ofruara në tregun me shumicë arriti në 1 466, nga 651 (+125%). Megjithatë, volumet u ulën me 29% (nga 1 432 në 1 018) midis 2020 dhe 2021 përpara se të rriteshin përsëri në 2022 me 27% për të arritur në 1 291 linja me qira.
75. Në vitin 2021 dhe 2022, linjat me qira me shumicë përfaqësonin përkatësisht 30% dhe 29% të totalit të linjave me qira me pakicë. Edhe një herë, kjo përqindje është e paqëndrueshme gjatë periudhës së vëzhguar pasi përfaqësonte 21% në 2017, 37% në 2018 dhe 39% në 2020.
76. Linjat me qira me shumicë të One Albania u ulën si në volum ashtu edhe në pjesën e tregut midis 2017 dhe 2022, pasi ra nga 281 lidhje (43% e tregut) në 166 lidhje (13% e tregut). Përkundrazi, Vodafone u rrit si në volum ashtu edhe në pjesën e tregut duke kaluar nga 170 lidhje (26% e tregut) në 2017 në 450 lidhje (35% e tregut) në 2022.
77. Për sa i përket numrit të operatorëve të shërbyer përmes tregut me shumicë, Vodafone ishte operatori kryesor me 55 operatorë-klientë në vitin 2022 pas një rritje të ndjeshme nga vetëm 5 operatorë-klientë në 2021. Abissnet është ofruesi i dytë më i madh me 23 operatorë-klientë në vitin 2022 (nga 17 në 2021) dhe One Albania është ofruesi i tretë më i madh me 22 operatorë-klientë në vitin 2022 (në rënie nga 27 në 2021).
78. *Pyetje nr. 9: A jeni dakort me vlerësimin e konkurrencës në tregjet Broadband me shumicë të kryer nga AKEP në seksionin 3.2.2?*
79. *Lidhur me pyetjen nr. 9: Të dhënat e analizuar nga AKEP në seksionin 3.2.2 nuk realizojnë një vlerësim të konkurrencës në tregjet Broadband me shumicë por thjesht paraqesin volumet e akseseve bitstream me shumicë të shitura në Shqipëri (2016-2022) sipas raporteve vjetore statistikore të AKEP bazuar në të dhënat e mbledhura nga operatorët.*
80. Në përputhje me udhëzimet për FNT të Komisionit Evropian, për të përcaktuar nëse një treg me shumicë e justifikon futjen ose mbajtjen e një rregullimi ex-ante, autoriteti rregullator kombëtar duhet të përcaktojë nëse tregu(t) themelor i shitjes me pakicë është (janë) potencialisht konkurrues në mungesë të rregullimit me shumicë, i bazuar në një gjetje të fuqisë së ndjeshme të tregut, të vetëm ose të bashkuar, dhe si rrjedhim nëse ndonjë mungesë e konkurrencës efektive është e qëndrueshme.
81. Për këtë qëllim, AKEP analizoi nëse, në mungesë të rregullimit me FNT në tregjet e identifikuar me shumicë, mund të shfaqet rreziku i dëmtimit të konsumatorit për shkak të

mungesës së konkurrencës qoftë në tregun e shitjes me pakicë për shërbimet broadband të kategorisë familje, qoftë në tregun me pakicë për shërbimet broadband të kategorisë së biznesit.

82. Asnjë dëm i konsumatorit nuk është identifikuar për shkak të mungesës së konkurrencës në rast të heqjes së rregullimit FNT në tregjet me shumicë në rrjedhën e sipërme të tregut me pakicë për shërbimet broadband për përdoruesit familjare.
83. Volumi i akseseve të shitura në tregun me shumicë në Shqipëri është shumë i ulët. Në të vërtetë, pavarësisht disponueshmërisë së një aksesit të rregulluar nga One Albania, akseset në bitstream u ulën nga 4 633 aksese në 2016 në vetëm 578 aksese në vitin 2022. Përveç volumeve kaq të ulëta, One Albania nuk është më ofruesi kryesor i akseseve bitstream me shumicë në Shqipëri. Për më tepër, kërkesa për aksese LLU u zhduk nga tregu që nga viti 2018. Pavarësisht mungesës së përdorimit të produkteve të rregulluara, është zhvilluar një konkurrencë e bazuar në infrastrukturë.
84. Për të zgjeruar rrjetet e tyre, operatorët shqiptarë ndërtojnë rrjetin e tyre duke përdorur infrastrukturën e tyre, madje edhe për pjesët me kapital më intensiv në rrjet (d.m.th., infrastrukturën fizike lokale) ku ata mbështeten kryesisht në tubacionet dhe shtyllat e tyre të ndërtuara, të financuara nga secili operator me vete ose bashkërisht nëpërmjet marrëveshjeve të investimeve të përbashkëta.
85. Si i tillë, duke pasur parasysh zhvillimet e sektorit që nga vendimi i fundit i analizës së tregut në 2016, AKEP gjykon se të dy tregjet e aksesit me shumicë në nivel lokal dhe qendror luajnë një rol shumë të vogël, nëse ka, në zhvillimin e sektorit të komunikimeve elektronike në Shqipëri. Prandaj, heqja e rregullimit ex-ante nga këto tregje nuk ka të ngjarë të çojë në dëmtim të konsumatorit ose të pengojë zhvillimin e konkurrencës në tregun e shitjes me pakicë për shërbimet broadband fiks për kategorinë familje.
86. Asnjë dëm ndaj konsumatorit nuk është identifikuar për shkak të mungesës së konkurrencës në rast të heqjes së rregullimit me FNT në tregjet me shumicë në rrjedhën e sipërme të tregut me pakicë për shërbimet broadband për kategorinë biznes.
87. Megjithëse One Albania ka ende një prani të rëndësishme në tregun me pakicë të linjave me qira, në nivelin me shumicë One Albania nuk është më ofruesi më i madh pasi pjesa e saj e tregut ra në 13% për kapacitetet e dhëna me qira në 2022, nga 43% në 2017. Përveç kësaj, ka operatorë të tjerë që kanë zhvilluar oferta konkurruese me shumicë dhe janë bërë lider në treg, si për nga volumi i akseseve të shitura ashtu edhe për numrin e operatorëve-klientë të shërbyer.
88. Ndërsa One Albania ende zotëron rrjetin më të përhapur në Shqipëri, operatorët alternativë nuk duket se varen nga ofertat me shumicë nga operatori incumbent për të konkurruar në

nivelin e shitjes me pakicë, pasi në treg u shfaqën oferta konkurruese me shumicë. Ndërsa operatorët alternativë vazhdojnë të ndërtojnë rrjetet e tyre në nivel lokal, veçanërisht në zonat urbane ku aktiviteti ekonomik është i përqendruar dhe shumica e bizneseve me nevoja strikte shërbimi për cilësinë janë zbatuar, operatorët biznes duket se kanë gjetur alternativa ndaj ofertave me shumicë të One Albania. Në këtë mënyrë, konstatohet rënia e vërejtur në volume, pjesëve të tregut dhe në numrin e klientëve për operatorin incumbent që nga analiza e mëparshme e tregut.

89. Prandaj, sipas AKEP-it, heqja e rregullimit ex-ante në tregun e aksesit me shumicë me cilësi të lartë të ofruar në një vendndodhje fikse nuk ka gjasa të çojë në ndonjë dëm të konsumatorit ose të pengojë zhvillimin e konkurrencës në tregun e shitjes me pakicë për shërbimet broadband fiks për kategorinë e pajtimtarëve biznes.
90. *Pyetje nr.10: A jeni dakort me konkluzionin e AKEP për mungesën e operatorëve me fuqi të ndjeshme në treg (FNT) në tregjet e identifikuar me shumicë?*
91. *Lidhur me pyetjen nr. 10: Në vlerësimin e Autoritetit të Konkurrencës, pavarësisht se deri në fund të vitit 2021, ishin gjithsej 240 operatorë fiks të licensuar që ofrojnë shërbime broadband në Shqipëri, vihet re se operatori incumbent (One Albania) ka një mbulim të gjerë gjeografik, ku nga 122 zona lokale, mbulon 93 zona (79% e bashkive) në vitin 2022. Ndërmarrja One Albania është ofruesi kryesor i kapaciteteve të tubacioneve (me 92% të pjesëve të tregut në vitin 2022), nga ana tjetër, ATU aktualisht nuk ofron asnjë kapacitet të tubacioneve në tregun me shumicë, si dhe në vitin 2022 pjesa e tregut të ndërmarrjes One Albania përfaqësonte 76% të volumit total të fibrave të errëta me shumicë (lokale+urbane), për këto arsye vlerësohet se ndërmarrja One Albania SHA përmbush kriteret për FNT në tregjet e identifikuar me shumicë.*
92. Nisur nga përfundimi i arritur nga AKEP lidhur me mungesën e nevojës për të vendosur rregullimin ex-ante në tregun për aksesin lokal me shumicë të ofruar nga vendndodhje fikse, tregu për akses qendror me shumicë i ofruar në një vendndodhje fikse për produktet e tregut të përgjithshëm dhe tregun për akses me shumicë me cilësi të lartë i ofruar nga vendndodhje fikse, AKEP propozon heqjen e detyrimeve rregullatore ekzistuese të vendosura aktualisht për sipërmarrësin One Albania në bazë të vendimit të mëparshëm të analizës së tregut të AKEP në 2016.
93. *Pyetje nr. 11: A jeni dakort me konkluzionin e AKEP mbi rëndësinë e heqjes së detyrimeve rregullatore ex-ante të vendosura aktualisht për sipërmarrësin One Albania?*

Lidhur me pyetjen nr.11: Autoriteti i Konkurrencës vlerëson se operatori inkumbent është ai që ka shtrirjen më të madhe të rrjetit në pjesët ndërrbane dhe në akset kryesore të rrugëve nacionale, dhe në kushtet e ekzistencës së barrierave të larta dhe jo kalimtare ligjore dhe

rregullatore për hyrjen dhe se struktura e tregut me shumicë të aksesit për infrastrukturës fizike pasive ndërrurbane nuk priret drejt konkurrencës efektive brenda horizontit kohor përkatës, ky treg duhet të jetë ende nën rregullim ex-ante, pasi operatori inkumbent është operator me fuqi të ndjeshme në tregun me shumicë të aksesit në rrjetin lokal (LLU) dhe si i tillë duhet t'i nënshtrohet detyrimeve rregullatore që parashikon Ligji nr. 9918 datë 19.5.2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë". Ndërmarrjet e tjera kanë një mbulim të vogël të cilat ekzistojnë pothuajse ekskluzivisht brenda qyteteve dhe e vetmja mundësi për rritjen e konkurrencës është aksesit në rrjetin e inkumbentit (One Albania SHA). Vendosja e detyrimeve në zbatim të Ligjit nr. 9918/2008 është e nevojshme ndaj ndërmarrjes One Albania, për të nxitur konkurrencën në treg.

Autoriteti i Konkurrencës, vlerëson se ndërmarrja One Albania SHA i përmbush kriteret për FNT në të treja tregjet me shumicë të aksesit në nivel lokal në vendndodhje fikse (WLA), në nivel qendror për produkte të tregut të përgjithshëm (WCA) dhe të aksesit me cilësi të lartë në vendndodhje fikse (WHQA).

94. Pavarësisht pothuajse mungesës së shtrirjes së produkteve të rregulluara, konkurrenca me pakicë është zhvilluar. Si i tillë, heqja e detyrimeve rregullatore ekzistuese nuk ka gjasa të dëmtojë konsumatorin për shkak të mungesës së konkurrencës në rast të heqjes së rregullimit me FNT në tregjet e sipërme me shumicë. Në të njëjtën logjikë, zhvillimi i konkurrencës me pakicë ka ndodhur pavarësisht mungesës së rregullimit në tregjet e tjera me shumicë.
95. Sa më sipër, AKEP propozon:
- i. Heqjen e detyrimeve rregullatore ex-ante të vendosura aktualisht për One Albania në tregun e aksesit lokal me shumicë të ofruar në një vendndodhje fikse (WLA);
 - ii. Heqjen e detyrimeve rregullatore ex-ante të vendosura aktualisht për sipërmarrësin One Albania në tregun e aksesit qendror me shumicë të ofruar në një vendndodhje fikse për produktet e tregut të përgjithshëm (WCA);
 - iii. Heqjen e detyrimeve rregullatore ex-ante të vendosura aktualisht për sipërmarrësin One Albania në tregun e aksesit me shumicë me cilësi të lartë të ofruar në një vendndodhje fikse (WHQA); dhe
 - iv. Të mos vendos detyrime rregullatore ex-ante në tregun me shumicë për aksesin pasiv në infrastrukturën fizike ndërrurbane.
96. *Pyetje nr. 12: A keni komente të tjera për AKEP në lidhje me analizën e tregjeve broadband me shumicë të propozuara?*
97. *Lidhur me pyetjen nr. 12: Pavarësisht se sipas analizës së AKEP, ku vihet re se konkurrenca ndërmjet operatorëve është zhvilluar në tregun me pakicë, dhe se operatorët alternativë nuk duket se varen nga ofertat me shumicë nga operatori incumbent për të konkurruar në nivelin*

e shitjes me pakicë, pasi në treg u shfaqën oferta konkurruese me shumicë, kjo edhe për shkak të detyrimeve në tregun me shumicë të cilat kanë qenë në fuqi për ndërmarrjen One Albania (dikur Albtelecom), mund të kenë ndikuar pozitivisht dhe në tregun e rrjedhjes së poshtme (tregun me pakicë). Si dhe për shkak se ndërmarrja One Albania është ofruesi kryesor i kapaciteteve të tubacioneve (me 92% të pjesëve të tregut në vitin 2022), vlerësohet se vendosja e detyrimeve në tregjet e identifikuar nga AKEP, në zbatim të Ligjit nr. 9918/2008 është e nevojshme, si një ndërmarrje One Albania e cila përmbush kriteret për FNT.

98. Meqenëse AKEP, aktualisht është përpara marrjes së Vendimit për miratimin e analizës së tregut “Analiza e tregjeve me shumicë të aksesit broadband fikse”, vlerësojmë se është e nevojshme që AKEP për të përmbushur qëllimin dhe objektivat rregullatore, të përcaktuara nga ligji, të përcaktojë ndërmarrjen One Albania SHA me fuqi të ndjeshme në: (i) tregun e aksesit lokal me shumicë të ofruar në një vendndodhje fikse (WLA); (ii) tregun e aksesit qendror me shumicë të ofruar në një vendndodhje fikse për produktet e tregut të përgjithshëm (WCA); (iii) tregun e aksesit me shumicë me cilësi të lartë të ofruar në një vendndodhje fikse (WHQA) dhe të ndërmarrë masat rregulluese, për të mos lejuar praktika antikonkurruese.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d), nenin 26 dhe nenin 70 të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

- I. Ti rekomandojë Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, si vijon:
- i. Mbajtjen e detyrimeve rregullatore ex-ante të vendosura aktualisht për ndërmarrjen One Albania në:
 - i. tregun e aksesit lokal me shumicë të ofruar në një vendndodhje fikse (WLA);
 - ii. tregun e aksesit qendror me shumicë të ofruar në një vendndodhje fikse për produktet e tregut të përgjithshëm (WCA);
 - iii. tregun e aksesit me shumicë me cilësi të lartë të ofruar në një vendndodhje fikse (WHQA).
 - ii. Ndërhyrjen rregullatore dhe marrjen e masave përkatëse nga ana e AKEP në tregun me shumicë për infrastrukturën fizike pasive ndërrbane, për të adresuar problematikat që shkaktohen nga mospasja e konkurrencës në këtë treg.

II. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

**VENDIMET E
KOMISIONIT TË
KONKURRENCËS
2024**
BULETINI ZYRTAR



2024